B. A. KULE
MISTERI I QUAJTUR KOMB
DHE
SHQIPTARI I PARË...
(shkrime dhe fejtone)

B. A. KULE

# MISTERI I QUAJTUR KOMB DHE SHQIPTARI I PARË…

**(shkrime dhe fejtone)**

**Tiranë 2017**

**Uroj që ky libër t'ju ndihmojë sadopak të kuptoni, se çfarë do të thotë, të jesh shqiptar...**




Të gjitha të drejtat e botimit në gjuhën shqipe, janë të autorit, (kulebujar@gmail.com).

## NGA I NJËJTI AUTOR...

**GRAAL**
**SHPIRTI I HUMBUR I EVROPËS**
**DHE**
**HISTORIA E MOHUAR E ALBA – GENS**
**( UEGEN 2013 )**

**YLLI I BIJVE TË PELLAZGUT**
**( MAGUS 2016 )**

**FJALOR RRËFYES I MITEVE PELLAZGE**
**( MAGUS 2016 )**

# PËRMBAJTJA


**Tregtar flamujsh ..... 5**
**Papagallët e katedrales së Dhërmiut ..... 13**
**Evropa dhe Greqia... ..... 28**
**Sikur me pas fol sot, Faik Konica... ..... 35**
**Duhet të krenohemi me Shën Albanin?..... 43**
**Evropa dhe profecia e J. G. Hahn ..... 49**
**Kampionati Botëror i Futbollit**
**dhe "Sindroma e Jeniçerllëkut" ..... 54**
**Faleminderit i Fortlumturi Irene! ..... 64**
**Misteri i quajtur komb dhe shqiptari i parë... ..... 72**
**Sporti, olimpiadat, politika dhe...**
**Rrëfenja e krijimit të një kombi të ri ..... 81**
**Shqiptarët midis Shilës dhe Karibdës ..... 91**
**Kush po i gënjen çamët? Apo...**
**Çamët po gënjejnë vetveten? ..... 96**
**Albin Kurti, Ben Blushi dhe thyerja e ëndrrës ..... 105**
**Rrëfenjë arkeologjike ..... 112**
**Mbi "Velierën", "Dakot" dhe "Dakeshat"! ..... 127**
**Kush e vrau mikun tim Altin Kocaqi? ..... 131**
**14 shkurt 2013... ..... 139**
**Mbi z. Lubonja dhe "Lubonjëzimin"**
**e shoqërisë shqiptare ..... 154**
**"Magus" ..... 184**

# TREGTAR FLAMUJSH

Rrëfenja e Ernest Koliqit zë fill qetësisht. Monotone dhe e ngadaltë. Njësoj si ai tak–taku i orës së vonuar të qyteteve shqiptare, të cilat, në fillimin e shekullit të XX, nga moçali i ligështisë aziatike, u gjenden befas në zemër të Evropës.

Shkrimtari i ri Hilush Vilza që sapo ishte kthyer në atdhe mbasi kishte mbaruar studimet diku në Evropë, po shëtiste udhëve të qytetit ku kishte lindur dhe ishte rritur, Shkodrës…

Çdo ditë, kur gjatë ecejakeve nëpër rrugët e qytetit i qëllonte ti afrohej "dugajës" (shitores) të Gaspër Tragaçit, i pa dëshirë për tu takuar me tregtarin, Hilushi kujdesej të kthente udhë. Nuk kishte ndonjë shkak të logjikshëm, borxhe apo hasmëri. Përkundrazi, Gaspëri ishte mik i vjetër i shtëpisë së tij. Atëherë, përse...

Cila të ishte arsyeja e asaj ndjesie të errët dhe neverie të pashpjegueshme që e shtynte ti qëndronte larg Gaspër Tragaçit?

Mos ndoshta sepse tregtari, ndryshe nga ai, ja kishte kushtuar jetën grumbullimit të parasë?

Kultura, shkolla, aq më tepër shkrimet dhe poezitë, për tregtarin nuk kishin asnjë vlerë nëse nuk sillnin para dhe, Hilushi e dinte…

Në Shqipërinë e tij, ndryshe nga profesioni i tregtarit, arti i të shkruarit nuk i sillte para atij që e ushtronte por,

veç punë, punë, "punë në këmbim të asgjësë", siç do të thoshte duke qeshur me ironi Gaspër tregtari.

"Tani që e bëmë Shqipërinë, duhet të bëjmë shqiptarët", përsëriste deri në mërzi bashkëqytetasi i tyre At Gjergj Fishta dhe, Hilushi, po aq mirë e dinte se, udha e vetme për të "bërë" shqiptarët, për të mbarsur në shpirtrat e tyre ndjesinë e të qenit pjesë e një kombi, dashurinë dhe respektin për historinë dhe kulturën e popullit që i kishte lindur, ishte shkrimi i historisë së tyre të mohuar dhe të harruar, lëvrimi i gjuhës shqipe, që edhe pse e gjallë, mbas pesë shekujsh dhune, përbuzjeje dhe përndjekje të ushtruar nga shteti kozmopolit otoman, tanimë rënkonte vuajtjet e vdekjes. Dhe…

Për ti dhënë frymë dhe ringjallur gjuhën shqipe, duheshin shkruar poezi, romane, drama, komedi, duhej shkruar, shkruar, shkruar pa pushim.

Hë…

Mjerisht, pikërisht ai, arti i të shkruarit, ilaçi i vetëm për të ringjallur gjuhën dhe kombin, në Shqipërinë e Gaspër Tragaçëve, në Shqipërinë e dallkaukëve që ëndërronin akoma mustaqet e baba sulltanit dhe urrenin deri në deje këdo që kishte luftuar me pushkë dhe penë për Shqipërinë e lirë, në Shqipërinë e levandinëve të rinj (siç i quante Konica) që, mbasi livandoseshin dhe kollariseshin allaevropiançe, flisnin shatra patra, një fjalë shqip, dy frëngjisht dhe një italisht, duke ëndërruar që pushtetin e baba sulltanit ta këmbenin me atë të ndonjë

baba sulltani nga Roma, Parisi apo Brukseli, vraponin ti lëpiheshin konsujve të huaj se mos kushedi, ndonjëri prej tyre, i prishej mendja dhe i blinte, që të shisnin Shqipërinë…

Në Shqipërinë e Tragaçëve, Dallkaukëve dhe Levandinëve, arti i të shkruarit, ilaçi për të shpëtuar kombin përbuzej nga të gjithë. Askush nuk e donte. Askush nuk paguante qoftë dhe një kothere bukë në këmbim të tij dhe, ata…

Grusht mjeranësh që e përgatisnin këtë ilaç, që shkruanin e shkruanin për të shpëtuar atë pak që kishte ngelur gjallë nga gjuha dhe historia e Shqipërisë, për të mbajtur në jetë qoftë edhe një ditë më shumë zemrën dhe shpirtin e kombit, lëngonin në përbuzje dhe varfëri njësoj si kombi dhe populli që kërkonin të shpëtonin.

Ja se përse Hilushi e mbante larg Gaspër Tragaçin dhe ndjente neveri nga prania e tij.

Por atë ditë nuk mundi ti shmangej. Gaspëri e kapi prej krahu dhe e shtyu brenda në shitore. I dha kafe dhe cigare. I rrahu shpatullat dhe e pyeti gjerë e gjatë për familjen. Dhe në fund…

Gaspër Tragaçi e pyeti nëse vazhdonte të shkruante dhe ndërsa Hilushi po mëdyshej ti përgjigjej, shtoi, "Më kanë thënë se din me qitë edhe vjersha".

"Po ky, a mos po don me u tall me mua? Apo… Në emër të një urtësie kallpe, kujton se do t'më mësoj sesi ta rregulloj jetën dhe të gjej atë çfarë, sipas tij, është lumturia,

duke më këshilluar të mos merrem më, me punë boshe nga të cilat nuk përfitoj asgjë. Me shkrime e vjersha që s'qesin asnjë dobi. E teproi, kësaj here s'po e la pa përgjigje!", mendoi rrëmbimthi Hilushi.

Por përgjigja nuk i doli nga goja. Ndjehej i pafuqishëm. I mposhtur. I mundur. I shkelur me këmbë. Si? Çfarë arsyetimi mund të përdorte për të bindur Gaspër Tragaçin se, shkrimet dhe poezitë nuk ishin të pavlera, nuk ishin punë boshe, punë që s'qesin dobi, ti shpjegonte se, shkrimet dhe poezitë ishin thesari më i madh që një komb mund të grumbullonte, esenca e magjishme që mbante gjallë shpirtin e kombit, ndërkohë, që gjendej i rrethuar nga pasuria e dukshme dhe e prekshme e Gaspër Tragaçit?

Përball shitoreve, karrocave me kuaj, vilave, tokave e gjithçka tjetër që zotëronte Gaspër Tragaçi, si mund të dëshmonte se, edhe puna që bënte ai, e kishte një vlerë dhe…

Ajo vlerë…

Ishte e barazvlefshme me jetën e kombit!

"Gaspër Tragaçi ka të drejtë", mendoi i vrarë në shpirt Hilushi, "Në Shqipërinë e matrapazëve, dallkaukëve dhe levandinëve, puna e tij vlente më pak se një kothere buke. Dhe… Ndoshta ka të drejtë, edhe kur t'më këshilloj të ndërroj udhë sa nuk është vonë…",.

Por, për habinë e Hilushit, Gaspër Tragaçi, nuk e këshilloi të ndërronte udhë…

Përkundrazi i lëvdoi shkrimet dhe e këshilloi të shkruante sa më shumë.

"Veç nesh, e gjithë bota e duan vendin e vet. Gjindja e këtushme s'ndjen dashuri për atdheun. Por, nëse nuk ndjejnë, duhet me i ba me ndie me përdhuni. Dikur ndër shqiptar, kishte shumë shkrimtar të zot. Ata e bën Shqipnin. Prandaj, duhet që ju të rinjtë, të punoni më shumë. Të flisni dhe predikoni pa u lodhur. Të shkruani pa pushim. Sidomos djem si ty që janë të zotë në këtë punë. Nuk ka rrugë tjetër… Duhet me e mbajt gjallë këtë Shqipni. Me i mbush mendjen të madhi e të vogëli, që ta përparojnë dhe begatojnë vendin e tyre", i tha Gaspër Tragaçi.

Hilushin zuri ta vriste ndërgjegjja.

Mos ndoshta ishte gabuar dhe e kishte gjykuar keq Gaspër Tragaçin kur kish menduar se, tek ai, nuk kishte as edhe një pikë të vetme dashurie për kombin?

Se, qëllimi i vetëm i atij njeriu ishte veç paraja?

Se…

Për para, Gaspër Tragaçi ishte i gatshëm të shiste jo vetëm atdheun por edhe të ëmën?

Nëse kishte gabuar, duhej ti kërkonte falje.

Ndërsa Hilushin po e torturonin kafshimet e ndërgjegjes, Gaspëri vazhdonte të fliste…

"Mbas luftës së madhe, kujtova se Shqipnija, do t'u makambte. Ti e din se mue, më mbushet mendja me zor.

Sidomos në këso punësh. E tash, po druhem se jam gabue".

"Nuk je gabuar aspak", nxitoi ta mbështeste Hilushi. "Hapat e para janë të vështirë por shumë shpejt edhe ne, do të hyjmë në udhën e përparimit".

"Ty të lumtë goja. Ishalla bahet si thue ti. Por unë druhem se kam ra brenda".

"Ç'kërkon të thuash? Në ç'mënyrë ke rënë brenda?", e pyeti i habitur Hilushi.

"Hajde e shif", ia ktheu Gasperi dhe i bëri me shenjë që Hilushi ta ndiqte.

U futën të dy në depon e shitores dhe ecën një copë herë mes rafteve të mbushura dëng me mallra. Në fund të depos gjendej një derë. Gasperi gjeti çelësin dhe e hapi. Hilushi u fut brenda dhe pa që dhoma ishte e mbushur deri në maj me qindra kuti kartoni. Gasperi grisi njërën prej kutive dhe me pamje të trishtuar, nxori që andej një flamur të kuq me shkabën e zezë dy krenare në mes…

Flamurin e Shqipërisë!

"E kupton tash përse të thash, se kam rënë brenda", i tha Gasperi dhe pastaj shtoi, "mendova se tash që shqiptarët fituan lirinë dhe u bën shtet, s'do të rrinte kush pa e ble një flamur. Por s'blen kurrkush. Më kanë mbetë pa u shitë. Dhe më beso, çmimin, mjaft ja kam ul. Gjynah me mbet pa u shit ky far malli. Shif ç'copë të mirë që ka", i tha Gasper Tragaçi dhe përkëdheli plot epsh pëlhurën e flamurit.

“Mos e prek me ato duar të ndyta!”, bërtiti befas Hilushi dhe ja rrëmbeu flamurin.

“Ç’pate? U çmende?”, bërbëliti Gaspëri i frikësuar.

“Bukur, besa, e paske mendue… Vuani urie ju shkrimtarë e poetë, por mos rrini pa shkruar e pa fol për atdheun se mua, s’po më shiten flamujt!”, tha Hilushi dhe…

Fundin e rrëfenjës së Ernest Koliqit nuk po e tregoj sepse, dëshiroj që vetë ta lexoni, por, ndërkohë, në këto ditë të mbushura me flamuj kuq e zi që valëviten qiejve, ju këshilloj të hidhni sytë rreth vetes dhe të shihni tregtarët e flamujve…

Letra higjienike, birra, fara kungulli, lule dielli, kompani telefonike, qumësht, dhallë dhe kos, të gjitha të mballosura me simbolin tonë kombëtar.

Shihni se si, nga ekranet e TV, gjatë këtyre ditë të futbollit evropian, në emër të dashurisë për kombin dhe simbolit kombëtar, bankierë dhe tregtarë të çdo lloji, që kurrë, kurrë nuk janë kujtuar të ndërtojnë një shkollë, muze apo bibliotekë, të financojnë krijimin e një gazete mbarëkombëtare apo qoftë të ndihin botimin e një libërthi të vetëm mbi historinë apo kulturën e popullit shqiptar, me qylaf në kokë dhe flamuj në duar, iu kërkojnë pa pushuar të firmosni kreditë tyre duke iu premtuar, se për hir të flamurit, do t’iu rrjepin lëkurën kaq apo aq përqind më pak. Gazeta dhe Televizione, që gjatë gjithë vitit i hapin dyert kanat më kanat, levandinëve që

propagandojnë ditë e natë, se flamuri dhe himni kombëtar janë paçavure, që sa nuk është vonë duhet ti zëvendësojmë; flamurin me ndonjë pëlhurë të qëndisur me ngjyrat e dylberit dhe himnin, me ndonjë këngë dashurie për ata që na kanë vrarë e grabitur, coptuar e dhunuar por kurrë nuk na kanë kërkuar falje, tashmë, në emër të flamurit kuq e zi, ju kërkojnë, ju urdhërojnë, të mos i hiqni sytë nga programet e tyre. Politikanë; përpara mëkateve ndaj atdheut të të cilëve, Gaspër Tragaçi duket i pafajshëm sa edhe një engjëll, që të krekosur me fanellat dhe simbolet kombëtare, ju kërkojnë, ju urdhërojnë, ti dashuroni, adhuroni dhe votoni…

Nëse, çdo shqiptar, të paktën një herë në jetën e tij, do të kishte lexuar rrëfenjën e Ernest Koliqit, nuk do të binte peng dhe as do të hipnotizohej nga kurthet e përditshme të tregtarëve modernë të flamujve.

Njësoj si Hilush Vilza i Ernest Koliqit, do të ngrinte kryet dhe do t'u thoshte…

**MOS E PREKNI ATË FLAMUR TË SHENJTË O SHUSHUNJA TË BABËZITURA!**

**JU NUK JENI TË DENJË PËR TË!**

**JU NUK MERITONI TË QUHENI SHQIPTAR!**

Por…

Për fatin e keq të Ernest Koliqit dhe të Shqipërisë, shqiptarët, lexojnë pak dhe harrojnë shumë…

Tiranë 17. 06. 2016.

# PAPAGALLËT E KATEDRALES SË DHËRMIUT

Në mëngjesin e 26 gushtit të vitit 2015, ora 5.10 min, nëpunësi i zyrës 34, Ministria e Jashtme Greke, kati tretë, korridori djathtas (*në krah të haleve*), u zgjua nga zilja e telefonit.

– Ç'është? Kush është? – pyeti nervoz nëpunësi i katit të tretë, korridori djathtas, zyra 34 (*në krah të haleve*).

– Jam unë!

– Kush unë?

– Nëpunësi 65! Roja i natës, – shpjegoi zëri.

– Çka ndodhur?

– Shqipëria na sulmoi!

– Shqipëria?

– Shqipëria! – pohoi zëri.

Nëpunësi i zyrës 34 fërkoi sytë.

“Pasi u bëmë gazi i Evropës edhe kjo na kish ngelur... Të sulmoheshim nga Shqipëria. Por… Ndoshta më mirë që ndodhi kështu. Nëse na pushton do të detyrohet të na paguajë edhe borxhet”, mendoi ngathtësi 34 teksa përpiqej të bindte veten të ngrihej nga shtrati.

Përfytyrimi i pushtimit të Greqisë nga Shqipëria, hë… Ashtu si patën bërë dikur gjermanët me tanke, më përpara akoma, turqit me taborë dhe romakët me legjione, e bënë të qeshte. Pastaj mendimi ju kthjellua…

“Ata mutër politikanë shqiptarë e vetmja gjë, që janë në gjendje të prodhojnë, janë emigrantët”.

Mllefin për prishjen e ëndrrës së bukur të pushtimit nga shqiptarët, nëpunësi 34 ja shfryu telefonit i bindur, që ai, që fliste përtej telit ishte çmendur.

– E ç’ë pastaj? Lajmëroni ministrin!

– Nuk mundemi.

– Atëherë kryeministrin.

– Keni harruar? – e pyeti zëri nga skaji tjetër i fillit, – Nuk kemi as ministër dhe as kryeministër. Kanë dhënë dorëheqjen në 20 gusht.

– Vërtet! – pohoi mendueshëm nëpunësi i zyrës 34. – Nuk kemi as ministër dhe as kryeministër. Ja përse ata trimat që qeverisin Shqipërinë paskan guxuar të na sulmojnë. Sulmojnë? Vërtet na kanë sulmuar?

– Për ju kemi dërguar një makinë. Tashmë do të ketë mbërritur, – u përgjigj zëri.

Lau sytë dhe doli në rrugë. Ca minuta më vonë, ndërsa përgjonte uturimën e motorit të makinës që nxitonte drejt rrugës e cila të çonte në ministri, pa e kuptuar pse, hapi gojën dhe shqiptoi ngadalë një shprehje të vjetër turke që e kish dëgjuar dikur nga gjyshja.

– Për hajër ishallah…

Nëse lajmi kishte diçka të vërtetë, qoftë edhe pakëz fare, më në fund, edhe atij, nëpunësit të harruar të zyrës 34 (*pranë haleve*), tanimë që Greqia nuk kishte as kryeministër, ministër, zëvendës e zëvendës të zëvendësit, do t'i jepej rasti të tregonte, se kush ishte dhe sa vlente. Edhe pse mëdyshas dhe pa ndonjë dëshirë, u betua që, do t'i nxirrte ujin e zi Shqipërisë. Mëdyshas dhe pa dëshirë sepse, gjyshja e tij, sa ishte gjallë, veç asaj shprehjes së vjetër turke, përdorte edhe ca fjalë të tjera që kur i dëgjonin, nën zë dhe disi të frikësuar, anëtarët e familjes mërmërisnin se ndoshta, ishin shqip.

"Pleqëria e ka marrosur", kujdesej të shpjegonte babai, thuajse sikur të ishte dëshmuar shkencërisht që marria dhe pleqëria, së bashku me sëmundjet, sillnin edhe mësimin e papritur të gjuhëve te reja dhe të çuditshme.

Në hyrje të ministrisë e priste nëpunësi 65 (*shefi i rojeve të natës*), një syresh i cili u prezantua si nëpunësi 57 dhe ca të tjerë që e përshëndetën së largu duke ulur kokat.

– Më zgjuan në mes të natës! – iu ankua 57 – e të mendosh që akoma nuk na kanë paguar rrogën e korrikut dhe…

– Ju jeni? – ia preu fjalën në mes 34.

– Shefi arkivit, – u përgjigj përultas 57 i frikësuar nga zëri autoritar i 34 dhe vetëm pas disa hapash në heshtje, ndoshta me shpresën që të fshinte nga kujtesa e tjetrit ankesat për zgjimin në mesin e natës dhe mos pagesën e rrogës së korrikut, duke treguar dosjen e trashë që mbante nën krahë, shtoi me një zell të papritur…

– Kam gjithçka këtu. Njoftimet nga terreni. Çfarë ka ndodhur. Kur dhe si ka ndodhur.

Në zyrë, mbi tryezën e shkrimit, veç dosjes që i tregoi 57, ishin radhitur edhe 7 dosje të tjera.

– Dosjet e Shqipërisë. Nxora ato më kryesoret, – shpjegoi 57, – nëse keni nevojë për plotësime dhe hollësira të mëtejshme kam edhe të tjera. Shumë të tjera. Mjaft që të më thoni dhe unë…

– Më trego shkurtazi se çfarë ka ngjarë, – e urdhëroi prerë 34.

Rrëfimi i tjetrit e zhgënjeu.

Qeveria shqiptare kishte prishur kishën e një fshati të quajtur Dhërmi. Një ngrehinë të vogël prej tullash dhe betoni të ngritur në fillim të viteve 90. Shkatërrimi kishte ndodhur natën. Diku rreth orës katër të mëngjesit.

"Përse natën?", pyeti veten 34, "Si të ishin banditë dhe jo shtet! Kishin frikë? Nga kush? Ai fshat sipas të dhënave nuk ka më shumë se disa dhjetëra banorë. Të gjithë, pleq dhe plaka. Të rinjtë e kanë braktisur fshatin që në fillim të viteve 90. E mbi gjithçka, përse e prishën kishën? Aq më

tepër kur e dinin se çdo të ndodhte më pas… Çfarë do të ndodhte? Ajo që kish ndodhur edhe ca herë të tjera. Kryepeshkopi grek i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare do t'i ankohej shtetit grek dhe shteti grek i vetëshpallur mbrojtës i Kishës Ortodokse Shqiptare, do të kërcënonte shtetin shqiptar. Kërcënimet në kohë kishin qenë të ndryshme. Përqendrime të reparteve të ushtrisë greke pranë kufirit të Shqipërisë. Mbyllja e kufirit. Organizimi i operacioneve policore të emëruara me nofkën përçmuese "Fshesa" që zbonin me mijëra emigrantë shqiptarë përtej kufirit verior të Greqisë.

Të gjitha këto, kurorëzoheshin gjithmonë me atë…

Qershinë mbi tortë. Ankesën në Bruksel. Akoma pa mbërritur ankesa në Bruksel, burokratët, që mbushnin zyrat e Bashkimit Evropian, do t'i tërhiqnin veshin qeveritarëve shqiptarë dhe këta, fajtorë apo jo, do të nxitonin t'i kërkonin falje shtetit grek dhe do të mbyllnin gojën.

Kur e dinin se ç'do ngjante më pas, përse e bënë? Një qëllim e kishin pasur dhe ky, sigurisht nuk lidhej aspak me arsyen se kisha ishte një ndërtesë e paligjshme siç ndoshta do të këmbëngulte qeveria shqiptare. Shqipëria gëlonte nga ndërtesat e paligjshme. Ç'punë i prishte qeverisë shqiptare kisha e vogël sa një kotec e një fshati të humbur të quajtur Dhërmi?"

Mungesa e një arsyeje bindëse e cila të shpjegonte përsenë e prishjes së kishës së Dhërmiut nga shteti

shqiptar, e shtyu nëpunësin 34 të mendonte, që pas prishjes së kishës, fshihej diçka tjetër.

Çfarë? Këtë nuk e dinte por …

Shfletoi buletinin informativ mbi Shqipërinë dhe nuk vuajti për të zbuluar atë që kërkonte…

"***Piloti i një helikopteri të ngarkuar me drogë në Shqipëri, arrestohet në brigjet Italiane***". "

***"Oficerë të lartë të policisë shqiptare, të lidhur me trafikun e drogës***".

"***Mijëra qytetar shqiptarë kërkojnë çdo muaj, azil ekonomik në Gjermani***".

"***Gjermania kërcënon rivendosjen e regjimit të vizave për shqiptarët***".

"***Në samitin e Vjenës, kryeministri shqiptar tregon barcaleta***".

Hë! Ndërsa faqet e para të gazetave shqiptare ishin zënë nga lajmi i prishjes së kishës, me tone epike, sikur të bëhej fjalë për ndonjë betejë, gazetarë, opinionistë, profesorë e doktorë, çula e papaçula të të gjitha llojeve dhe ngjyrave, lëvdonin guximin e qeverisë shqiptare që…

I KISHTE THYER HUNDËN GREQISË!

Nuk i duhej të lexonte më tepër për të kuptuar se ç'ishte ajo, "diçkaja tjetër", që qeveria shqiptare kishte kërkuar të fshihte mbas tymnajës që do të ngrinte prishja e kishës kotec të Dhërmiut.

Ata, qeveria greke, kishin 20 vjet që për ti fshehur qytetarëve greminën ku po rrëshqiste vendi, ngrinin

tymnaja historish mbi shqiptarët gogola që po pushtonin apo komplotonin për pushtimin e Greqisë. Për ushtri fantazma, që synonin të çlironin Greqinë e veriut (*shqiptarët e quanin Çamëri*) apo organizata të paqëna që thurnin plane për krijimin e Shqipërisë së Madhe.

– Kripa është e dëmshme, por pa të, gjella nuk ka shije. Për të çoroditur ndërgjegjen e turmave, tymnajat me një grusht patriotizmi brenda, janë gjithmonë ato më të mirat, – i pohoi vetes 34 dhe u përfshi nga një ndjenjë keqardhjeje dhe mirëkuptimi ndaj kolegëve të tij shqiptarë.

Keqardhjeje sepse…

Jo të gjitha shteteve u lejohej të përdornin patriotizmin për të gënjyer turmat. Turmat? Tingëllon keq! Le të themi popullin. Shqipëria hynte në listën e atyre që nuk i lejohej. Dhe jo pa arsye…

Në dy shekujt e kaluar, për të shpëtuar ekuilibrin politik të kontinentit, fuqitë e mëdha evropiane e ndanë Shqipërinë në dy pjesë. Pastaj në tre, katër, e në fund në pesë pjesë. Patriotizmi, qoftë edhe një pikëz, mund të derdhte gotën e durimit, t'u kujtonte shqiptarëve padrejtësinë që u ishte bërë dhe zot na ruaj se ç'mund të ndodhte më pas. Ekuilibri i Evropës do të prishej dhe burokratëve, që flinin në Bruksel, Paris, Londër, Vjenë, Moskë e Berlin do t'u prishej gjumi. Kjo ishte arsyeja që politikanëve shqiptarë, para se të bëheshin qeveritarë, iu bëhej e qartë se, nëse donin të qeverisnin atë që kishte

ngelur nga vendi i tyre, duhej t'i qëndronin patriotizmit, nacionalizmit; quaje si të duash, larg po aq sa djalli temjanit. Për ta nacionalizmi ishte i ndaluar sa edhe fryti i pemës së diturisë për Adamin. Dhe, gjithkush e dinte se ç'i ndodhi Adamit kur "harroi" urdhrin e Zotit dhe guxoi të shijonte frytin e pemës së diturisë…

Zoti e dëboi nga parajsa dhe ky, me hallate në duar mori udhën e emigrimit. Nga ana tyre, nuk mundej ta mohonte, politikanët shqiptarë ishin treguar gjithmonë burra të mençëm. Ndryshe nga Adami, kishin zgjedhur të mos kundërshtonin Zotin, të shijonin të mirat e parajsës dhe të dërgonin popullin e tyre me hallate në duar rrugëve të emigrimit.

Siç përmendëm, ndjenja, që në rrjedhën e mendimeve të nëpunësit 34 ndoqi atë të keqardhjes për kolegët e tij shqiptarë, ishte ajo e mirëkuptimit.

"Ne e kemi përdorur popullin e tyre, "shqiptarët gogola" që kërkojnë të pushtojnë Greqinë me mijëra herë, për të shpëtuar nga hallet. Nuk u bë nami se edhe shteti shqiptar, guxoi të na përdorë ne, një herëz të vetme. Guxoi… Mjeranët… Pritën që Greqia të mos kishte qeveri, e pastaj guxuan. Ndoshta nuk e dinin, që me apo pa qeveri, nëpunësi 34 është gjithmonë në llogore. Sigurisht, mundem t'i fal… Nëse tregohen të sinqertë dhe më thonë… I nderuari 34! Nuk kishim rrugë tjetër… Donim të mbulonim të pëgërat tona dhe s'dinim si të bënim ndryshe… Lutemi të na falësh! Nuk do ta përsërisim më!"

Zhurma e mërmëritjeve e shkëputi nga mendimet.

34 vëzhgoi me kujdes fytyrat e përgjumura të nëpunësve dhe ju drejtua njërit prej tyre.

– Ti! Lajmëro Presidentin!

– Ora eshte 6.45,– vërejti me mëdyshje nëpunësi.

– E pastaj?

– Ndoshta presidenti është akoma në gjumë! Ta zgjoj?

– Jo! Prit që të zgjohet dhe pastaj lajmëroje,– tha 34 dhe u kthye nga të tjerët.

– Ti! Kryetarin e parlamentit.

– Ti! Kryepeshkopin.

– Besoj se u kuptuam? Vetëm kur të zgjohen!

– Kurse ti! Thërrit ambasadorin shqiptar. Hë! Këtë zgjoheni edhe nëse është në gjumë!

Kur ngeli vetëm, 34 vendosi të rilexonte përshkrimin e ngjarjes, që punonjësi i terrenit 102/22, kishte dërguar, nga Dhërmiu.

"… rreth mesditës, me arsyen se kërkonin të ndiznin ca qirinj dy të panjohur i kërkuan çelësat e Kishës të moshuarës M.Gj. Kjo, e moshuara M.Gj, duke kujtuar se ishin bij të fshatit, emigrantë që kthehen në fshat për pushimet e verës, por edhe sepse kishte gjellën mbi zjarr dhe frikësohej se mos i digjej, u dorëzoi çelësat dhe nuk i shoqëroi ashtu siç bënte ngaherë. Njëzet minuta më pas, M.Gj, e shqetësuar që dy të panjohurit nuk ishin kthyer për ti dorëzuar çelësat, del nga shtëpia dhe sheh dhjetë

apo njëzetë burra që po prishnin traversat prej betoni të Kishës.

"Ç'po i bëni Qishës mor maluketër!", bërtiti M.Gj.

"Kemi urdhër nga lart!", i përgjigjet njëri nga përdhunuesit (*kështu i quajti M.Gj kur më rrëfeu ngjarjen*).

M.Gj i kërcënon përdhunuesit e qishës me bastun dhe jep alarmin.

– Ngrihuni! Po na prishin Qishën! – bërtiste pa u ndalur M.GJ.

Pak minuta më vonë (*fshati është i vogël*), banorët, dhjetë a pesëmbëdhjetë (*më i riu ndër ta është 65 vjeç*), armatosur me tiganë, garuzhde, kallama, thupra thane dhe tufa hithrash, hidhen në sulm për të mbrojtur Kishën. Përdhunuesit e panjohur, i hipin makinave (*pa targa*) dhe largohen të frikësuar nga sulmi. Banorët vendosin të bëjnë roje rreth Kishës, por në mbrëmje lodhja i mposht, dhe kush për shkak të fryrjes së prostatës, dhimbjes së veshkave, rritjes së presionit të gjakut e arsye të tjera fiziologjike, kthehen në shtëpi për të pushuar. Nuk mundën të flenë gjatë sepse, në mëngjesin e ditës së sotme, me shumë gjasa rreth orës 04.00, u zgjuan nga një zhurmë e pazakontë për qetësinë e një fshati të vogël si Dhërmiu. Dalin nga shtëpitë. Kisha ishte shndërruar në një gërmadhë mbi të cilën përdhunuesit kishin vendosur ikonën e Zotit tonë Jezu Krishtit. Meqë s'kishin ç'të ruanin më, kisha tashmë ishte shkatërruar, u kthyen në shtëpi dhe fjetën. Me respekt etj, etj…"

– Lexojeni! – i bërtiti nëpunësi 34 dy të dërguarve të shtetit shqiptar dhe i hodhi përpara raportin mbi ngjarjen e Dhërmiut.

– Kjo është fyese, – mërmëriti i pari në gjuhën greke.

– Po! Fyese! – përsëriti i dyti në gjuhën angleze dhe fërkoi me dashuri kravatën me koka papagajsh shumëngjyrësh, sikur kjo, kravata të ishte një relikte e shenjtë që mrekullisht do të zhbënte telashin e prishjes së kishës.

34, me gjithë informacionin e bollshëm që punonjësit e terrenit si 102/22 dërgonin nga vendi fqinjë, nuk ishte në dijeni, që kravatë papagallsit i pëlqente të mburrej, se një kravatë të ngjashme me të tijën, mbante hera–herës edhe kryeministri i Shqipërisë.

– Jeni sjellë si banditë! As më pak e as më shumë! Banditë kokë e këmbë!

– Ju po vazhdoni të na fyeni! – tha i pari në gjuhën greke.

– Në vendin tonë ne, bëjmë ç'të duam, – shtoi i dyti në gjuhën angleze.

– Pikërisht! – pohoi 34 dhe kur ndeshi me vështrimet pyetëse të dy të dërguarve të shtetit shqiptar shtoi…

– Kjo shpjegon se përse qytetarët tuaj marrin arratinë nga Shqipëria dhe bëjnë gjithçka për tu bërë grekë, italianë, gjermanë, eskimezë. Të jenë gjithçka tjetër përveçse shqiptarë.

– Protestoj! Ju po fyeni shtetin shqiptar!– tha i pari në greqisht.

– Po,po! Edhe unë protestoj! – tha i dyti në anglisht.

"Po të kishin me vete një të tretë… Ky… Hë! Pa dyshim që do t'më fliste italisht apo gjermanisht. Flasin ç'do gjuhë veç asaj të tyres. Tamam papagaj!", mendoi i argëtuar 34 me vështrimin e ngulur tek kravata e shndritshme me koka papagajsh e të dërguarit të shtetit shqiptar.

– Ju kërkoni të ndërhyni në punët tona të brendshme, – tha i pari që mori guxim nga heshtja e 34.

– Ju e dini se ç'do të thotë kjo?– e pyeti 34.

– Kjo çfarë? – pyetën njëzëri në greqisht dhe anglisht të dërguarit e shtetit shqiptar.

– Të ndërhysh në punët e brendshme të një shtetit tjetër, – shpjegoi 34.

– Sigurisht! – tha i pari në greqisht.

– E dimë! Si nuk e dimë! – tha kravatë papagallsi në anglisht.

– Atëherë duhet të dini edhe se sa përqind e banorëve të fshatit… Si quhej? Ah po! Dhërmi… Ka marrë shtetësinë greke? Oh! Jo! Mos më shihni ashtu. Nuk ja kemi dhënë shtetësinë greke me zor. Na e kanë kërkuar. Madje na janë lutur. Përgjëruar…

I pari kërkoi diçka në një çantë prej lëkure, fshiu djersët, kërkoi sërishmi dhe pastaj, i dëshpëruar, pa nga i dyti.

– Ç'më sheh mua o derëzi! Ti e di, unë, një vit kam që punoj në ministri. Nga ky, tetë muaj kam qenë në fushatë të mblidhja vota për partinë, – iu përgjigj shikimit të tjetrit, kravatë papagallsi, në një gjuhë të pakuptueshme për 34.

"Më në fund folën shqip", mendoi 34 dhe pasi priti një copë herë për të shijuar deri në fund hutimin e dy kolegëve shqiptarë, u hodhi përpara një letër.

– Lexojeni!

– Po ata janë shqiptarë, – tha me gjysmë zëri i pari.

– E di! – ia ktheu i qetë 34 – Por ju… Ju dhe shteti që përfaqësoni, i keni detyruar të bëhen grekë. Ashtu si keni detyruar të tjerët të bëhen gjermanë, italianë, francezë. Madje edhe ju vetë, nëse nuk gabohem…

34 vështroi një tjetër shkresë dhe pastaj shtoi…

– Nuk jeni shqiptarë!

– Ju keni shtetësinë amerikane,– iu drejtua 34 të parit.

– Kurse ju, prit… Ah po… Ju jeni kanadez, – i tha 34 me një buzëqeshje ironike kravatë papagallsit.

– Pra si të themi, – vazhdoi 34, – ky nuk është më, një takim mes tre kolegëve, dy shqiptarë dhe një grek, por një takim ndërkombëtar. Le të flasim pra, siç flitet në takimet ndërkombëtare, hë… Me arsyen e pastruar nga hidhërimet e të shkuarës dhe jo siç e kemi zakon ne ballkanasit.

Të dërguarit e shtetit shqiptar ulën kokat në shenjë miratimi.

– Si mendoni, – vazhdoi 34, – nëse unë dërgoj në Bruksel këtë dokument mbi përqindjen e shtetasve grekë që banojnë në Dhërmi, kujt do t'i japi të drejtë Brukseli? A do ta quaj ankesën e Greqisë ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë?

– Ndoshta jo, – tha i pari në greqisht.

– Mos ta shndërrojmë në tragjedi. Ta zgjidhim mes nesh, – tha kravatë papagallsi në anglisht me një ton mirëdashës kafenesh.

– Ju na thoni se ç'duhet të bëjmë dhe ne do ta bëjmë, – vazhdoi i pari në greqisht.

– Do ta bëjmë, – miratoi kravatë papagallsi në anglisht.

– Në vend të atij kotecit që e quanin Kishë, do të ngremë një të vërtetë. Me kullë, kryq, kambanë e ikona. Me oborr dhe po të doni, edhe me një shkollë ku të rinjtë të mësojnë gjuhën e tyre. Kë gjuhë? Oh ç'të doni ju! Greqisht, anglisht, gjermanisht…

– Të rinjtë? Çfarë të rinjsh? Aty nuk kanë ngelur të rinj, – mërmëriti trishtueshëm 34.

– Meqë s'ka të rinj, në vend të shkollës, ngremë një shtëpi kulture për pleq e plaka, – propozoi i pari në greqisht.

– Le të mësojnë edhe ata ndonjë gjuhë të huaj, – plotësoi kravatë papagallsi në anglisht.

– Të argëtohen, – korrigjoi i pari në greqisht.

– Pse të mos argëtohen, – shtoi në anglisht kravatë papagallsi. – E meritojnë. Kanë punuar gjithë jetën. Ta shijojnë pensionin që shteti juaj aq bujar dhe fisnik…

– Sa për kishën, – nxitoi të ndërhynte i pari që ngjau se nuk i pëlqeu ajo përmendja e pensioneve që merrnin pleqtë dhe plakat e Dhërmiut…

– Për atë Zot! Me dy apo me tre kate do ta bëjmë kishën. Si hotel me pesë yje do ta bëjmë,– u betua në anglisht kravatë papagallsi.

– Jo po katedrale, – mërmëriti i zymtë nëpunësi 34.

– Po! Shumë e drejtë! Do të ndërtojmë në Dhërmi një katedrale, – miratoi greqisht i pari.

– Katedrale o posi, – tha në anglisht kravatë papagallsi.

"Mjeranët! I mjeri popull…", mendoi 34 dhe me vështrimin e ngurosur tek kokat e prera të papagajve shumëngjyrësh që stolisnin kravatën e të dërguarit të shtetit shqiptar, ju kujtua një nga ato shprehjet e gjuhës së pakuptueshme që fliste gjyshja….

Zoti na shpëtoftë!

Tiranë, 30 gusht 2015.

## EVROPA DHE GREQIA...

(*historia e një dashurie të tradhtuar*)

Evropa i kërkon Greqisë të paguajë borxhin.

Greqia i tregon bërrylin dhe i thotë, "hip këtu të shohësh Stambollin".

Evropa nguron…

Dikush thotë, se Evropa ka frikë t'ia "hipi" Greqisë, qoftë edhe mbi bërryl.

Dikush tjetër këmbëngul që, Evropa nuk i frikësohet edhe aq "hipjes" mbi bërrylin e Greqisë sesa përballjes me vështrimin e Stambollit.

Përse?

Përgjigja është e thjeshtë...

Për hatrin e Greqisë, Evropa është grindur me Stambollin.

Hë…

Jo vetëm me Stambollin.

Për t'i bërë qefin Greqisë, Evropa, më shumë se një herë ka pështyrë Maqedoninë dhe përbuzur Shqipërinë. Madje, i ka tërhequr veshin edhe Bullgarëve dhe Rumunëve. Çfarë s'ka bërë thuaj…

Ç't'i kërkonte Greqia, ajo ia jepte.

Nëse Greqia nuk kënaqej, i jepte edhe më.

Evropa mbylli sytë edhe veshët kur Greqia e tradhtonte me Serbinë e kasapit Millosheviç[1]. Zemra i dhembte e shpirti i përvëlonte, por s'bënte zë. Në vend që të ankohej, ashtu si të gjithë të dashuruarit përpiqej ta shfajësonte. Boshnjakët myslimanë vdisnin si miza nën breshërinë e predhave të artilerisë serbe të bekuar nga dhespotët grekë…

E ça pastaj?

Ç'faj kishte Evropa, që ata, boshnjakët myslimanë kishin zgjedhur të jetonin në mes të krishterëve?

Nuk mund të prishej me Greqinë vetëm për ca boshnjakë më pak a më shumë.

Koha është mikja më e mirë e të dashuruarve, dhe asaj kohe, Evropa e dashuruar pas Greqisë, në vend që ta shante dhe ta quante tradhtare, zgjodhi të priste. T'i paguante drekat dhe darkat, hotelet dhe motelet ku Greqia e Papandreut dhe Micotaqit[2] ndërzehej me Serbinë e Millosheviçit, me shpresën se ndoshta një ditë, Greqia do të mërzitej nga Millosheviçi dhe gjithë "viçat" e tjerë që thurnin ëndrrën e marrë të rilindjes së një perandorie serbo-greke që do të sundonte Ballkanin si në kohërat e Perandorisë Bizantine apo asaj të Stefan Dushanit[3] dhe do të kthehej tek ajo…

Tek dashuria e vjetër. Tek Evropa. Kokulur si djali plëngprishës i Biblës. Do t'i kërkonte falje dhe pranonte gabimin.

Greqia jo vetëm që nuk e pranoi gabimin por…

Tani mjaft! E teprove! Paguaj borxhin! – çirret Gjermania

– Të dhamë sa deshe. Të plotësuam ç'do dëshirë dhe tani na tregon Stambollin, – shton pastaj cazë e frikësuar se mos ndoshta, për inat të saj, Greqia është bërë vërtet mike me Turqinë.

– Greqia na e dredh me Turqinë? – ç'thoni moj motra? – ia pret Luksemburgu me gjysmë zëri, i frikësuar se mos Greqia e dëgjon dhe i bën gjëmën, – Greqia e urren Turqinë. Aq shumë, sa na shtyu edhe ne ta urrejmë. Madje edhe mua që s'kam parë kurrë turk me sy.

– Nuk e ka për herë të parë, – ia kthen me dyshim Spanja.

– Atë shprehjen që thotë, "pranoj më mirë të mbarsem nga çallma e turkut se nga kësula e papës", grekët e kanë nxjerrë, – hyn në bisedë Italia.

– A thua të na e ketë dredhur me Turqinë? Nuk i mjaftoi Serbia e Millosheviçit? Zuzarja! Prit ndonjë ditë kur të na sjellë në shtrat edhe Kinën, Indinë apo kushedi kë tjetër, – shfrynte xheloze Evropa e dashuruar.

Gabohej!

Greqia, ashtu si me të drejtë dyshonte Evropa, vërtetë e kishte tradhtuar, por jo me Turqinë…

– Greqi! Paguaj borxhin të thashë! – e urdhëron rreptë Gjermania

– Lavire, – shton Franca thuajse me dashuri.

– T'më merrni pleshtat! Borxhin harrojeni,– tallet Greqia.

– Moj ti! – e kërcënon Gjermania dhe turret ta kapë.

Por, se kap dot. Greqia vrapon dhe ulet në prehrin e Rusisë që ngre dorën dhe i bënë shenjë Gjermanisë të ndalet.

– Asnjë hap më tutje, – thotë Rusia.

– Hë moj Rusi, – i lutet Gjermania.

– Hë moj xhane, – shton Franca dhe bën një hap prapa duke i shkelur syrin.

Të gjithë vështrojnë Gjermaninë dhe presin në heshtje se ç'do të bëjë.

Simpatia e ndërsjellë që lidh Francën me Rusinë nuk është e panjohur për askënd. Ama, dikur ka qenë më shumë se simpati. Është e vërtet, shumë ujëra kishin rrjedhur nga koha kur Franca dhe Rusia dashuroheshin, por ai, dyshimi brejtës se mos ndoshta, zjarri i dashurisë së vjetër ndizej rishtazi, nuk e linte të qetë Gjermaninë edhe pse, tashmë, Franca kishte më shumë se gjysmë shekulli që flinte në një shtrat me të. Ja përse ajo shkelje syri i dhembi në zemër Gjermanisë.

– Lavire, – mërmëriti Gjermania.

– Kush, Greqia? – e pyeti Franca dhe në sy i shkëlqeu një dritë e frikshme.

"Ti! Ti je lavire! Lavire e shkuar lavires! Baxhellë e karaputanë!", dëshiron t'i ulërijë Gjermania, por hesht e

nga goja nuk nxjerr zë. Përtyp të sharat, mllefin e pështymën dhe i ngul sytë Rusisë.

– Lëshoje Greqinë se ajo është e jona, – i thotë e vrenjtur Gjermania.

– Mos e ngri zërin se nuk më tremb, – ia kthen Rusia.

– E di që s'të tremb, – i përgjigjet Gjermania, kësaj radhe me zë të butë.

– Ju më lëshoni Ukrainën dhe unë iu lëshoj Greqinë, – propozon Rusia.

– Ukrainën ta lëshojmë… – përgjigjet me mëdyshje Gjermania.

– Ç'na bëhet vonë për Ukrainën, – ia ndërpret fjalën në mes Franca.

– Ta lëshojmë! Si s'ta lëshojmë, – miraton plot zell Spanja.

Gjermania vështron me inat Francën dhe Spanjën dhe shton…

– Problemi nuk është Ukraina, por…

– Por..., – përsërit Rusia.

– Se ç'do të kërkosh pas Ukrainës. Kush na garanton që, le të themi nesër, nuk do të kërkosh edhe Bullgarinë, Rumaninë, Çekinë, Polon…

– Askush! – përgjigjet qetësisht Rusia.

Poloninë e zënë të dridhurat dhe kërkon me sy Britaninë.

– Mos ki frikë se më ke mua, – përpiqet ta qetësojë Gjermania, por, këto fjalë, në vend që ta ndihin, e bëjnë

Poloninë në fillim të zverdhet e pastaj të zbardhet si kufomë.

Nuk ka faj mjerania. Gjysmë shekulli më parë, Rusia dhe Gjermania e ndanë në dysh dhe pastaj hop, secila gëlltiti nga një copë.

Kujtimi i të shkuarës i moleps të gjithë si një sëmundje e keqe. Bullgaria dhe Hungaria vështrojnë me inat Rumaninë. Çekia nënqesh plot ironi me dashamirësinë e Gjermanisë për Poloninë. Italia i hakërrehet Kroacisë dhe kjo në shkëmbim i tregon turpshëm gishtin e mesit.

– Ah ç'na bëre moj Greqi! – rënkon Gjermania.

– Bëni ç'të doni borxhet nuk i kthej, – çirret Greqia nga prehri i Rusisë.

– Nëse Greqia nuk paguan, as unë nuk paguaj, – thotë e strukur në një cep Portugalia.

– Nëse Greqia dhe Portugalia nuk paguajnë borxhet, as unë… – fillon të flasë Italia por Gjermania e ndërpret.

– Greqia do t'i paguaj borxhet deri më një! Mos më thënçin Gjermani. Do ta shihni se çfarë do ti punoj nesër.

Të gjithë heshtin dhe presin të nesërmen…

Tiranë, 06.07.2015.

**1. Sllobodan Millosheviç. Politikan Serb. Ideator, frymëzues dhe përgjegjës kryesor, i luftërave, masakrave dhe gjenocidit që shteti serb kreu në Bosnje dhe Kosovë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të XX. President i Republikës Socialiste të Serbisë.**

**President i Republikës së Serbisë. President i Republikës Federale të Jugosllavisë.**

**2. Politikan grek, mbrojtës dhe përkrahës të Sllobodan Millosheviçit dhe shtetit Serb e Jugosllav nga ky të qeverisur.**

**3. Në postin e Mbretit të Serbisë ( 1331 –1346), Stefan Dushani, shfrytëzoi dobësinë e Perandorisë Bizantine *(të shkaktuar nga luftërat me turqit otoman dhe kriza e brendshme politike*) për të pushtuar territoret perëndimore të saj dhe të shpallej "Perandor i serbëve dhe i romakëve" (1346 –1355). Mbas vdekjes së Dushanit, e ashtuquajtura "perandori serbe" u shkatërrua po aq shpejt saç edhe ishte krijuar.**

## SIKUR ME PAS FOL SOT, FAIK KONICA...

(*pasqyra e ministrit*)

Dutmu Butmu, Ministri i Punëve të Jashtme i Mbretëri…, Republikës së Zululandit, rregulloi mbi hundë syzet e arta, rrudhi ballin, shtrëngoi vetullat, rrahu qerpikët njësoj ashtu siç rreh krahët një dallëndyshe e plagosur, dhe…

U vështrua gjatë në pasqyrë.

Kështu bënte ngaherë kur problemet e shumta dhe aq tepër të koklavitura që mbarte posti i lartë i Ministrit të Punëve të Jashtme i Republikës së Zuluve e detyronin të mendohej. E për dreq, këta, zulutë, populli i tij që mos qoftë, ishin të bindur se të tjerët, i kishin bërë në të shkuarën aq shumë padrejtësi sa atij, i duhej të shihej në pasqyrë të paktën për nja shtatë apo tetë orë në ditë.

Shihej në pasqyrë kur hante, kur pinte, kur dhjen..., kur udhëtonte me avion, kur takohej me ministrat e shteteve të tjera.

Shihej në pasqyrë, buzëqeshte, shtrëngonte duar sa në të majtë e në të djathtë dhe pastaj, përsëri buzëqeshte e shihej rishtazi në pasqyrë duke medituar gjatë nëse kishte buzëqeshur ashtu siç duhej.

– Ç'kërkojnë nga unë më shumë se kaq – i shfryu ministri plot mllef vetvetes në pasqyrë.

– Përse më bien në qafë?

– Më kërkojnë të mendohem përpara se të flas!

– E ku ta gjej unë kohën për tu menduar?

– Ngrihem nga gjumi. Ha mëngjesin që mos e ngrënsha në gënjej, mbasandaj, vrap e tek estetisti. Nja dy orë më duhen, ndryshe, si do ta kisha një lëkur të tillë, – bërbëliti ministri dhe i hodhi një vështrim të kënaqur pasqyrës.

– Si byçkë fëmije e kam. Ama, nuk është e lehtë. Duhen masazhe, kremra, maska me baltë nga deti vdekur, të tjera me leshterik nga deti kuq, dhe orë të tëra para pasqyrës. Në Bruksel, Strasburg, Vjenë dhe Londër, lëkura ime është legjendë. Të gjithë ma lëvdojnë. Kurse... Këtu në Zululand, askush nuk e përmend. Përse nuk ndihen krenarë për lëkurën time që e gjithë bota ma lëvdon, por më kërkojnë të zgjidh probleme të paqena?

Zulutë që braktisnin atdheun…

Zulutë që asimilohen…

E ku qëndron problemi këtu?

Ku ka më mirë që Zulutë emigrojnë dhe asimilohen? Kështu qytetërohen dhe mësojnë të admirojnë vlerat e vërteta të qytetërimit… Lëkurën si e imja, kostumet me të cilat unë, i përfaqësoj këta mosmirënjohës aq denjësisht në botë, mënyrën se si qesh, shtrëngoj duart, nënshkruaj marrëveshjet. Meqë ra fjala tek kostumet, në diplomaci, kostumet janë themelore dhe për të zgjedhur stofrat e duhura që të shkojnë me ngjyrën e lëkurës dhe atë të syve,

duhen orë të tëra studimi. Të shfletosh revista pas revistash dhe pasi të gjesh stilistin e duhur për ty, atë më të famshmin e momentit, duhen bërë prova pas provash. Si mund të shkosh në një takim ndërkombëtar i veshur me kostumin e dikujt që nuk e ka emrin në faqet e para të revistave të modës? Të gjithë do të qeshin me ty. E për më tepër, me namin e keq që kanë Zulutë, populli im që mos qoftë. Kostumi, kravata, lëkura, flokët (*ah flokët…*), bëjnë diferencën. Të gjithë të shohin dhe thonë me vete, "këta zulutë nuk qenkan dhe aq zulu sa ç'thuhet. Shiko ç'stil, ç'sharm e ç'buzëqeshje! Ky ministër, edhe pse zulu, nuk duket aspak ashtu,siç thuhet se janë zulutë… Të egër, barbarë dhe të pa ditur. Dëgjoni se sa bukur e me ç'elegancë e flet anglishten, frëngjishten, italishten. Dikush madje, atje në Bruksel, apo, ndoshta në Paris, teksa më lëvdonte për aftësinë me të cilën flisja gjuhët e popujve të qytetëruar, kostumin dhe kollaren që më shkëlqenin mbi trup, më rrëfeu për një pasha zulu që ashtu si unë, e kishte mahnitur parinë e kryeqyteteve të Evropës me aftësinë që kishte për të folur gjuhët e huaja, pendët me të cilat stoliste qylafin, koleksionin e uniformave që i ndërronte sa herë shfaqej në publik, aq sa, nuk ngjante fare si Zulu.

"Njësoj si ju… Pastaj, nuk e di se përse, një tjetër zulu e vrau", i kishte thënë ai dikushi dhe i rrahu shpatullat.

"Eh!", psherëtiu ministri, "Një burrë të tillë, zotëri burrë, që bota e donte aq shumë… Me gjuhë të huaja, sharm, stil e gjithë të tjerat… Domosdo që përfundoi i

vrarë nga një zulu. Ne zuluve (*që mos qofsha*), nuk na e kanë fajin të tjerët. Jemi gjëma e vetvetes. Si quhej ai pashai? Mmm! Më ngjan Esit apo Esat, diçka e tillë… Duhet t'ia shënoj emrin dhe të llafos me shefin e madh që t'i ngremë një shtatore".

Befas, në rrugën poshtë ndërtesës së ministrisë, u dëgjua një britmë ankthi, pastaj, një sërë krismash. Ndoshta një breshëri automatiku…

"Fishekzjarrë!", mendoi ministri pa i hequr sytë nga pasqyra.

"Rrugaçët! Nuk pushojnë së harxhuari paret duke blerë fishekzjarrë dhe pastaj, ankohen që nuk kanë me se të blejnë bukë! Ehh këta zulutë! Si të bëjmë me ta? Nuk pushojnë së ankuari! Njëherë, që s'kanë bukë dhe njëherë tjetër, që s'kanë punë. Në Evropë, njerëzia ëndërron të qëndrojë në shtëpi, përpara Tv pa bërë asgjë hiç, kurse këta, dashkan punë. Ankohen se gjoja dikush, iu rrëmben vajzat dhe i shet si skllave rrugëve të Evropës dhe pastaj, i harrojnë vajzat dhe thonë, se ky dikushi, po iu vjedh historinë, dhe shteti, nuk bën asgjë për ti mbrojtur. I gjithë ky zullum, për ca poçe e gurë të vjetër… Po i vjedhin historinë! Ngordhi bota për historinë e Zuluve! Ç'histori zeza? Ca banditë e ca kusarë që bridhnin sa andej këndej mbi kuaj. Ne ngremë pallate kurse këta, akoma tek gurët e gjyshërve. Dhe… Kësaj radhe…"

– Për besë që kësaj radhe, më ranë në qafë së koti, – i foli ministri pasqyrës.

– Më beso, krejt së koti.

– Ngritën krye sepse thashë, "PARTINË E DUA MË SHUMË SE ATDHEUN".

– Më thuaj o pasqyrë, ku qëndron problemi këtu? Se, ja… Gjyko ti vetë… Ç'më ka dhënë atdheu mua? Asgjë prej gjëje. Kurse Partia… Partia më bëri ministër. Më thuaj, ç'do të isha unë, nëse, nuk do të ishte Partia? Një hiç, ja se ç'do të isha. Ndoshta do të shisja banane ose fiq, apo, e shumta, do t'më shkonte jeta duke punuar si përkthyes i të huajve që vijnë në Zululand për të bërë ahengje dhe gjuajtur kafshë të egra. Pastaj, ç'është ky atdheu, që duhet ta dua më shumë se Partinë?

Në Parti i njoh të gjithë… Horrin, Morrin, Qorrin… Konen dhe Bolen. Pallën dhe Shalën. Dhe, të gjithë më njohin mua. E përse u dashka ta dua atdheun, që e përsëris, s'më ka dhënë gjësendi, më shumë se këta?

"Vërtet… Ç'të jetë ky, atdheu? Përse zulutë më kërkojnë ta dua më shumë se Partinë?", mendoi ministri.

Meqë, edhe pse shtrëngoi vetullat, rrudhi ballin dhe rrahu qerpikët, nuk mundi t'i gjente një përgjigje pyetjes se ç'ishte atdheu, ministri vendosi të këshillohej me këshilltarin e tij ministror.

Këshilltari, po aq riosh dhe bukurosh sa edhe ministri, pasi i lëvdoi kravatën dhe kostumin, si këshilltar që ishte, e këshilloi se çfarë kremi të përdorte për qeset e syve.

– Ju lodheni shumë, – i dha fund këshilltari, këshillave për kremin.

– Kam një pyetje, – tha i zymtë ministri.

– Çfarë? – pyeti këshilltari i gatshëm të përsëriste mënyrën e përdorimit të kremit të syve.

– Doja të pyesja nëse… Ti, a di gjë, se ç'është ky atdheu?

– Atdheu? – përsëriti i habitur këshilltari.

– Atdheu, – këmbënguli ministri.

– Si të them… Besoj se do të jetë shkruar në ndonjë libër, – tha me dyshim këshilltari dhe pastaj shtoi…

– Librat me gjëra të tilla merren.

– Gomar! – shfryu ministri, – po ta kishim humbur kohën duke lexuar libra, as unë dhe as ti, nuk do të ishim këtu ku jemi.

– E vërtet, – pohoi këshilltari.

Heshtje.

– Po sikur, sikur të pyesim shefin e madh, – propozoi papritmas këshilltari.

– Dy herë gomar!, – shfryu ministri dhe duke imituar zërin e hollë dhe femëror të këshilltarit, shtoi…

– Po sikur, sikur shefi të mërzitej nga padituria jonë dhe të bënte ministër Horrin, Morrin ose Qorrin? Pallën apo Shalën?

– Vërtet… Shefi mund të mërzitej. Ai mërzitet lehtë dhe kur mërzitet, nuk ta zgjat shumë.

– Shhhtttt!

Ministri vuri gishtin tregues para hundës dhe së bashku me këshilltarin vështruan me ndrojtje përreth.

– Si të bëjmë atëherë? – pyeti  me zë të ulët këshilltari.

– E gjeta! – tha ministri,– të pyesim Stufu Faqeziun.

– Ide e përkryer! – tha i ngazëllyer këshilltari.

– Jo më kot, un jam ministër dhe ti këshilltar,– ia ktheu i kënaqur ministri.

Stufu Faqeziu ishte analo-opinionisti më mendjendritur i Zululandit. Çdo ditë e çdo natë, herë nga faqet e gazetave dhe herë nga ekranet e Tv, Stufu Faqeziu e këshillonte popullin e zuluve se, për çfarë dhe si, duhej të mendonte.

Zululandi kishte disa analo-opinionistë, njëri më faqezi se tjetri, por Stufu, pa dyshim që ky, ishte më faqeziu ndër të gjithë.

Këshilltari rrëshqiti gishtin mbi iPhonin e ri dhe priti.

– Alo? Stufu Faqeziu? Mir! Po… Dëgjo,– tha këshilltari dhe e pyeti faqeziun se ç'ishte atdheu.

– Ç'thot, – pyeti i paduruar ministri.

– Thotë se, mbi këtë temë ka shkruar disa artikuj.

– Ç'më duhet, – rënkoi ministri i zemëruar.

– Një në gazetën "Llapaqeni" dhe tjetrin tek "Zagarlehësi".

– Nuk e pyeta se me kë dhe ku është ndërzyer, por se ç'është atdheu…

– Po bërtet, – rrëfeu këshilltari dhe largoi iPhonin nga veshi – thotë se, duhet ta ndalojmë me ligj dashurinë për atdheun. Sepse… Atdheu është një përrallë që i ka kaluar koha. Që… Dashuria për Atdheun, për një popull si zulutë

që duhet të qytetërohet, është më e rrezikshme se një epidemi kolere. Se… Duhet ti mësojmë zuleve që atdheu është shteti. Që… Kush e do shtetin do edhe atdheun. Në të kundërt… Kush nuk do shtetin është armiku i atdheut.

– Si përfundim? – pyeti ministri.

– Atdheu është shteti,– tha këshilltari.

Ministri rrudhi mendueshëm ballin, shtrëngoi vetullat, rrahu qerpikët dhe vështroi ngultas pasqyrën.

– Meqë shteti, jemi ne… Unë, ti, Horri, Morri, Qorri, Palla dhe Shala, pra ne… Partia! Atëherë, nuk u gabova aspak kur thash që, "Partinë e dua më shumë se Atdheun", sepse, pa ne, pa Partinë, nuk do të kishte shtet dhe, si rrjedhojë, nuk do të kishte as atdhe,– arsyetoi ministri dhe me një pamje të kënaqur pyeti pasqyrën…

– U binde, që unë kam të drejtë dhe ata, zulut, gabohen?

Pasqyra heshti e nuk u përgjigj.

Ndoshta sepse, nuk ishte magjike…

Ndoshta sepse, kishte FRIKË të thoshte të vërtetën…

FUND.

Me dashuri dhe respekt të gjithë zuluve nga, B.K (Bey Konica).

Firma, data e gjithë të tjerat…

Tiranë 25. 02. 2016.

# DUHET TË KRENOHEMI ME SHËN ALBANIN?

Një mik të cilin e nderoj dhe e respektoj, më bëri sot një pyetje të bezdisshme. Një pyetje nga ato që mund ti përgjigjesh në dy mënyra. Të thuash përgjigjen që ti e di, se pyetësit i pëlqen të dëgjoj, ose, në të kundërt, të përballesh me rrezikun e keqkuptimit sepse, për të mos u keqkuptuar, do të duhet të shtjellosh fijet e një përgjigjeje të gjatë, të gjatë sa një libër që ka të paktën njëqind faqe dhe, për fatin tim të keq, miku im edhe pse atdhedashës…

Nuk i pëlqen të lexoj!

Cila ishte pyetja sepse…

Edhe juve, njësoj si miku im, nuk ju pëlqen të lexoni?

Mos u mërzitni, tash do t'iu a tregoj…

***

– Më thuaj, a është Shën Albani, shqiptar? – më pyeti miku.

– Për kë Alban e ke fjalën, sepse shenjtor me emrin Alban ka të paktën tre. Dy nga Anglia dhe një nga Gjermania.

– Fillo prej atij nga Anglia, – më urdhëroi miku.

– Të parit apo të dytit?

– Të parit! – ma ktheu miku.

– Ti ndoshta po më pyet nëse Shën Albani ishte Ilir? – e pyeta i pushtuar nga ndjesia e keqe se miku po më shtynte drejt një gracke.

– Ilir, shqiptar, njësoj është, – ma ktheu miku shpërfillës për vërejtjen time.

– Si të them, edhe aq njësoj nuk është, – guxova ta kundërshtoja.

– Pse s'qenka njësoj, – mu përgjigj miku duke u vrenjtur në fytyrë i pakënaqur nga kundërshtimi im i ndrojtur.

– Po ja, ti je i biri i Xhemalit dhe, Xhemali ishte i biri i…

– Adilit! – plotësoi i sigurt miku.

– Xhemali ikte në punë me biçikletë kurse ti, ke makinë. Xhemali ishte i gjatë kurse ti je i shkurtër. Xhemali ishte biond kurse ti tullac. Xhemali kishte gjashtë kalamaj, kurse ti…

– Mjaft! – ma preu fjalën miku dhe shtoi me inat, – Nuk kam nevojë të ma tregosh ti, sesi ishte im atë.

– Pra… Edhe pse je i biri Xhemalit, ti nuk je si Xhemali. Arsye kjo, për të cilën, ke edhe një emër të ndryshëm nga yt atë. Përfytyro tani sesa ndryshon ti, nga Adili, gjyshi yt. Keni jetuar në kohë të ndryshme, keni respektuar ligje dhe besime të ndryshme, jeni ushqyer ndryshe nga njëri tjetri. Ty të pëlqen uiski dhe redbulli, kurse Adilit i pëlqente rakia dhe uji i ftohtë.

– E çlidhje ka e tëra kjo me Shën Albanin?

– Asgjë! Doja thjesht të shpjegoja se përse, të qenit shqiptar dhe të qenit ilir, nuk është e njëjta gjë. Shqiptarët janë pasardhës të arbërve dhe arbrit pasardhës të ilirëve. Shqiptarët kanë trashëguar shumë nga gjuha dhe traditat e ilirëve dhe të arbërve por, nuk janë as ilirë dhe as arbër, sepse një pjesë akoma më të madhe të këtij thesari, gjuhës dhe traditave, e kanë braktisur apo humbur rrugës.

– Ok! A është Shën Albani, Ilir?

– Shën Albani ishte legjionar në territorin e Anglinë së sotme që asaj kohe, quhej Britani apo toka e britëve, kurse, vetë ishulli i Britanisë, quhej Albani, nga ku, rrjedh edhe emri Shën Alban, pra, shenjtori i parë i krishterë i Albanisë. A ishte legjionari që më pas do të shpallej nga kisha shenjtor, me origjinë Ilire? Edhe mundet… Ama, po aq shumë, mund të ishte kelt, gal, gjerman, skithas apo italik. Pse jo, edhe nubian apo egjiptian. Romakët e kishin zakon, që në vendet e pushtuara ti shpërndanin toka legjionarëve që dilnin në pension, të ngrinin koloni siç quanin ata. Të lindurit në Iliri, Britani apo Gali, nuk do të thoshte aspak që ishe një britan, gal apo ilir.

– Po atëherë, përse Britania quhej Albani? Përse Shqipëria quhet njësoj? – më pyeti miku dhe pastaj i ngazëllyer, u përgjigj po vet, – Sepse ja kemi vënë emrin neve, Albanët!

– Apo jo? – shtoi pastaj duke vërejtur mëdyshjen time.

– Ilirët apo Pellazgët, por jo shqiptarët – e korrigjova.

– Ilirët apo Pellazgët, – pohoi ai i pakënaqur.

– Një lidhje e ka por …

– Ma shpjego… – më urdhëroi prerazi miku.

– Kam shkruar një libër mbi këtë temë,– ia ktheva unë.

– Ohu, libër! Ma thuaj me dy fjalë!

– Nëse do të mund të ta shpjegoja me dy fjalë, nuk do të më duhej të shfletoja njëqind libra për të shkruar në fund, mbas shtatë vjetësh, një të vetëm me 700 faqe, që, për besë, e di që nuk mjaftojnë…

I frikësuar nga ideja e leximit të një libri (*zoti i ruajt shqiptarët nga librat*), miku im ju rikthye temës së Shën Albanit.

– Ah, sikur dikush të vërtetonte se Shën Albani ishte shqiptar, – rënkoi plot afsh.

– Ilir, – ndërhyra unë.

– Njësoj është, – ma ktheu shpërfillës me vështrimin e ngurosur diku larg si të ëndërronte diçka të përtejme që mendja ime ishte e kotë të përpiqej ta cikte.

– Përse? Përse mendon që është kaq e rëndësishme të qenit ilir i shën Albanit? – e pyeta plot kureshtje.

– Për tu krenuar që një shqiptar përhapi krishterimin në Britani. Mendo pak, gjithë këta njerëz të mëdhenj... Kostandini dhe gjithë ata të tjerët. Perandorët ilirë të Romës. Ata të Bizantit. Vezirët dhe pashallarët shqiptarë të Perandorisë Turke. A nuk duhet të jemi krenarë me ta?

"Ja gracka së cilës i druhesha", mendova, dhe pasi u mendova edhe ca, vendosa të fshihesha pas fjalëve me të

cilat Sami Frashri, një nga etërit e kombit tonë, këshillonte Shqiptarët se me kë duhet të krenoheshin…

"***Shqiptarët, gjatë gjithë historisë së tyre, kanë dëshmuar që janë të zotë edhe me kordhë edhe me pendë, edhe me trimëri edhe me mënd e dituri. Shqipëria ka nxjerë shumë njerëz të shquar e me nam të madhë po asnjë prej tyre nuk ka punuar për Shqipëri, e cila ka mbetur gjithnjë e varfër dhe e padëgjuar, e me djemtë e saj janë mburrur kombe dhe vende të tjera. Është ndodhur një shqiptar i zoti të ngjalli Egjiptin e të bëjë prej këtij vendi të humbur e të prishur si ishte, një vend të pasur e të ndritur si është sot, por kurrë nuk është gjendur dikush ti bëjë Shqipërisë një të mirë të këtillë. Prandaj themi me hidhërim në zemër që; shqiptarët kanë punuar gjithmonë për botën dhe kurrë për vete…***

***Vetëm një Skënderbe ka punuar në kohrat e shkuara për Shqipërinë dhe vetëm ay është vërtet mburrje për Shqipërinë***"

Të krenohemi dhe të shëmbëllehemi vetëm me ata që kanë punuar dhe janë sakrifikuar për kombin e tyre, këshillon Sami Frashëri dhe, shembuj heronjsh të tillë kemi plotë edhe në historinë e Ilirëve…

Të mirënjohur si mbreti Bardhyl, Kliti, Glauku, Agroni, Teuta, dy Batot e kryengritjeve ilire dhe shumë e shumë heronj të tjerë, emrat dhe historitë e të cilëve do ti njihnim

sikur, ah, sikur të mos merreshim me “lavditë” e atyre që “punuan për të tjerë” dhe të zbulonim e lexonim, të nxirrnim mësime nga historia e popullit tonë.

Por…

Për ta bërë këtë, fatkeqësisht, “historitë” me “dy fjalë” të Fb (siç i pëlqejnë mikut tim), jo vetëm që nuk mjaftojnë, por, janë edhe të dëmshme.

Përse?

Po të shpjegoja se përse, ky shkrim do të zgjatej shumë dhe ju...

Hmmm....

Nuk do ta lexonit!

Tiranë. 22. 06. 2016

# EUROPA DHE PROFECIA
# E
# JOHANN GEORG VON HAHN

Fuqitë e mëdha evropiane (*Franca, Anglia, Rusia, Gjermania*) mbasi e detyruan Perandorinë Otomane në vitin 1829 të njihte krijimin e një shteti që nxituan ta pagëzonin me emrin "Greqi", të pranonte pavarësinë e këtij shteti në vitin 1830, kurorëzuan edhe një princ bavarez si mbret të tij në vitin 1832.

Qindra ekspertë të fushave të ndryshme të qeverisjes dhe administrimit të një shteti, e shoqëruan mbretin e ri në udhëtimin drejt mbretërisë që mbarte emrin magjepsës "Greqi". Atdheut të Pitagorës, Platonit, Eskilit, Leonidës dhe Themistokliut…

Udhëtim ky, që në gazetat evropiane do të krahasohej plot epos dhe mallëngjim me udhëtimin e Argonautëve.

Por, a ishte vërtet Greqia, Greqi?

Pra, një vend i populluar nga njerëz që flisnin gjuhën e banorëve të Greqisë antike?

Midis këtyre qindra ekspertëve shtetformues që shoqëruan mbretin bavarez drejt mbretërisë të sapo pagëzuar Greqi, bënte pjesë edhe doktori në drejtësi J. G. Hahn. Ashtu si të gjithë ekspertët e tjerë evropianë që ju

bashkëngjitën misionit të mbretit bavarez për të formuar shtetin e ri, edhe J. G. Hahni, do të vërente me habi se ajo, gjuha greke që flitej në Greqi, nuk i ngjasonte aspak greqishtes antike që mësohej në shkollat evropiane.

Habia e parë do të pasohej nga një e dytë akoma më e madhe.

Popullsia e shtetit të ri, në pjesën dërrmuese të saj fliste një tjetër gjuhë, krejt e ndryshme nga ajo e para që quhej greke por e tillë nuk ishte. Kjo gjuhë tjetër i përkiste një populli të quajtur shqiptar, të njëjtit popull të cilit i përkisnin edhe luftëtarët më të paepur dhe prijësit kryesorë të kryengritjes antiturke që gazetarët evropianë e kishin emëruar "greke", por që tashmë, askush nuk ishte më i sigurt nëse ishte e drejtë të vazhdonte të cilësohej si e tillë.

"***Sot Atika, Magara, Beotia, Eubeja e Jugut, Argolisi dhe Korinthi kanë vetëm banorë shqiptarë… Ndër ishujt Hydra, Specia, Poros dhe Salamisa banohen vetëm nga shqiptarë dhe në këto vende përpara kryengritjes greke, asnjë grua nuk dinte greqisht. Kjo shpjegon se përse luftërat ndër dete u kryen vetëm nga shqiptarët, dhe arsyen që sot gjuha e folur në flotën greke është vetëm shqipja. Por edhe në kampet e kryengritjes në Tripolice dhe Athinë nuk flitej aspak vetëm greqisht, sepse elementi luftarak shqiptar merrte pjesë edhe në betejat e tokës. Marko Boçari dhe Foto Xhavella ishin shqiptarë nga Suli,***

***të tillë janë edhe Grivat që janë po nga Suli, siç ishin shqiptarë edhe Kriziotët nga Eubeja e Jugut***".

(J. G. Hahn. Studime Shqiptare. Kap, IV)

Por, ndërsa i gjendur përpara këtij problemi krejtësisht të pa parashikuar, mbreti i ri i ndihmuar nga këshillat e ekspertëve shtetformues evropianë dhe të dhespotëve të Kishës së Krishtere Ortodokse vendosi që, nëse nuk kishte një komb grek, zgjidhja më e mirë do të ishte ta formonin një të tillë, J. G. Hahn i pasionuar pas hulumtimit të historisë së popujve dhe gjuhëve që ata flisnin, filloi të studionte historinë, zakonet dhe gjuhën e popullit të shqiptarëve. Shqiptarë të cilët, politika evropiane e ndihmuar nga ajo e Kishës Ortodokse vendosi t'i "qytetëronte" duke i kthyer në grekëfolës dhe në të tilla raste, ashtu si kishte ndodhur shumë herë në histori, dënimi për ata që nuk dëshironin të "qytetëroheshin" duke harruar kulturën, gjuhën dhe historinë e tyre ishte një dhe i vetëm…

Vdekja!

Në këtë përpjekje, apo më saktë, luftë kundër kohës për të memorizuar në kujtesën e historisë, qenësinë e kulturës dhe gjuhës të një populli të dënuar me vdekje, J. G. Hahn do të shkruante "Studime Shqiptare" (*Jene, 1854*).

Krejtësisht i ndërgjegjshëm për pafuqinë e tij për të ndalur aksionin e dhunshëm politik, ekonomik, kulturor, demografik, që shteti i ri grek i ndihmuar me aq zell edhe nga Kisha Ortodokse kishte ndërmarrë për të

"qytetëruar", apo më saktë, për të "greqizuar" shqiptarët, Hahni shkruan i dëshpëruar…

"***Tashmë shqiptarëve të Greqisë nuk i vjen mirë t'i quash shqiptarë, sepse i ngjan njësoj, si t'i quaje barbarë. Ai e quan veten helen dhe mburret me këtë origjinë. Në shumë qytete të mëdha të Atikës, gratë kur shohin se pranë tyre po kalon në rrugë një i huaj, flasin greqisht, dhe në Hydra, Specia dhe Salamis, mund të takosh sot vetëm pak vajza, që nuk dinë të flasin greqisht, megjithëse gjuha e familjeve të tyre është shqipja. Ky zhvillim po ecën kaq shpejt, sa nëse do të vazhdojë me këtë ritëm, brenda tre brezave shqipja do të flitet vetëm ndër skajet më të veçuara të Greqisë dhe brenda gjashtë brezave do të jetë zhdukur fare…***". (Studime Shqiptare. Kap, IV)

Nga largësia e kohërave mund të dëshmojmë që tashmë, kjo "pjesë" e profecisë së Hahnit është thuajse përmbushur. Shkruajmë "pjesë" sepse në shkrimet e tij, Hahn, më shumë se njëherë shpreh ndjenjën dhe dyshimin se harresa, zhdukja e kujtesës së kulturës dhe gjuhës të shqiptarëve të Greqisë, më shumë se vetë atyre, do t'i shkaktonte një dëm të pa zëvendësueshëm kujtesës historike dhe kulturore të Evropës. Do të cungonte njëherë e përgjithnjë identitetin shpirtëror e të qenit dhe të ndjerit evropian. Se, duke pranuar zhdukjen e kulturës dhe gjuhës së shqiptarëve të Greqisë, Evropa po zhdukte një pjesë të vetvetes. Një pjesë të trupit të saj, pa të cilën,

ndoshta nesër, nuk do të mund t'i mbijetonte stuhive, sfidave të historisë.

Ishte pikërisht kjo ndjesi, dyshim, që në kohë do të shndërrohej në bindje, e cila e nxiti J.G. Hahn të memorizojë në rreshtat e "Studimeve Shqiptare" gjithçka që mundi mblidhte mbi historinë, kulturën dhe gjuhën e popullit shqiptar, jo vetëm në Greqi por kudo që ai jetonte në Ballkan.

Tiranë, 02. 12. 2015.

# KAMPIONATI BOTËROR I FUTBOLLIT
# DHE
# "SINDROMA E JENIÇERLLËKUT"

Tashmë që kampionati botëror i futbollit ka mbaruar[1], mund të meditojmë dhe të diskutojmë qetësisht mbi një nga çështjet që gjatë zhvillimit të tij, ndezi aq shumë debate dhe emocione të kundërta .

Penalltitë?

Arbitrimi?

Mbytja e turpshme e "titanikut" Brazil?

Aspak!

Tema e diskutimit do të jetë krejtësisht "Made in Albania".

Edhe pse kombëtarja e futbollit të Shqipërisë nuk mundi të shkonte në Brazil, një ekip thuajse i plotë lojtarësh, emrave të të cilëve mediat shqiptare u ngjitën si bisht nga pas përcaktimin e çuditshëm "me origjinë shqiptare", udhëtuan drejt Brazilit dhe luajtën në fushat e botërorit nën hijen e flamujve të kombeve të huaja.

Shkruaj "përcaktim i çuditshëm" sepse, kur dëgjon që emri i dikujt shoqërohet nga përcaktimi "me origjinë shqiptare", të krijohet përshtypja se ke të bësh me individë që kanë të paktën tre apo katër breza që janë larguar nga atdheu i tyre, ndërkohë që, lojtarët "me origjinë shqiptare"

të botërorit, kanë lindur thuajse të gjithë në trojet ku shqiptarët kanë jetuar dhe jetojnë të paktën prej 3000 vjetësh.

Krahas përcaktimit të çuditshëm "me origjinë shqiptare", mediat TV dhe ato të shkruara, e shoqëruan përmendjen e emrave të këtyre lojtarëve edhe me një bombardim sistematik nga eteri dhe toka që përcolli mbi të gjithë ne (*shqiptarët që jetojnë në atdhe dhe ata që edhe pse prej shumë vitesh jetojnë në dhe të huaj nuk e quajnë veten "me origjinë shqiptare", por thjesht, shqiptarë*), thirrjen thuajse kërcënuese se duhet të ndiheshim krenarë për lojtarët "me origjinë shqiptare" pjesëmarrës në botërorin e futbollit. Por, për shkakun se dashuria dhe krenaria janë ndjenja, dhe si të tilla, është e vështirë të mbarsen apo të mbillen në shpirtrat njerëzor me anën e arsyetimeve, pohimeve, këshillave apo udhëzimeve, qofshin këto edhe të ardhura nga lartësitë mendore të komentuesve mediatikë të ndeshjeve të botërorit, për të cilët, nuk mund të mos përmendim se në pjesën dërrmuese të tyre, na shfaqen në ekranet e TV dhe faqet e gazetave edhe në rolet e opinionistëve politikë, ekonomikë, letrarë, ushtarakë etj, etj, etj, shqiptarët fatzinj, që ndryshe nga ajo çfarë iu urdhërua nga lartësitë mediatike, nuk mundën të ndjeheshin as krenarë dhe as të dashuruar, u përpoqën me gjysëm zëri të justifikojnë mungesën e krenarisë dhe dashurisë duke u mbrojtur pas faktit, se këta, lojtarët e quajtur "me origjinë shqiptare", nuk luajtën për

Shqipërinë dhe si rrjedhojë, nuk kishin se përse të donin dikë që nuk i donte…

Nuk mund të ndjeheshin krenarë, për dikë, që duke luajtur nën hijen e një flamuri tjetër (*cilado qoftë arsyeja që e kishte shtyrë të merrte këtë vendim*), tregonte se (*për një shkak apo një tjetër*) nuk ishte krenar për flamurin, historinë, kulturën dhe traditat e popullit të tij.

– Çfarë janë këto gjepura? – do të çirreshin gazetaro – opinionistët e TV kombëtare të shtetit shqiptar. Këta lojtarë janë ambasadorët e Shqipërisë në botë. Flamujtë? Gjepura! Jetojmë në shekullin e XXI dhe ju na flisni për flamuj. Nuk ka rëndësi për kë flamur luajnë! E rëndësishme është "origjina" e tyre shqiptare dhe jo flamuri para të cilit përgjunjen, i këndojnë himnin dhe i lartësojnë nderin e krenarinë.

Mbasandaj, ndoshta sepse ky arsyetim nuk u mjaftonte për të bindur as edhe veten, shtonin…

– Mos harroni! Ai, flamuri tjetër, të cilit i përgjunjen e kështu me radhë, i ka ushqyer, edukuar dhe shkolluar. Pra, është krejtësisht e logjikshme që kanë zgjedhur të luajnë në hijen e këtij flamuri dhe jo atij shqiptar.

Është e vërtet, ky arsyetim së pari të ngjan krejtësisht i logjikshëm, por edhe ai e ka një "thembër të Akilit"…

Në rastin e lojtarëve, saktësojmë, shqiptarë dhe jo "me origjinë shqiptare", që luajnë nën hijen e flamurit Zviceran, Gjerman apo atij Grek apo Belg, vërtet që nuk mundemi të mohojmë se janë ushqyer, edukuar dhe

shkolluar në këto vende, por nuk duhet gjithashtu të harrojmë, që ky edukim dhe shkollim nuk ka qenë aspak falas apo dhuratë e qeverive të vendeve përkatëse, por, është mundësuar nga taksat publike të paguara edhe nga moria e emigrantëve që banojnë dhe punojnë në këto vende. Emigrantë që, duke qenë kryesisht në moshë të re, i japin vendeve ku kanë emigruar shumë herë më tepër nga ajo që u marrin. Si rrjedhojë, ajo çështja e "borxhit" ndaj vendit që i ka "ushqyer" dhe "edukuar", nuk është aspak në gjendje të shpjegojë dhe të justifikojë vendimin për të luajtur nën hijen e një flamuri të ndryshëm nga ai i Shqipërisë ose Kosovës, nëse nuk plotësohet me diçka tjetër…

Por, për një çast, le të marrim si të vlefshëm arsyetimin se, ashtu si zagari që leh atje ku ha (*edhe pse ushqimin e ka paguar me djersën e ballit*), shkollimi dhe edukimi në një vend të huaj përligj plotësisht mohimin për të luajtur (*theksojmë, për të luajtur dhe jo për të luftuar apo sakrifikuar jetën*) për Shqipërinë apo Kosovën. Të quajmë të vlefshëm pohimin se këta lojtarë duhet që t'ia dinë për nder vendeve që i "ushqyen", "edukuan" dhe "shkolluan", nder të cilin, tashmë duhet që t'ia shpërblejnë duke i shërbyer.

Edhe pse mund t'ju duket e çuditshme, pranimi i vlefshmërisë i këtij pohimi do t'na detyronte të rishkruanim disa faqe të historisë së popullit tonë.

Ky rishkrim do të mbarsej nga arsyetimi se…

Nëse pranojmë që lojtarët me "origjinë shqiptare" duhet t'jua dinë për nder vendeve të cilat i ushqyen dhe edukuan, dhe si rrjedhojë, edhe duhet t'ia shpërblejnë këtë nder duke luajtur për ta, atëherë, sipas të njëjtës logjikë duhet të gjykojmë dhe vlerësojmë edhe rrëmbimin e dhunshëm të djemve shqiptarë nga shteti otoman në shekujt XV-XVI, për të mbushur me ta, radhët e reparteve ushtarake të jeniçerëve.

Nga kronikat e historisë mësojmë, se çdo katër vjet, hordhi të ushtrisë otomane, e mblidhnin këtë taksë gjaku (*djem të moshës nga 8 në 14 vjeç*) në mbarë territoret e banuara nga shqiptarët. Rilindësit do ta krahasonin dëmin që pagimi i kësaj takse gjaku i shkaktoi popullit tonë, me atë që mbi popujt e tjerë të Evropës e shkaktonin vetëm epidemitë e murtajës. Por, ndryshe nga epidemitë e murtajës, murtaja e rekrutimit të jeniçerëve e godiste popullin tonë në mënyrë të pashmangshme çdo katër vjet, duke i rrëmbyer të ardhmen, shpresën dhe vullnetin për të mbijetuar. Kjo është ajo, pjesa e historisë që duhet të rishkruajmë duke pohuar prerë dhe qartë se rilindësit tanë gaboheshin keqas kur e krahasonin rekrutimin e jeniçerëve nga shteti otoman me sëmundjen e frikshme të murtajës, sepse shteti otoman, i ushqeu, i edukoi dhe i arsimoi këta djem shqiptarë. Më të aftëve ndër ta i dha mundësinë të bëheshin njerëz të pushtetshëm e të famshëm, jo vetëm brenda kufijve të shtetit otoman por në mbarë Evropën.

Sami Frashëri në veprën "Fjalor historik dhe gjeografik" na njeh me listën e emrave dhe biografitë e këtyre djemve shqiptarë që ushqimin, edukimin dhe arsimimin ia shpërblyen shtetit otoman duke luftuar dhe punuar për lavdinë dhe madhështinë e tij deri në ditët e fundit të jetës së tyre. Ndër ta, mund të përmendim Bajazit Pashën, vezir i shtetit otoman gjatë kohës së sundimit të sulltan Mehmetit (1413-1421). Famëkeqin Ballaban Beun që në vitin 1465, u dërgua nga sulltani të sulmonte Shqipërinë në krye të 15 mijë kalorësve dhe 3000 këmbësorve. Daut Pashën që u shpall kryevezir në vitin 1483…

Oh!

Lista e emrave të bejlerëve, pashallarëve dhe vezirëve "me origjinë shqiptare" që me bëmat e tyre do t'i dhuronin lavdi dhe pushtet shtetit Otoman, është e gjatë. Prania e këtyre emrave, në mënyrë të pavarur nga çështja e lojtarëve me "origjinë shqiptare", ka nxitur shpesh herë ndër shekuj përflakjen e debatit nëse duhet të ndjehen krenarë shqiptarët për famën dhe lavdinë, që bashkëkombës si Bajazit Pasha apo Ballaban Beu zotëruan duke i shërbyer një shteti të huaj, për më tepër, pikërisht atij që kishte pushtuar vendin e tyre. Në dhjetëvjeçarët e fundit shqiptarëve të hipnotizuar nga doktrinat e globalizmit dhe kozmopolitizmit (*po aq shumë sa dikur ishin të hipnotizuar nga doktrina e komunizmit dhe internacionalizmit proletar*) u janë shërbyer një sërë librash,

dokumentarësh televizivë dhe pafundësie artikujsh në shtypin e përditshëm për ti bindur, se këta vezirë, bejlerë dhe pashallarë, duhet të futen në radhën e atyre personazheve të historisë së Shqipërisë, me të cilët duhet të krenohen. Me këtë prirje për të mbarsur në shpirtrat e shqiptarëve ndjenjën e krenarisë për bëmat e jeniçerëve, jeniçerllëkut apo famës që të mundëson të qenit jeniçer, ndjenjë kjo, që është e logjikshme të mendojmë se shteti otoman kishte shumë arsye ta mbështeste moralisht dhe financiarisht, u përball edhe rilindësi ynë Sami Frashëri.

I shqetësuar nga kjo dukuri që kërkonte t'i rrëmbente popullit shqiptar jo vetëm gjakun por edhe shpirtin, Sami Frashëri nga faqet e "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë ?" i shpjegon popullit të tij se…

"***Shqiptarët, gjatë gjithë historisë së tyre kanë dëshmuar që janë të zotë edhe me kordhë edhe me pendë, edhe me trimëri edhe me mënd e dituri, e Shqipëria ka nxjerë shumë njerëz të shquar e me nam të madhë po asnjë prej tyre nuk ka punuar për Shqipëri, e cila ka mbetur gjithnjë e varfër dhe e padëgjuar, e me djemtë e saj janë mburrur kombe dhe vende të tjera. Është ndodhur një shqiptar i zoti të ngjalli Egjiptin e të bëjë prej këtij vendi të humbur e të prishur si ishte, një vend të pasur e të ndritur si është sot, por kurrë nuk është gjendur dikush ti bëjë Shqipërisë një të mirë të këtillë. Prandaj themi me hidhërim në zemër që; shqiptarët kanë punuar gjithmonë për botën dhe kurrë për vete…***", shkruan rilindësi ynë

duke na dhënë në fund edhe përgjigjen e pyetjes tunduese se për kë duhet të ndihemi krenar…

"***Vetëm një Skënderbe ka punuar në kohrat e shkuara për Shqipërinë dhe vetëm ay është vërtet mburrje për Shqipërinë***".

Përgjigja e rilindësit është e qartë dhe nuk le shtigje për mëdyshje dhe hezitime. Duhet të ndjehemi krenarë, të adhurojmë dhe nderojmë vetëm bashkëkombësit tanë që kanë luftuar dhe punuar për Shqipërinë.

Ky shkrim do të ngelej i mangët, nëse nuk do të flisnin edhe për atë "diçkanë" që më shumë se çdo tjetër arsye i shtyu lojtarët shqiptarë të luanin në hijen e flamujve të huaj dhe jo të atij të vendit dhe popullit të cilit i përkasin. Këtë "diçka" që mundemi ta quajmë pa u gabuar edhe "sindroma e jeniçerllëkut". Të përdorim pra, për ta emëruar, termin mjekësor "sindrom", sepse ndër sëmundjet që kanë munduar dhe mundojnë trupin dhe shpirtin e popullit tonë, "jeniçerllëku" është ai më i rrezikshmi.

Të mashtruar, hipnotizuar por edhe fshehur pas koracave të doktrinave globaliste dhe kozmopolite, përhapja e të cilave në territoret ku kanë banuar ilirët, arbërit dhe banojnë sot shqiptarët, është investuar me aq zell për dhjetëra shekuj nga politika e shteteve multinacionale siç ishin Perandoria Romake ajo Bizantine dhe Otomane, doktrina që do të pasoheshin në shekullin e XX edhe nga ajo e komunizmit dhe internacionalizmit

proletar, dhe së fundmi, edhe nga thirrjet anonime (të shtira se vinë nga Bashkimi Evropian!) se duhet ta harrojmë plagën e ndarjes së popullit tonë mes pesë kufijve sepse do të bashkohemi ne BE, sa edhe doktrinave globaliste fetare që për shekuj janë përpjekur të mbjellin në shpirtin e popullit tonë, idenë se, përpara se të jemi dhe të ndjehemi shqiptar, jemi myslimanë, ortodoksë apo katolikë, shqiptarët e kanë justifikuar "jeniçerllëkun" apo vënien e shpirtit, mendjes dhe forcës së tyre në shërbim të kombeve të huaj.

Rezultati?

Ai që kemi para syve!

Një komb i ndarë në pesë shtete të ndryshme dhe i dërrmuar moralisht, politikisht, ekonomikisht, dhe mbi të gjitha, i dërrmuar shpirtërisht. Një komb i cili ka humbur shpresën se të ardhmen e tij duhet dhe mundet që ta përcaktojë dhe ndërtojë vetë.

Rruga e shpëtimit për të dalë nga kjo gjendje nuk mund të jetë asnjë tjetër veç asaj që na kanë këshilluar Rilindësit…

Shërimi nga sindroma e Jeniçerllëkut!

Kura është e thjeshtë…

Mos të vendosim asnjë doktrinë, qoftë kjo filozofike, politike apo fetare, mbi kombin, gjuhën, kulturën, historinë dhe flamurin e popullit tonë!

Për tu rikthyer aty ku u nisëm, pra, nga botërori i futbollit, edhe ky, në mikrokozmosin e topit të

rrumbullaket, dëshmoi që dy skuadrat më të suksesshme të tij, ishin ato të dy kombeve që në kontinentet përkatëse, shquhen per nacionalizmin e tyre…

Gjermania dhe Argjentina!

Ashtu siç na dëshmoi, që edhe kombe të vegjël dhe të varfër nga ana ekonomike siç janë Kosta Rika dhe Uruguai, mundën të përballen denjësisht e madje edhe të fitojnë ndaj kombeve shumë më të pasur dhe të mëdhenj se ata. Fitore të cilat, nëse trupi dhe shpirti i kombit tonë nuk do të ishte molepsur nga sindroma e jeniçerllëkut, do t'i gëzohej tashmë edhe populli Shqiptar.

Tiranë, 16. 07. 2014.

**1. Kampionati Botëror i Futbollit (XX), i zhvilluar në Brazil, 12 Qershor – 13 Korrik 2014.**

# FALEMINDERIT I FORTLUMTURI IRENE!

Gjatë ditëve që pasuan ceremoninë e shenjtërimit të katedrales "Ngjallja e Krishtit" në Tiranë[1], politikanët, gazetarët dhe opinionistët e të gjithë ngjyrave dhe formave, si të kishin zbritur befas nga bota e përkryer e qiejve, na u lebetitën, qanë dhe qurravitën, duke përdorur të gjitha sojet e mediave që shërbejnë për të propaganduar lebetitjen, qarjen dhe qurravitjen e mendjendriturve që na udhëheqin jetën dhe ushqejnë shpirtin, sepse aq papritur (*për ta*), në mes të Tiranës, kryeqytetit të Republikës së Shqipërisë, Patriarku i Serbisë, Fortëlumturia e tij Irenej, i "preu në besë" dhe guxoi t'i (ri)kujtonte popullit shqiptar që...

Kosova është zemra e Serbisë!

Papritur?

Oh, jo!

Gjithkush e dinte se edhe shumë herë të tjera më parë, i Fortëlumturi Irenej, kishte shpallur dhe rishpallur me krenari, që Kosova është zemra e Serbisë dhe si e tillë, do të ngelej gjithmonë pjesë e pandashme e shtetit Serb.

Sigurisht...

E dinte gjithkush përveç atyre, politikanëve, gazetarëve dhe opinionistëve shqiptarë që u ndjenë të tradhtuar nga i Fortëlumturi Irenej sepse ky, ndryshe nga ata, guxoi rishtazi të përsëriste pa druajtje dhe me vendosmëri atë që kishte thënë gjithmonë, pra…

Që Kosova është Serbi!

Ndërkohë që politikanët, gazetarët dhe opinionistët shqiptarë, të zhytur (*si derrat në llucë*) në vogëlsinë e bollëkut të një fame mediokre e kanë ngritur karrierën e tyre duke mos guxuar kurrë, qoftë edhe një herë të vetme, të pohojnë të kundërtën e asaj që shpalli i Fortëlumturi…

Pra…

Që Kosova është Shqipëri, pavarësisht dëshirave, qëllimeve dhe planeve politiko−ekonomike që ka thurur dhe vazhdon të endë me aq zell shumëkush në Beograd, Athin, Bruksel, Moskë, Berlin apo Paris!

Por, a kanë të drejtë shqiptarët të shajnë, anatemojnë dhe akuzojnë si besëthyes kryepeshkopin Irenej?

Mendoj që jo!

Përkundrazi, shqiptarët duhet ta falënderojnë të Fortëlumturin Irenej sepse u rikujtoi, që ata që copëtuan trupin, shpirtin dhe zemrën e kombit tonë, ata që programuan zhbërjen e kombit shqiptar, nuk kanë ndryshuar aspak mendim.

Vallë, a duhet të fajësojmë të Fortëlumturin Irenej sepse, ndërkohë që politikanët, gazetarët dhe opinionistët tanë, janë përpjekur dhe përpiqen të na mbushnin mendjen për miqtë e shumtë që ka Shqipëria në Evropë dhe në botë (*a nuk bënte kështu edhe Enver Hoxha*?), Bashkimi Evropian e harroi gjenocidin e fundshekullit të XX që shteti Serb kreu mbi popullin shqiptar të Kosovës

dhe në 2 mars 2012 e dekoroi Serbinë me statusin e vendit kandidat të BE?

Vallë, a duhet ta fajësojmë Kryepeshkopin e Serbisë sepse, ndërkohë që Serbia ndërton shkolla dhe krijon komunitete "Serbe" në zemër të Shqipërisë[2] (*e përse të mos e bëjë kur ka aq shumë shqiptarë që pranojnë të shesin votën për një thes me miell apo një celular, e të tjerë, që pranojnë po kaq lehtë të shpallen grekë në këmbim të një pensioni të përmuajshëm prej 100 eurosh, euro që vijnë sërishmi nga Brukseli*), akademikët shqiptarë punojnë (*të paguar nga ne*) për të coptuar gjuhën shqipe (*sipas ndarjes së kufijve*) në dy, tre apo katër pjesë?

Vallë, a duhet ta fajësojmë kryepeshkopin Irenej, sepse qeveritarët shqiptarë të Kosovës dhe ata shqiptarë të Shqipërisë, për t'i bindur qytetarët e tyre se kufijtë me të cilët Evropa na ka ndarë padrejtësisht janë të palëvizshëm, nuk humbasin rastin për të na taksuar dhe gjobitur sa herë guxojmë t'i kapërcejmë këta kufij?

Vallë, a duhet ta fajësojmë kryepeshkopin Irenej sepse, ndërkohë që politikanët shqiptarë propogandojnë ekonominë mjerane dhe poshtëruese të fasoneve[3], miqtë tanë evropianë të ndjekur nga ata që jetojnë shkretëtirave të Arabisë, investojnë në Serbi miliarda euro për ndërtimin e industrive të vërteta, reale dhe dinjitoze, që qëndrojnë aq shumë larg realitetit dhe mendësisë thuajse skllavopronare te "kioskave" shqiptare të quajtura fasone?

Vallë, a duhet ta fajësojmë kryepeshkopin Irenej sepse, ndërkohë që Serbia investon miliona euro për ruajtjen dhe propagandimin e kulturës serbe, në TV kombëtare të Republikës të Shqipërisë lëvdohen dhe duartrokiten këngëtarë serbë që nëpër koncertet e tyre i kanë kërkuar publikut të vrasin shqiptarët?

Vallë, a duhet ta fajësojmë kryepeshkopin Irenej sepse, ndërkohë që historianët tanë po përpiqen sipas këshillave të Evropës së "re" të zhbëjnë kujtesën e kombit tonë, duke fshirë nga librat e historisë listën e gjatë të masakrave, që fqinjët tanë kryen mbi shqiptarët me bekimin e Evropës së "vjetër", historianët dhe diplomatët e shtetit serb, në emër të një historie të rreme i kërkojnë Evropës tu japi atë që i "takon"?

Pak muaj më parë, Ana Hrustanovic, ambasadorja e Serbisë në Itali, në një konferencë të zhvilluar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë dhe Instituti i Studimeve të Larta të Gjeopolitikës do të deklaronte; "***Republikës së Serbisë i është dashur shumë herë të përballet me sfidat e shkaktuara nga përpjekjet e institucioneve të përkohshme të Prishtinës për të ndryshuar situatën në vend, përpjekje që ka vënë në rrezik sigurinë e të gjitha rajonit…***", duke bërë të qartë se për shtetin e Serbisë, shteti i Kosovës jo vetëm që nuk ekziston por, ato që përfaqësuesja e shtetit Serb i cilëson si "*institucionet e përkohshme të Prishtinës*", janë të rrezikshme për të gjithë rajonin dhe si të tilla, duhen eliminuar.

Vallë, ku ndryshon deklarata e përfaqësueses së shtetit të Serbisë nga ajo që shpalli Irenej në Tiranë?

Por përfaqësuesja e shtetit Serb në Itali nuk u ndal me kaq...

Lartësoi dorën e saj paqësore mbi mëkatarët italianë që guxuan të njihnin pavarësinë e Kosovës dhe ja u fali mëkatin me këto fjalë…

*"**Edhe pse ka njohur pavarësinë e Kosovës, Italia ka dëshmuar një mirëkuptim të madh ndaj Republikës së Serbisë. Provë e miqësisë që lidh dy vendet tona, është fakti, që në këto momente, në Republikën e Serbisë zhvillojnë veprimtarinë e tyre mbi 500 ndërmarrje italiane ku punojnë 20.000 persona. Midis këtyre ndërmarrjeve mund të përmendim emra të nderuar si Fiat, Beneton, etj**"*.

Në fund të fjalimit të saj, përfaqësuesja e shtetit të Serbisë, përmendi edhe lidhjet e ngushta historike dhe kulturore që kishin ndihur në forcimin e miqësisë midis Serbisë dhe Italisë. Kush ishin këto lidhje dhe sa thellë shtriheshin në kohë? Ja se ç'përgjigje jep ambasadorja serbe...

*"**Këto lidhje janë shumë të ngushta. Mjafton të kujtojmë 17 perandorët romakë të lindur ne tokën Serbe, dhe midis tyre, Kostandinin e Madh. Këtë vit Serbia së bashku me Italinë dhe të gjithë botën e krishterë do të***

***festojë edhe 1700 vjetorin e ediktit të Milanos me të cilin Kostandini i Madh e shpalli krishterimin, besim zyrtar të Perandorisë Romake"***.

Ndërkohë që historianët e institucioneve të shteteve shqiptare nxitojnë plot dëshirë e vullnet që të zhbëjnë sa më parë historinë e Shqipërisë, ndërkohë opinionistët dhe politikanët shqiptar na çirren papushim nga ekranet e TV se, për të shkuar në Evropë duhet ta harrojmë të shkuarën, të harrojmë heronjtë që me gjakun e tyre kanë ngjizur në zemrat tona emrin e Shqipërisë, Serbia po shkruan historinë e saj të re!

Mos ndoshta është faji i Irenejt që ne, shqiptarët "modernë", që na nxisin aq shumë të jemi anglisht folës, arab folës, kinez folës, pra gjithçka përveçse shqip folës, nuk jemi të denjë dhe përbuzim historinë e kombit dhe të trojeve tona?

A duhet ta fajësojmë kryepeshkopin serb për të gjitha këto?

Jo!

Madje duhet ta falënderojmë !

Ta falënderojmë sepse...

Na kujtoi që përtej retorikave televizive, Bashkimi Evropian, përbuz dhe nuk i do brenda kufijve të tij, ata si ne; ata që nuk duan dhe respektojnë së pari, historinë e tyre, historinë e kombit, kulturës dhe vendit të cilit i përkasin.

Na kujtoi që rruga e shqiptarëve drejt Europës, nuk kalon dhe varet nga Beogradi, Athina, Brukseli apo nga aftësitë servilo – pështirosëse të politikanëve shqiptarë, por, nga vullneti i popullit Shqiptar për tu bashkuar.

Na kujtoi që qëllimi i vetëm i shqiptarëve duhet te jetë një dhe i vetëm …

Bashkimi kombëtar!

Sepse, vetëm bashkimi kombëtar na hap rrugën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, udhën e hyrjes në Evropë si të barabartë mes të barabartëve.

Për të gjitha këto arsye mendoj se, të gjithë së bashku, duhet t'i themi Kryepeshkopit të Fortëlumtur të Serbisë…

Faleminderit!

Tiranë, 07 .06. 2014.

**1. Katedralja e besimit të krishterë ortodoks, " Ngjallja e Krishtit" u inaugurua në datën 01. 06 2014.**

**2. Në vitin 1924, disa dhjetëra familje të besimit mysliman me etni bosnjake dhe shqiptare nga krahina e Sanxhakut, mbasi braktisën vendlindjen e tyre për ti shpëtuar persekutimit dhe politikës së gjenocidit të Mbretërisë Serbe (*e quajtur asaj kohe; Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve*) u mirëpritën nga shteti shqiptar që i ndihu të strehohen në Myzeqe në fshatrat e Libofshës, RrethLibofshës, Hamilit dhe Petovës. Për ironinë e fatit dhe të historisë, 70 vite mbas persekutimeve dhe masakrave të shtetit serb që i detyruan këto familje të braktisnin vendlindjen, disa prej pasardhësve të këtyre familjeve, me shpresën e përfitimeve ekonomike dhe sociale shpallen "komunitet serb" dhe si të tillë, i kërkojnë Ministrisë së Kulturës dhe Shkencave të**

**Serbisë të ndërtojë për ta një shkollë ku pjesëtarët e këtij "komuniteti serb" në zemër të Shqipërisë të arsimoheshin në gjuhën serbe. Në shtator të vitit 2010 me miratimin e institucioneve të shtetit shqiptar, ambasadori i Serbisë në Tiranë, inauguron shkollën e parë serbe në fshatin Reth–Libofsh të komunës Libofshë (Fier).**

**3. Me rënien e bllokut komunist, duke filluar nga dhjetëvjeçari i fundit i shekullit të XX, shumë ndërmarrje evropiane të tërhequra nga fitimi ekonomik që mundësonte krahu i lirë i punës në shtet ish komuniste, transferuan një pjesë të procesit të prodhimit punishteve të ngritura në këto vende, që për këtë arsye u quajtën edhe"fasone", emër që mund të shqipërohet; punishte bishtëz apo punishte copëz.**

**Kushtet çnjerëzore dhe skllavëruese të punës, paga e ulët dhe mungesa totale e institucioneve që kujdesen për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në të quajturat "fasone", janë bërë shumë herë objekt diskutimesh të ashpra në parlamentet e vendeve të BE.**

# MISTERI I QUAJTUR KOMB
# DHE
# SHQIPTARI I PARË…

Jeta njerëzore përcaktohet nga kufijtë e lindjes dhe vdekjes. Shtyrë nga kjo ndjesi sa edhe për arsye praktike, shkronjësit e historisë janë përpjekur gjithmonë ta ndajnë historinë njerëzore në epoka kohore që kanë një fillim dhe një fund. Edhe pse këto ndarje janë të pasakta dhe artificiale (*si çdo gjë tjetër, edhe historia, nuk lind nga hiçi e nuk shndërrohet në hiç*), nëse respektojmë metodën tradicionale dhe aktuale të ndarjes kronologjike të historisë, mund të themi, se epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, zë fill me jetën dhe mendimin e patriotit Naum Veqilharxhi, që lindi në fshatin Vithkuq të Korçës në vitin 1797.

Vetëm pak vite mbas lindjes së Naumit, familja e tij u detyrua të emigronte në një nga principatat autonome të Rumanisë. Por, edhe pse i rritur larg atdheut, Naum Veqilharxhi si dikur Gjergj Kastrioti, nuk e harroi kombin të cilit ndjente se i përkiste.

Në vitin 1838, shteti rumun kreu një regjistrim të popullsisë. Sipas mendësisë së kohës, shqiptarët e besimit ortodoks u regjistruan si të kombësisë greke dhe ata myslimanë si të asaj turke. Por Naumi këmbënguli dhe i

detyroi autoritetet rumune ta regjistronin si të kombësisë shqiptare duke u bërë i pari qytetar me kombësi shqiptare në mbarë botën.

Pra, Rilindja jonë Kombëtare zë fill me një "Jo!" të vendosur!

Me një akt të prerë mohimi…

**"Unë nuk jam as grek dhe as turk! Feja nuk mund të përcaktojë kombësinë time!"**

Akt mohimi që do të pasohej nga pohimi…

**"Unë jam shqiptar!"**

Pohim ky, që do të trondiste si një tërmet të gjitha planet e fshehta që diplomacia e shteteve evropiane do të thurte për zhbërjen e kombit shqiptar në shekujt që pasuan.

Beteja juridike e Naum Veqilharxhit për të ligjësuar të drejtën e njohjes së kombësisë shqiptare nga shteti rumun, do të paraprihej dhe pasohej nga përpjekjet e tij për shkrimin e një abetareje të gjuhës shqipe, botimin e kësaj abetareje dhe njohjen zyrtare të gjuhës shqipe nga autoritetet e shtetit turk dhe ato të kishës ortodokse.

Nga një lutje për ndihmë drejtuar një nipi të tij, tregtar ky i përmendur për pasurinë e madhe që zotëronte, Naumi do të merrte këtë përgjigje…

"Ç'është ky komb shqiptar që më flet ti mor xhajë? As edhe një libër i vetëm historie nuk shkruan për historinë e tij. Nuk ka pasur kurrë ndonjë shtet të quajtur shqiptar. Të

kështilloj pra, të mos humbasësh më paret dhe kohën me marrëzira të këtilla…"

Nipi i Naum Veqilharxhit kishte të drejtë!

Asnjë libër historie nuk fliste për një komb të quajtur shqiptar. Asnjë shtet në histori nuk kishte mbajtur emrin e këtij kombi. Por megjithëkëtë, Naumi ashtu si shumë bashkëkombës të tij, etër të rilindjes sonë kombëtare, në mënyrë krejtësisht të palogjikshme për mendësinë e kohës kur jetonte, ndjente se i përkiste këtij kombi. Ndjente se ishte shqiptar dhe jo grek, serb, bullgar, rumun apo italian.

Përse?

Çfarë na bën të ndihemi pjesë e një kombi?

Pyetje kjo që na shpie drejt të tjerave akoma edhe më tunduese.

Çfarë është kombi?

Cilat janë arsyet që përcaktojnë krijimin dhe mbijetesën e një kombi?

Ndërkohë që shqiptarët të frymëzuar nga idetë e Rilindjes Kombëtare, filluan të luftonin me penë dhe me pushkë që të fitonin të drejtën për të pohuar përpara mbarë botës emrin e kombit të tyre, në vitin 1882, shkrimtari dhe filozofi Ernest Renan do të përpiqej t'i jepte një përgjigje misterit të madh që mbulonte arsyet e lindjes dhe ekzistencës së kombeve. Mister ky, që aq shumë kishte torturuar mendjet e historianëve dhe filozofëve përgjatë shekujve.

Në kërkim të kësaj përgjigjeje kaq tunduese por edhe të rrezikshme për një kohë kur mendohej se, për të bërë apo zhbëre një komb, mjaftonin firmat e diplomatëve të fuqive të mëdha evropiane, Renan qëmtoi me kujdes të gjitha teoritë që politologët, filozofët dhe historianët kishin ngritur në kohë për misterin e quajtur komb.

Kujdes!

Teori që fatkeqësisht, akoma edhe në ditët e sotme, mund t'i dëgjoni të propagandohen si të vërteta absolute në faqet e librave (*madje edhe ato shkollorë*), gazetave apo prej gjuhëve përpëlitëse të opinionistëve tanë mendjendritur, që çdo mbrëmje na dyndin nga ekranet gjithnjë e më të dysta të aparateve televizive.

Sipas më të famshmes ndër këto teori; **lindja, mbijetesa dhe madhësia e një kombi lidhej dhe varej ngushtësisht me ekzistencën historike të një shteti dhe shtrirjes së kufijve të tij**.

Renan, pranon se ishte plotësisht e vërtetë që krijimi i disa kombeve evropiane si për shembull ai francez, e kishin zanafillën në territoret e pushtuara nga shtete të krijuara prej dinastish mbretërore mesjetare.

"**Pushtime së pari të pranuara nga popullsitë e nënshtruara, e më pas, të harruara si të tilla, nga masat e popullit**", thekson Renan.

Krijimi dhe ekzistenca e kombit francez ngjante se dëshmonte vërtetësinë e kësaj teorie. Por, në ç'mënyrë shteti i dinastisë mbretërore franke të Merovingëve që

udhëhoqi pushtimin e Francës gjeografike mbas rënies së Perandorisë Romake, arriti të shndërrojë në një komb të vetëm një popullsi aq të ndryshme nga prejardhja etnike dhe kulturore siç ishte ajo e Provincës Romake të Galisë?

Përgjigja e Renan është cinike sa edhe reale;

"**Harresa dhe falsifikimi i historisë, janë mjetet kryesore që përdor politika shtetërore për krijimin e një kombi të ri. Kjo është edhe arsyeja që studimi dhe hulumtimi i historisë bëhen armiku më i madhi politikës shtetërore që kërkon të krijoj një komb të ri. Hulumtimi i historisë sjell në dritë, dhunën e kryer gjatë bashkimeve të detyruara të popullsive nga politika shtetërore. Madje, edhe në rastet kur pasojat e kësaj politike kanë qenë pozitive, bashkimi është kryer gjithmonë në mënyrë të dhunshme. Bashkimi i Francës Veriore me atë jugore ishte rezultat i një masakre dhe terrori që vazhdoi për më shumë se një shekull**".

Por shumë kombe në mbarë botën ashtu si edhe kombi shqiptar, ndryshe nga ai francez, ndjeheshin të tillë, edhe pse nuk kishin pasur asnjëherë në historinë e tyre një shtet që t'i kishte bashkuar dhunshëm brenda kufijve të tij.

Si ishte e mundur?

Cila ishte arsyeja apo shkaku i mistershëm që i kishte bëre këto bashkësi individësh të ndjeheshin pjesë të një kombi të ndryshëm nga kombet e tjera?

Mos ndoshta kjo arsye, ishte ajo që politologët evropianë të shekujve XIX dhe XX, e quanin faktori "racë"?

"**Është e vërtetë që raca ruan akoma kuptimin e saj në zoologji**", përgjigjet Renan**, "por, nga ana tjetër, duke njohur se prej miliona vitesh njeriu është ndarë nga bota e kafshëve, ideja e studimit të ndikimit të saj në zhvillimin e shoqërisë njerëzore është krejtësisht absurde dhe e palogjikshme. Shumë kombe, si për shembull gjermanët apo italianët, u krijuan nga bashkimi i racave dhe popujve të ndryshëm, por kjo, nuk i ka penguar aspak të ndihen një komb më vete**".

Mos ndoshta arsyeja e krijimit dhe mbijetesës së një kombi ishte gjuha e përbashkët?

–Aspak! – do të kundërshtonte prerë Renan.

Anglia dhe Shtetet e Bashkuara, edhe pse flisnin të njëjtën gjuhë, nuk ishin një komb i vetëm dhe e njëjta provë, vlente edhe për kombet e Amerikës Jugore që edhe pse flisnin spanjisht, nuk ishin e nuk ndjeheshin pjesë e kombit spanjoll.

Mos ndoshta arsyeja e krijimit të kombit ishte feja?

–Jo! – do të mohonte i vendosur Renan.

Në disa prej kombeve evropiane praktikoheshin dy apo më shumë besime fetare, por ky fakt, nuk ishte bërë shkak që këto kombe të shpërbëheshin.

Atëherë…

Çfarë përcaktonte krijimin dhe mbijetesën e një kombi?

Ernest Renan do t'i jepte kësaj pyetje një përgjigje të paparashikueshme…

"**Kombi është një gjendje shpirtërore dhe si i tillë ka një zanafillë shpirtërore.**

**Dy ndjesi që nuk mund të ndahen nga njëra–tjetra, i japin jetë zanafillës shpirtërore nga ku lind kombi dhe ushqejnë shpirtin që e mban atë gjallë. Njëra i ka rrënjët në të shkuarën dhe tjetra në të ardhmen. E para, lidhet me ekzistencën e një thesari kujtimesh që mbartin së bashku në kujtesë një grup individësh. Kurse e dyta, lidhet me vullnetin që shpreh ky grup individësh për ta ruajtur këtë thesar kujtimesh dhe dëshirës për t'ia lënë trashëgim pasardhësve, ashtu si ata vetë, e kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre. Njeriu nuk mund të transformohet sipas dëshirave të momentit. Edhe kombi, ashtu si individi, është pjellë e një të shkuare të gjatë e të mundimshme, gjatë së cilës, për mbijetesën e tij, janë kryer shumë sakrifica e përkushtime. Nderimi i paraardhësve tanë, ndër të gjitha besimet fetare është ai më i natyrshmi dhe i ligjshmi sepse janë këta paraardhës, ata që na kanë krijuar ashtu siç jemi sot. Një e shkuar heroike, njerëzish të mëdhenj dhe lavdie, është boshti shoqëror ku mbështetet ekzistenca e një kombi**".

Mbi gjithçka tjetër, sipas Renan, lindja, ekzistenca dhe mbijetesa e një kombi, përcaktohet nga kujtesa e tij historike. Nga kultura, mitet, legjendat, përrallat, këngët,

traditat të krijuara në shekuj falë frymëzimit që kjo kujtesë historike rrezatonte.

Ishte pikërisht ekzistenca e kësaj kujtese historike dhe kulturore të trashëguar nga të parët, vullneti për ta mbrojtur dhe dëshira për t'ia lënë këtë kujtesë historike dhe kulturore në trashëgim pasardhësve, faktori X apo esenca e magjishme që përcaktonte lindjen dhe mbijetesën e një kombi në histori.

Naum Veqilharxhi dhe etërit e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishin bij të një kombi të vogël i cili sipas teorive të politologëve evropianë të përmendura nga Ernest Renan nuk kishte arsye të ekzistonte, dhe si rrjedhojë, për të mos dëshmuar pavlefshmërinë e teorive të tyre, nuk duhej të ekzistonte.

Bij të një kombi, që nuk kishte pasur kurrë një dinasti mbretërore që t'i kishte bashkuar brenda kufijve të një shteti të vetëm.

Bij të një kombi, që në pjesën dërrmuese të historisë së tij, kishte qenë i ndarë ekonomikisht dhe politikisht nga kufijtë e dy apo më shumë shteteve.

Bij të një kombi, pjesëtarët e të cilit ishin besimtarë të feve të ndryshme.

Por, të gjithë këta faktorë që në teoritë e politologëve evropianë të përmendur nga Renan, dëshmonin për mos ekzistencën e kombit shqiptar, nuk kishin mundur të zhbënin nga shpirti i shqiptarëve ndjesinë e të qenit pjesë e një kombi të ndryshëm nga të tjerët.

Akti i mohimit i Naum Veqilharxhit, "**Unë nuk jam, as grek, as serb, as turk, as italian!**", i pasuar nga pohimi, "**Jam shqiptar!**" dhe vetë ekzistenca e kombit shqiptar, dëshmonin për vërtetësinë e përgjigjes që Ernet Renan i dha pyetjes se çfarë ishte një komb dhe çfarë kushtëzonte lindjen dhe mbijetesën e tij.

Pra...

**Nëse duam të jemi, të ndjehemi shqiptar edhe përgjatë rrjedhës së panjohur të historisë së këtij shekulli të ri, duhet mbi gjithçka tjetër, të mësojmë, ruajmë dhe të mos harrojmë, historinë e të parëve tanë, pa mundin, gjakun, djersën dhe sakrificat e të cilëve nuk do të ishim mbi këtë botë.**

Tiranë, 28 Nëntor 2015.

# SPORTI, OLIMPIADAT, POLITIKA, DHE…
## RRËFENJA E KRIJIMIT TË NJË KOMBI TË RI

Përpiquni të përfytyroni sikur shqiptarët e quajtur "lal" dhe ata të quajtur "lab", së bashku me krahinat përkatëse ku jetojnë (Myzeqenë dhe Labërinë), të shkëputur nga Shqipëria për një arsye apo një tjetër, do të vendosnin të krijonin një shtet më vete, shtet të cilin, frymëzuar nga emrat e tyre krahinor (Lalë dhe Lab) por edhe për ti bërë qefin edhe Parisit, Brukselit dhe Madridit, do ta quanin OLALA dhe veten OLELEZ.

Parisi, Brukseli dhe Madridi, të kënaqur me emrin OLALA të shtetit dhe atë OLELE të "kombit të ri", që aq shumë i ngjante thirrjes "OLE!" të spanjollëve dhe asaj "O La La!" të frëngjisht folësve, do ti dhuronin Olelezëve një flamur të ri fringo, të cilin, nga ajo ditë e tutje, Olelezët duhej ta valëvisnin mbi krye në vend të flamurit me shkabë të zezë që kishte përfaqësuar etërit, gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre.

Dhe ç'flamur pa…

Tjetër më të bukur nuk kishe ku të gjeje!

Ishte i kaltër si qielli. Në qendër, vizatuar me ngjyrë të artë, shkëlqente pamja e hartës së trojeve ku jetonin lalët dhe labët, e cila, ndriçohej nga drita e shtatë yjeve vezullues që ngjante sikur hidhnin valle mbi të.

Veç flamurit, fuqitë e mëdha i dhuruan Olelezëve edhe një kushtetutë të shkruar nga një grup ekspertësh evropianë, ku, në krye fare, me shkronja të mëdha, shkruhej se;

**1. Olelezëve u ndalohet në përjetësi të ribashkojnë vendin e tyre me Shqipërinë.**

**2. Vrasja e një olelezi, dënohet nga ligji, po aq sa edhe vrasja e një qeni.**

Përtej dyshimeve nëse, nenin e dytë të kushtetutës së tyre, ekspertët konstitucionalistë të Evropës e kishin shkruar të nxitur nga dashuria për kafshët apo nga mospërfillja për vlerën që kishte për ta jeta e një olelezi, olelezët me këngë e me valle, me olelera dhe tralalara, e shpallën ditën e ardhjes së kushtetutës nga Evropa, festë kombëtare.

Të pajisur kësisoj me flamur dhe kushtetutë, olelezët vendosën njëzëri që kishte ardhur koha ta përfaqësonin denjësisht kombin e tyre të ri në veprimtarit sportive ndërkombëtare,. sepse, në ato politike, siç ishte Lidhja e Kombeve, Evropa ja u kishte ndaluar hyrjen.

Deri kur?

Eh! Këtë Olelezët nuk e dinin!

"Ndoshta kurrë, ose ndoshta nesër. Varet nga sjellja juaj", i ishte përgjigjur Evropa.

Kështu ndodhi që olelezët, edhe pse, të mosnjohur si komb nga Lidhja e Kombeve, krijuan një kombëtare futbolli dhe futbollistët "lal" dhe "lab" që deri në atë kohë luanin me Kombëtaren e Futbollit të asaj që kishte ngelur nga vendi i quajtur Shqipëri, shkuan të luanin me Kombëtaren e Futbollit të kombit të ri të olelezëve…

"Po më thoni të ndalem, sepse… Edhe imagjinata duhet të ketë një kufi! Sepse… Ajo që po tregoj nuk është një rrëfenjë imagjinare por një rrëfenjë absurde!"

Rrëfenjë absurde?

Si mund ta quani absurde ndërkohë kur, ekranet e TV tuaj, gëlojnë nga pamjet e sportistëve shqiptar nga krahina shqiptare e Kosovës, që druhen, kanë turp apo frikë, të shpalosin krahas flamurit të shtetit të Kosovës (qytetar të të cilit tashmë janë) edhe flamurin që tregon përkatësinë e tyre kombëtare?

Si mund të jetë e tillë kur faqet e mediave elektronike, gjëmojnë, dridhen dhe përloten, nga fjalimet e sportistëve (fjalime të cilat, nuk ngjajnë aspak si të dalë nga zemrat e panjolla të sportistëve por nga penat e ndyra me gjak e me llum të politikës) që ja kushtojnë medaljet olimpike "kombit të ri të Kosovës", pa guxuar qoftë edhe një herë të vetme të përmendin fjalët, Shqipëri dhe shqiptarë?

Rrëfenja e Olelezëve nuk mund, nuk duhet t'ju ngjaj aspak absurde ndërsa shihni se si, ngadhënjimi olimpiko – mediatik i flamurit të "kombit të ri" kosovar mbi atë, flamurin e vjetër, flamurin me shkabë të zezë, flamurin e

njomur dhe pluhurosur nga gjaku i dhjetëra qindra betejave që shqiptarët kanë kryer për ti mbijetuar zhdukjes, flamurit të heronjve që na e kanë lënë trashëgim të parët, flamurin pa të cilin sot nuk do të ekzistonim, flamurin e Skënderbeut, u pasua thuajse si të ishte pjesë e një programi të mirë përcaktuar, nga lajmet për futbollistët që braktisnin kombëtaren e futbollit të Shqipërisë për të shkuar tek ajo e Kosovës.

Shumëkush prej nesh, nuk dyshoj aspak, me zemër të pastër dhe shpirt të sinqertë, u nxitua ti mbronte sportistët që shpërfillën flamurin e vjetër të kombit tonë të vjetër, me arsyen se sporti nuk duhej ngatërruar me politikën, se sporti, nuk është politik!

Sporti nuk është politik!?

Nga leximi i Historisë, të vetmes dituri që mund të shërojë plagët (ekonomike, shoqërore dhe politike) që torturojnë shpirtin e kombit shqiptar, do të mësonim se, lindja e sportit konkurrues (ai ku fituesi nderohet me një çmim) është pjellë pikërisht e politikës. Zhvillimi i Olimpiadave antike (të quajtura më pas panhelene) zuri fill nga nevoja e përfaqësuesve të mbretërive dhe qytet – shteteve të Greqisë qendrore dhe jugore për të kryer takime politike gjatë të cilave do të nënshkruheshin aleanca ushtarake, diplomatike, tregtare, vendosej fillimi i një lufte apo fundi i një tjetre. Për këtë arsye, disa shekuj më pas nga data hipotetike e Olimpiadës I (776 p.e.s),

pikërisht kjo datë, u konsiderua nga historianët si viti 1 i historisë së kombit të ri të quajtur Helen.

Një komb i ri që zë fill me një Olimpiadë?

Mos ndoshta historia po përsëritet?

Apo…

Ndoshta dikush po investon që historia të përsëritet?

Kush?

E kush tjetër veç politikës që kërkon me ngulm lindjen e një kombi të ri të quajtur kosovar (me një histori të re dhe një flamur të ri), njësoj ashtu si politikanët e mbretërive dhe qytet shteteve të Greqisë qendrore dhe jugore, të fshehur pas datës hipotetike të olimpiadës I, shpallën krijimin e kombit të ri që quajtur helen?

Por…

Tamam njësoj nuk është, sepse, për fatin e keq të shqiptarëve, ky "kombi i ri" që politika ngjan se po kërkon të krijoj e fshehur pas emrit të olimpiadës dhe fitoreve olimpike, ngadhënjimit mediatik të flamurit të "kombit kosovar" të shoqëruar nga harresa dhe shpërfillja për flamurin e kombit shqiptar, nuk është pjellë e bashkimit (si në rastin e përpjekjeve për krijimin e kombit helen!) por fryt i përçarjes, i copëtimit të kombit shqiptar.

Oh!

Le ti shmangemi këtyre hipotezave absurde dhe të vazhdojmë me mësimet e historisë.

Fuqitë e mëdha evropiane, mbasi krijuan në vitin 1832 shtetin e quajtur Greqi, shkruan për të një kushtetutë dhe

përzgjodhën një mbret; thuajse gjysmë shekulli më pas, organizuan Olimpiadën I moderne për ti prezantuar botës krijimin, apo më saktë rikrijimin e kombit të ri helen, (për më shumë sesi u krijua ky komb i ri mund të lexoni "Evropa dhe profecia e Johan Georg Von Hahn").

Nga 14 vendet që morën pjesë në Olimpiadën I, Greqia, kombi i ri helen, fitoi numrin më të madh të medaljeve, plot 46.

Si ishte e mundur që një vend si Greqia, më i prapambeturi dhe më i varfëri ndër të gjitha vendet e tjera pjesëmarrëse, të fitonte 46 medalje?

Për të mundësuar triumfet olimpike të Greqisë, organizatorët e Olimpiadës, krijuan një ligj tejet të veçantë…

Në Olimpiadën e parë, ju ndalua pjesëmarrja të gjithë atletëve profesionistë dhe ashtu siç kishin parashikuar organizatorët, Greqia triumfoi. Flamuri i ri i kombit të ri helen, u bë i njohur në mbarë botën. Gazetat e mbarë botës së qytetëruar shkruan për ringjalljen e kombit të Akilit, Agamenonit, Herkulit, Maratonomakut edhe pse, ajo, e vërteta ishte disi e ndryshme…

Mes përfaqësuesve të kombit të ri helen që fituan një medalje në Olimpiadën I, ishte edhe fituesi i garës së maratonës, Spiridhon Louisi. Këto ditë olimpiadash, famujsh që ngrihen dhe famujsh që shpërfillen, "harrohen" të mbarten mbi krahët e fituesve, mediat shqiptare do të shpallnin zbulimin e radhës se; Spiridon

Luisi ishte arvanitas… Pra shqiptar… Pra, që shqiptarët kishin fituar medalje edhe në Olimpiadën I!

E vërteta e hidhur është se, Spiridon Luisi ishte…

Analfabet!

Nuk dinte as të shkruante dhe as të lexonte.

Gjithçka që historia kujton nga biografia e Spiridhonit është se, kishte punuar si mbartës uji, ishte rekrutuar nga ushtria greke dhe pastaj kishte ngritur flamurin e kombit të ri helen në Olimpiadën I. Mendjes së tij i ishte ndaluar, mohuar të mësonte historinë e familjes, gjuhës, kombit që i përkiste dhe, si i tillë, Spiridonit i ngelej të ishte vetëm helen.

Pak vite mbas triumfit olimpik të helenit kujtesvrarë Spiridhon Luisit, ushtria e shtetit grek ku bënin pjesë shumë arvanitas (që triumfet e Olimpiadës I i kishte dhënë një arsye më shumë, të pranonin dhe ndjeheshin krenarë për emrin helen), pushtoi Shqipërinë e Jugut duke plaçkitur, dhunuar dhe vrarë të gjithë ata shqiptarë që nuk pranonin ta quanin veten helenë. Përballë këtyre masakrave, opinioni publik ndërkombëtar akoma i hipnotizuar nga rrëfenjat e Olimpiadës I, jo vetëm që nuk bëri asgjë për ti ndalur, por madje, edhe e miratoi kryerjen e tyre. Greqia e triumfuesve të Olimpiadës I, e meritonte të bëhej e madhe!

Ironia e fatit do të bënte, që shumë vite të tjera më pas, kujtesëvrari dhe i pagoji Spiridhon, simbol i Greqisë së re, i triumfeve Olimpike të flamurit të kombit të ri helen, gjatë

ceremonisë së hapjes së Olimpiadës së XI (1936) do ti dhuronte Adolf Hitlerit një degë ulliri, simbolin e paqes dhe mirësisë. Me këtë degë ulliri në duar, Adolf Hitleri, shpalli para botës, lindjen e kombit të ri gjerman!

Bota e mahnitur nga 89 medaljet e fituara nga Gjermania, do ta adhuronte Gjermaninë e re naziste dhe flamurin e saj të ri me kryq të thyer, të dyja të krijuara nga Adolf Hitleri.

Por, shumë shpejt, adhurimi për "kombin e ri" gjerman dhe flamurin e ri me kryq të thyer, i mbarsur nga medaljet olimpike që fitoi Gjermani Naziste, do të shndërroheshin në lot dhe gjak për botën dhe për Greqinë e Spiridhonit.

Gjithkush që ka përjetuar apo studiuar historinë e të quajturës "luftë e ftohtë" midis Bashkimit Sovjetik dhe Sh. B. A (Traktatit të Varshavës dhe Natos), e di fare mirë se kjo luftë, më shumë sesa në Vietnam, Kore dhe Kubë, u pasqyrua egërsisht në arenat e lojërave Olimpike.

Olimpiada XXII (Moskë 1980) u bojkotua nga Sh.B.A dhe 64 vende të tjera, në shenjë proteste për pushtimin e Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik, por kjo, nuk e ndali zhvillimin e Olimpiadës, në të kundërt, vendimi i Presidentit U.S.A, Xhimi Karter, që vendosi që atletët amerikanë të bojkotonin Olimpiadën, u konsiderua nga qytetarët amerikanë si shenjë frike dhe dezertimi përballë B.S në fushëbetejën e fitoreve olimpike.

Përfundimi?

Xhimi Karter humbet zgjedhjet për president të vitit 1980…

Shumica dërrmuese e sporteve olimpike, për mungesë të simpatizantëve që i ndjekin këto sporte, mbijetojnë në formën e një aktiviteti sportiv profesionist dhe jo të një loje argëtuese të papaguar, vetëm falë financimeve shtetërore, pra, vetëm falë politikës së shteteve për të shfaqur përpara mbarë botës ekzistencën dhe forcën e tyre ekonomike, kulturore dhe politike. Edhe pse Olimpiadat antike ishin pjellë e politikës dhe u përdorën për përmbushjen e një qëllimi politik (krijimin e kombit helen) në to, atletët nuk përfaqësonin shtetet, qytetarë të të cilëve ishin, por vetëm vetveten. Lavdia apo disfata ishte, thjesht dhe vetëm individuale dhe jo e shtetit qytetar të të cilit ishin. Në të kundërt, në Olimpiadat moderne, fitoret nuk janë të atletëve por të flamujve që këta ngrenë me fitoret e tyre.

Lista e dëshmive që tregojnë sesi sporti (dhe në veçanti Olimpiadat) është përdorur nga politika si mjet për të përmbushur qëllimet e saj, është e gjatë. Për fat të keq, skenat e triumfeve olimpike dhe post olimpike të flamurit të shtetit të Kosovës, të shoqëruara nga shpërfillja apo harresa e flamurit kombëtar dhe lajmet për largimin e disa lojtarëve të kombëtares së futbollit të Shqipërisë për të shkuar tek ajo e Kosovës, tregojnë që tashmë, politika që kërkon me ngulm krijimin e një kombi të ri kosovar, po përpiqet dhe po investon të përdorë për përmbushjen e këtij qëllimi edhe sportistët shqiptarë nga Kosova. Është e

natyrshme të dyshosh se edhe pranimi i shtetit të Kosovës në organizatat sportive ndërkombëtare ndërkohë që i mohohet njohja në organizatat politike si OKB etj, është bërë në këmbim të premtimit që sportistët që do të përfaqësojnë shtetin e Kosovës në veprimtaritë sportive ndërkombëtare, do të heshtin, harrojnë, shpërfillin, mohojnë, përkatësinë e tyre kombëtare.

Vallë a do të pranojnë në të ardhmen sportistët shqiptarë nga Kosova të bëhen pjesë e këtij kompromisi që i detyron të harrojnë, mohojnë dhe të shpërfillin flamurin që tregon përkatësinë e tyre kombëtare?

Të harrojnë, mohojnë dhe shpërfillin gjuhën dhe historinë e kombit që i ka lindur?

Përtej përgjigjeve të këtyre pyetje, sportistët shqiptarë nga Kosova kanë një fat të madh…

Ndryshe nga Spiridhon Luisi, ata mund të zgjedhin!

Të pohojnë qartë dhe prerë…

Unë jam Shqiptar dhe ky, flamuri me shkabën e zezë dy krenare, është flamuri i kombit të cilit i përkas!

Në të kundërt, të shndërruar në individë pa të shkuar e pa të ardhme, pa komb e pa atdhe, fitoret, triumfet e tyre olimpike do të harrohen sikur të mos kishin ndodhur kurrë.

Tiranë, 19. 08. 2016.

# SHQIPTARËT
# MIDIS SHILËS DHE KARIBDËS...

Gjatë udhëtimit drejt atdheut të humbur, shumë e shumë herë, Uliksi ishte munduar nga pesha e mëdyshjeve rraskapitëse dhe shpirt vrasëse...

Çfarë vendimi duhej të merrte?

Kë rrugë duhej të zgjidhte?

Të shkonte këndej apo andej?

Kishte marrë vendimin e duhur apo ndoshta...

Ishte gabuar?

Por, më shumë se çdo herë tjetër, mëdyshjet për vendimin që duhet të merrte e kishin munduar kur u gjend përballë Shilës dhe Karibdës...

Dy brigje.

Dy shkrepa nga re të zeza mbuluar.

Në mes, të frikësuara dhe pa zhurmë, rridhnin valët e detit.

Në njërin breg vigjilonte Shila, një qenie e përçudnuar që kishte 12 këmbë dhe gjashtë koka. Çdonjëra prej kokave kishte një gojë dhe çdo gojë, tre rreshta dhëmbësh të gjatë e të mprehtë si të ishin shpata.

Në bregun tjetër vërtitej e uritur Karibda që me gojën e hapur si një vorbull e zezë, së bashku me ujin e detit, gëlltiste çdo anije që pranë i lundronte.

"Nga të shkoj? Nga të iki? Kë të zgjedh? Dhëmbët e Shilës apo barkun e Karibdës?", pyeste e stërpyeste veten Uliksi.

Ndryshe nga Uliksi, shqiptarët që qëndrojnë përballë ekraneve të stacioneve TV, që askush nuk e di, se përse quhen kombëtare, nuk kanë mundësi zgjedhjeje.

Në njërin shfaqet seriali televiziv turk "Ertrugul"...

Historia imagjinare e babait të babait të kombit turk të quajtur Ertrugul. Përveç faktit që, siç përmendëm, kemi të bëjmë me një histori imagjinare, pra, me shkrimin e një historie të paqenë, gjithçka në këtë serial TV është e përkryer. Skenari është i shkruar mjeshtërisht dhe i kontrolluar me kujdes nga tre historianë akademikë. Veshjet e personazheve, karakteret, edukata që ata përçojnë, i krijojnë shikuesit përshtypjen se, fiset nomade turke të shekullit XIII, ishin aq të qytetëruar sa do t'ia kishte zilinë edhe një evropian i shekullit XXI. Një shoqëri njerëzish fisnikë që vetë zoti i kishte përzgjedhur për të sunduar mbi të gjithë popujt e botës dhe për të krijuar një perandori.

Për fatin tonë të keq, një prej këtyre popujve që do të sundoheshin nga pasardhësit e këtyre fiseve nomade turke (të përshkruar si fisnikë e të qytetëruar në serialin Ertrugul) që në shekullin e XIV do të hynin brenda kufijve

aziatikë të Perandorisë Bizantine, ishin edhe shqiptarët që akoma edhe sot, nuk po mundin të zhbëjnë nga trupi i kombit të tyre ligështinë morale dhe fizike (copëtimin politik të kombit shqiptar) që i la pas ky "qytetërim" i ardhur nga stepat e Azisë.

Nëse nuk e njeh historinë, atë të vërtetën të mbushur me male kufomash, gjak, përdhunime, shkatërrime, masakra të trupave dhe masakra të shpirtrave që finalizoheshin me masakra të diturisë dhe të kujtesës historike, është e pamundur që të mos i adhurosh heronjtë e serialit Ertrugul.

Edhe pse na dhemb shpirti dhe trupi nga plagët dhe varret që i shkaktoi kombit tonë pushtimi turk, nuk mundemi ta mohojmë që seriali TV i titulluar "Ertrugul" është tërheqës. Në të njëjtën kohë, nuk mundemi të fajësojmë skenaristët dhe regjisorët e këtij seriali, që për të nderuar atin e heroit të tyre kombëtar, kanë krijuar një histori të paqenë.

Po stacionet TV shqiptare dhe për më tepër ato që quhen kombëtare, çfarë bëjnë për të nderuar heroin e tyre kombëtar?

Ndryshe nga Ertruguli dhe fisi i Kaive, për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti dhe ndërmarrjen mbinjerëzore që kreu populli i tij, janë shkruar me dhjetëra libra, biografi dhe poema.

Pra...

Ndryshe nga autorët dhe prodhuesit e serialit turk "Ertrugul", ata shqiptarë kanë në dispozicion një thesar të pafundëm historie të shkruar, theksoj të shkruar dhe jo imagjinare si në rastin e Ertrugulit.

Por ...

Ndërkohë që kolegët e tyre turq rishkruajnë historinë apo më saktë, krijojnë histori e paqenë të një heroi fisnik në krye të një populli fisnik, prodhuesit dhe autorët e mediave kombëtare shqiptare, preferojnë të shpërfillin, përbuzin, përçudnojnë thesarin e kujtesës historike evropiane që rrëfen bëmat e Gjergj Kastriotit dhe popullit të tij, që gjunjëzoi për gjysmë shekulli perandorinë më të madhe të botës, dhe, i shërbejnë në pjatë popullit shqiptar një pseudo komedi të titulluar "Skënderbe" ku, paraardhësit e lavdishëm të shqiptarëve të sotëm, paraqiten si mbartës e të gjitha veseve të mundshme që ka prodhuar njerëzimi...

Midis Shilës dhe Karibdës, Uliksi zgjodhi Shilën.

Humbi shumë prej shokëve të tij më besnikë por shpëtoi anijen.

Po shqiptarët, a kanë mundësi të zgjedhin?

Kë të zgjedhin?

Çfarë të zgjedhin?

Të zgjedhin Ertrugulin trim, prijës i një populli fisnik dhe të "qytetëruar" që i afron televizioni kombëtar Klan?

Apo...

Të zgjedhin “Skënderbeun”; prijësin ikacak të një populli frikacak, pervers, budalla dhe imoral që i afron platforma TV Kombëtare Digitalb?

KËTO JANË MUNDËSITË E ZGJEDHJEVE QË I AFROJNË SHQIPTARËVE TV TONA TË QUAJTURA KOMBËTARE!

KOMBËTARE...?

Tiranë, 19. 01. 2017.

# KUSH PO I GËNJEN ÇAMËT?
# APO…
# ÇAMËT PO GËNJEJNË VETVETEN?

Vetëm një ditë përpara vizitës së radhës të Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, z. Ditmir Bushati në shtetin grek, z. Dr. Abaz Hodo, kryetar i shoqatës "Çamëria", me tejet "**respekt dhe konsideratë të lartë**", do t'i shkruante ministrit të sipërpërmendur një letër të hapur, (Gazeta Panorama, 21. 03. 2016).

Pasi i përshkruan me pak fjalë ministrit, historinë e tij familjare dhe atë të shoqatës "Çamëria", z. Dr. Abaz Hodo, i zbulon ministrit edhe një histori të panjohur...

Historinë e shqiptarëve të Çamërisë!

"**Ne pësuam të njëjtin fat, që Millosheviçi tentoi ndaj shqiptarëve të Kosovës; një situatë të ngjashme me genocidet ndaj shqiptarëve të Nishit apo Sanxhakut, dy shekuj më parë. Pra një përpjekje e vazhdueshme për të rrudhur dhe cunguar, hapësirën ku jeton kombi ynë. Ne u dëbuam sepse ishim shqiptarë e, rrjedhimisht çështja jonë nuk është e "jona" si pasardhës të të vrarëve dhe të dëbuarve, por është e jona si shqiptarë**", (e marrë pa ndryshime nga gazeta "Panorama").

Sigurisht që tashmë, ju do t'më pyesni se për ç'zbulim apo histori të panjohur e kam fjalën, kur, historinë aq të dhimbshme e tragjike të dëbimit të dhunshëm të popullsisë shqiptare të Çamërisë, në Shqipëri, e dinë të gjithë, madje, edhe fëmijët e shkollave fillore.

Të gjithë?

Vërtet e dinë të gjithë?

Edhe pse mund t'ju ngjajë absurde, e bëj këtë pyetje sepse, nëse është ashtu siç mendoni ju, pra, që historia e dëbimit të shqiptarëve nga Çamëria është e njohur nga të gjithë, përse vallë z. Dr. Abazi, ndjeu nevojën t'ia rrëfente ministrit tonë të jashtëm?

Dhe…

Nga kjo pyetje, të lindin natyrshëm edhe dy pyetje të tjera…

Mos ndoshta z. Dr. Abazi, me gjithë respektin dhe konsideratën që shpreh për ministrin, dyshon se mos ndoshta ai, Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë, nuk e njeh historinë e dëbimit të shqiptarëve nga Çamëria?

Por…

Nëse me të vërtetë z. Dr. Abazi brehet nga pesha e një dyshim të tillë, atëherë, si mund të ketë konsideratë dhe respekt (*ashtu si shprehet në fund të letrës së hapur*) për një ministër, që nuk e njeh një nga faqet më tragjike të historisë së Shqipërisë?

Si mund të shpresojë, se një ministër i këtillë, që nuk njeh historinë e popullit të tij, do të dijë të shtrojë çështjen e shqiptarëve të Çamërisë, në bisedimet me shtetin grek?

I pa shqetësuar nga pesha e dyshimeve që mbars në mendjen e lexuesit, z. Dr. Abazi, i zbulon më tej ministrit edhe se…

"**Ne u dëbuam sepse ishim shqiptarë e, rrjedhimisht, çështja jonë nuk është e "jona", si pasardhës të të vrarëve dhe të dëbuarve, por është e jona si shqiptarë. Për këtë arsye, po ju drejtohem për një çështje tuajën, çështjen e shqiptarëve të Çamërisë. Kjo çështje është e juaja dy herë; si shqiptar dhe si ministër i Republikës së Shqipërisë. Si shqiptar, sepse është një çështje e përbashkët e mbarë kombit shqiptar dhe si ministër, për shkak të detyrimeve të shumëfishta që keni në këtë lëmë**".

Frazë kjo, që, rishtazi, të nxit të pyesësh veten se mos ndoshta, z. Dr. Abazi dyshon që ministri nuk i di, apo ndoshta, për një shkak apo një tjetër i nënvleftëson të gjitha këto…

Pra nuk di apo nënvleftëson, faktin që…

Shqiptarët u dëbuan nga shteti Grek, për të vetmen arsye dhe faj sepse, ishin shqiptarë!

Dëbimi i shqiptarëve nga Çamëria është dhe do të jetë pjesë e pandashme e historisë së kombit tonë dhe një çështje mbarë kombëtare!

Që…

Ministri e Republikës së Shqipërisë, si shqiptar dhe si ministër, e ka për detyrë të bëj publike qenësinë e kësaj çështjeje!

Është e logjikshme të mendosh që nëse z. Dr. Abazi dyshon se ministri nuk i di të gjitha këto, në vend të një letre të hapur për ministrin, nënvizojmë, të shkruar me respekt dhe konsideratë të lartë, duhej të kërkonte pa asnjë mëdyshje dorëheqjen e tij.

Por…

Z. Dr. Abazi, në vend të dorëheqjes, si një baba i kujdesshëm që edukon të birin, pasi i mëson ministrit historinë aq të panjohur të shqiptarëve të Çamërisë, i jep atij edhe këshilla të hollësishme se si, të mos bjerë pre e kurtheve greke…

– Biri im, nëse ata, grekërit, do të thonë kështu, ti, përgjigju ashtu…

Mos qeshni. Nuk ka asgjë për të qeshur.

Ja se si e këshillon ministrin. z.Dr Abazi…

"**Jam i bindur se pala greke do të përmendi mashtrimin se paraardhësit tanë kanë bashkëpunuar me forcat naziste. Këtë e kanë thënë, ose nënkuptuar, edhe në praninë tuaj. Në nderin tonë kombëtar, përgjigja juaj duhet të jetë e qartë: shqiptarët e Çamërisë kanë dy veçanti të pagjendura në Ballkan. Ata kanë zhvilluar betejën më të gjatë pa ndërprerje kundër forcave naziste, betejën 55 ditore të Konispolit…**", etj etj.

Një kështillë kjo, tejet dhe krejtësisht e pavlefshme si nga ana diplomatike ashtu edhe nga ana historike, sepse…

Edhe sikur, dhe, theksoj sikur, popullsia shqiptare e Çamërisë të kishte bashkëpunuar me forcat nazi-fashiste, ky bashkëpunim imagjinar nuk e shfajëson aspak shtetin grek për krimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë dhe as ligjëson dhe justifikon dëbimin e tyre.

Mbi popujt e asnjë shteti të Evropës që bashkëpunoi haptazi me nazizmin dhe fashizmin si, Bullgaria, Rumania apo Hungaria, nuk u ushtrua si ndëshkim, as gjenocid dhe dëbim nga atdheu i tyre. Nuk u ushtrua gjenocid dhe dëbim nga atdheu i tyre, as mbi italianët dhe as mbi gjermanët, në vendet e të cilëve lindi nazizmi dhe fashizmi.

Atëherë, çfarë arsye e përçartur mund të na shtyjë të mendojmë se, në ndonjë tryezë diplomatike, gjenocidi dhe dëbimi i shqiptarëve të Çamërisë, mund të justifikohet dhe të përligjet me, një bashkëpunim hipotetik dhe krejtësisht të pabazë me nazi-fashizmin?

Nëse kjo, në të shkuarën apo në të ardhmen, ka ndodhur apo do të ndodhë në një tryezë bisedimesh shqiptaro-greke, do të thotë, që pala shqiptare në këtë tryezë, ka qenë e prirë, për një arsye apo një tjetër, të shfajësojë me ndihmën e kësaj hipoteze, paaftësinë dhe mos dëshirën e saj, për të vënë në vend të drejtën e nëpërkëmbur dhe dinjitetin e shqiptarëve të Çamërisë. Pra, që faji, nuk është aspak i palës greke që ka thurur

gënjeshtrën e bashkëpunimit me nazizmin, por, i palës shqiptare, që e pranon këtë gënjeshtër si arsye të vlefshme për justifikimin e krimeve të pajustifikueshme të gjenocidit, shpronësimit dhe dëbimit që shteti grek ushtroi ndaj popullsisë shqiptare të Çamërisë.

Mbas një sërë përsiatjesh, se çfarë dhe si, ministri, si shqiptar dhe si ministër, duhej t'i kërkonte shtetit grek në emër të shqiptarëve të Çamërisë, z. Dr. Abaz Hodo, kryetar i shoqatës "Çamëria", e mbyll letrën e hapur duke i shprehu ministrit, siç edhe rrëfyem më sipër, respektin dhe konsideratën e tij të lartë.

Listës së gjatë të mësimeve të historisë, këshillave dhe kërkesave që z. Dr. Abaz Hodo i drejtoi ndërmjet letrës së hapur, ministrit të jashtëm z. Ditmir Bushati një ditë para vizitës në Greqi, iu shtuan edhe dy "ftesat" e bëra nga z. Shpëtim Idrizi, kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, parti kjo, që në bisedat e përditshme njihet me emrin "partia e çamëve".

Ftesa?

"**Ju ftoj**", i drejtohet z. Idrizi, Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, "**të thoni të vërtetën e pakundërshtueshme, të shqiptarëve të Çamërisë, të kombit tonë, timin, tuajin!**".

"**Ju ftoj që të mbroni dinjitetin kombëtar dhe parimet e vlerat evropiane, në takimin tuaj në Athinë dhe jam besimplotë se do të ktheheni në Tiranë si Ministër i**

**Jashtëm i Shqipërisë me emrin DITMIR e jo si Dhimitër…**" (sipas, lajme.al).

Ç'ndodhi më pas?

Ministri shkoi në Greqi, buzëqeshi, i shtrëngoi dorën homologut të tij grek z. Nikos Kotzias, dëgjoi me kënaqësi lëvdimet e ministrit grek, që e quajti mik të Greqisë, sepse kishte studjuar në Greqi, buzëqeshi rishtazi, dëgjoi t'i flisnin edhe për emigrantët sirianë, për varret e ushtarëve grekë në Shqipëri, foli paksa për ligjin e luftës, u kënaq me përgjigjen tashmë bajate se Shqipëria dhe Greqia ishin vende miq dhe aleate në NATO, dhe, si mik i Greqisë, i kujtoi shqiptarëve që Shqipëria e mori statusin e vendit kandidat për në BE gjatë presidencës greke, pra falë Greqisë dhe...

Ndryshe nga çfarë e kishte këshilluar z. Dr. Abazi dhe ftuar z. Idrizi, u kthye në Shqipëri pa thënë qoftë edhe një fjalë të vetme mbi çështjen çame.

Përpara se të shkruaja këto fjalë, prita disa ditë me shpresën se, do të dëgjoja reagimin e z.Idrizi apo z. Dr. Abazi, sepse, ajo që kishte ndodhur, ishte e rëndë…

Po t'i besoje fjalëve të z. Dr. Abazi dhe ato të z. Idrizi, meqë ministri nuk tha as edhe një fjalë të vetme për çështjen çame, i binte që ky, sipas fjalëve të tyre, mos e dhëntë zoti, të ishte kthyer nga Greqia si Dhimitraqkë dhe jo si Ditmir.

Që, Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë, ishte i paaftë të thoshte të vërtetën e

pakundërshtueshme e historisë së shqiptarëve të Çamërisë!

Të mbronte dinjitetin kombëtar!

Të kryente detyrat e tij si shqiptar dhe si ministër!

Si mund të pranonin z. Dr. Abazi dhe z. Idrizi të përfaqësoheshin nga një ministër i tillë?

Por…

Çuditërisht, nga z. Dr. Abazi dhe z. Idrizi nuk pati asnjë reagim të bujshëm ashtu siç duhet të ishte, nëse vërtet besonin në fjalët që i drejtuan z. ministër apo do të ishin vërtetë të përkushtuar në misionin e shenjtë të rikthimit të dinjitetit të nëpërkëmbur të popullsisë shqiptare të Çamërisë.

Atëherë, përse vallë, u munduan së koti të shkruajnë letra dhe të bëjnë ftesa?

Mos ndoshta që nesër me to, të lanin duart si Ponc Pilati duke i thënë përkrahësve të tyre se ne, e bëmë tonën, por ai, ministër Dhimitraqka, nuk na dëgjoi?

Meqë, z. Idrizi është në të njëjtin koalicion politik me z. ministër, përse vallë nuk ia bëri që më parë "ftesat" apo kërkesat që kishte ndaj tij, por priti ditën e udhëtimit në Greqi?

Kur pa se ministri nuk e dëgjoi, përse vazhdon të qëndrojë në të njëjtin grupim politik me të?

Përse organizata e drejtuar nga z. Abazi nuk reagon?

Për përfitime politike dhe personale apo ndoshta…

Si z. Idrizi ashtu edhe z. Dr. Abazi, së fundmi u bindën se, z. ministër i Shqipërisë dhe homologu i tij grek, kanë të drejtë dhe ata gabohen?

Pra...

Që çështja çame nuk ekziston?

Që, ndaj popullsisë shqiptare në Çamëri nuk është kryer asnjë padrejtësi?

Kush po luan me çështjen çame, ministri i jashtëm i Greqisë, ministri i jashtëm i Shqipërisë, apo, z.Idrizi dhe z. Abazi?

Mos ndoshta të gjithë së bashku?

Në vend të përgjigjeve nga z. Idrizi dhe z. Dr. Abazi, në ekranet e Tv na u shfaq deputetja Mesila Doda e cila në emër të "partisë së çamëve" shpalli befas se, tanimë e tutje, qëllimi i partisë së saj, nuk ishin më, vetem "çamët" (*sepse problemin e tyre, pas këshillave të z. Abazi dhe z. Idrizi e zgjidhi ministër Dhimitraqka!*) por…

Bashkimi Kombëtar!

A mundemi që t'i besojmë?

Tiranë, 30. 03. 2016.

# ALBIN KURTI, BEN BLUSHI
# DHE
# THYERJA E ËNDRRËS

Në sfond; Skënderbeu, heroi kombëtar i shqiptarëve. Rreth tij, shqiptarë që rrahin, godasin, gjakosin, të tjerë shqiptarë. Kjo ishte pamja e protestës së Prishtinës të 27 Janarit[1].

Përse?

Cilat ishin arsyet?

Kush ishin shkaqet që e nxitën?

Tashmë, të gjitha këto pyetje, ngjajnë të pakuptimta po aq shumë sa të ngjan e marrëzishme të meditosh mbi to.

Shqiptarët panë në rrugët e Prishtinës të ndodhte ajo, gjëma e madhe që nuk e kishin menduar kurrë se do të ndodhte. Magjia e ëndrrës së përmbushur, mrekullia e shtetit të pavarur të Kosovës u thye dhimbshëm duke përgjakur zemrat e shqiptarëve në mbarë botën, që, padashur, u erdhi në kujtesë 17 shkurti i vitit 2008…

Dita e pavarësisë së Kosovës.

Pamja e qytetarëve të Prishtinës dhe mbarë Shqipërisë që thërrisnin me lot në sy…

– Bac, u kry!

Kujt i drejtohej kjo thirje? Adem Jasharit? Isa Boletinit? Bajram Currit? Azem Galicës? Ismail Qemalit?

Por heronjtë nga shtatoret e tyre të gurta, shtrëngonin buzët dhe heshtnin.

E pra, të gjithë këta heronj të gjakut shqiptar nuk luftuan kurrë për një Kosovë të pavarur por për një Shqipëri të bashkuar.

Midis shumë ndjenjave (*të gjitha të hidhura*), përpara pamjeve të dhimbshme të protestës së Prishtinës, shqiptarët befas u bënë të ndërgjegjshëm se në 17 shkurt 2008 e kishin gënjyer Bacën.

Kishin gënjyer vetveten!

Kjo ndjesi e helmët që i brente shpirtin e shoqëruar nga emocione të paforma e kundërshtira mbi arsyet e asaj (*gjëmës*) që po i ndodhte para syve e nuk ishin në gjendje ta ndalnin, do të nxiste shumë shqiptarë të merrnin penën, të përkuleshin mbi tastierën e PC, për të përshkruar atë që mendonin apo për të kuptuar se çfarë mendonin, dhe pastaj ti ndanin mendimet e tyre me vëllezërit dhe motrat e një gjaku.

"Dhimbja kur ndahet, është më e lehtë", thotë populli.

"Shpesh herë, dhimbjet e përbashkëta bëhen shkak për krijimin e një kombi sa edhe janë dëshmi të ekzistencës së tij", shkruan filozofi Ernest Renan.

Kur u ndesha së pari me titullin e "letrës" që shkrimtopolitikani Ben Blushi i dërgonte Albin Kurtit, udhëheqësit

të Lëvizjes Vetëvendosja, mendova që edhe pena e tij ishte frymëzuar nga të njëjtat ndjenja. Isha gabuar! Edhe pse nuk doja ti besoja syve, shkrimto-politikani Ben Blushi nuk ishte tronditur nga pamjet e shqiptarëve që rrihnin shqiptarët, por, sepse…

Albin Kurti kishte gabuar "llogaritë"!

Ja se si e fillon Ben Blushi shkrimin drejtuar Albin Kurtit; "***E kam takuar vetëm një herë Albin Kurtin për të kuptuar se ashtu si shumica e njerëzve që janë produkt i librave dhe i iluzioneve që shkaktojnë ato, ai ka një defekt të pëlqyeshëm: nuk di të bëjë llogari***".

Sigurisht, nëse do t'i dëgjoja këto fjalë të dilnin nga goja apo pena e një inkuizitori, djegësi librash, pra, nga një prej atyre, që shtetet autokratë, diktaturat dhe fetë autoritare nuk kanë pushuar kurrë së prodhuari, kjo nuk do të përbënte asnjë risi. Por, që këto fjalë të dilnin nga mendja dhe pena e një shkrimtari, një njeriu që ngjizte dhe u jepte jetë librave…

Ishte tronditëse sa edhe e frikshme.

E frikshme mbi atë që e pret njerëzimin, në një botë pa libra, ku zot do të bëhet llogaria e ftohtë dhe cinike. Në një botë si ajo që përshkruan Ray Bradbury në "Farenheit 451" ku librat, idetë, shpresat dhe ëndrrat që librat mbartin, konsiderohen si një drogë e dëmshme për shëndetin njerëzor. Prodhuese iluzionesh shterpe (***siç shprehet Ben Blushi***), dhe, si të tilla, edhe të dënueshme nga ligji.

Kush ishte vallë autori i këtyre rreshtave?

Shkrimtari apo politikani Ben Blushi?

Pa dyshim ky i dyti!

Por…

Mos ndoshta gabohesha?

Mos ndoshta kjo frazë ishte pjellë e mllefit cinik të shkrimtarit ndaj atyre librave që ndryshe nga të tijët, mbartnin me vete ide, shpresa, ëndrra dhe mbi të gjitha vijëzonin projektet e një të ardhmeje dhe njeriu më të mirë?

Habia e dytë që më krijoi artikulli i shkrimto-politikanit Ben Blushi ishte mos dëshira e tij, apo përpjekja e mundimshme për të mos përmëndur emrat "Shqipëri" dhe "shqiptar" duke i zëvëndësuar me përcaktimet "Kosovë", "shtet i Kosovës", "kosovarë".

Drama e gjithë asaj që tronditi zemrat e mbarë shqiptarëve si komb, në "letrën" e shkrimto-politikanit Ben Blushi ishte zhbërë, kthyer në hiç, shndërruar në problemin mediokër se si dhe përse, politikani kosovar Albin Kurti gaboi llogaritë politike për të zotëruar qeverisjen e shtetit të Kosovës.

Nëse Albin Kurti gjatë karrierës së tij politike gaboi "diku", "diçka", kjo "diçka" ishte përfshirja në lojën e "llogarive" të vogla sa edhe mediokre të shtetit të Kosovës. Të vogla dhe mediokre sepse, "Lëvizja Vetëvendosje" u mbars nga një ëndërr. Nga ëndrra dhe

ideali i madh që ka mbajtur gjallë shpirtin e kombit shqiptar gjatë aq të mundimshmit shekull të XX…

Endrrës dhe idealit të bashkimi kombëtar!

Ëndërr dhe ideal, pa të cilin, tashmë, kombi ynë me shumë gjasa do të ishte përpirë nga harresa e historisë.

Ishte premtimi i përmbushjes të kësaj ëndrre i shprehur qartë në programin dhe në manifestin politik të "Lëvizjes Vetëvendosje", sa edhe në fjalët e Albin Kurtit, që e shndërroi "Vetëvendosjen" në grupimin politik më të dashur nga shqiptarët e të gjitha trevave të Shqipërisë.

Dhe, kjo ëndërr e madhe që "Vetëvendosja" dhe Albin Kurti ju premtoi shqiptarëve se do të përmbushte, përjashton, shpërfill dhe i përbuz ato llogaritë e vogla për të cilat flet Ben Blushi.

Nëse "diku", "diçka", gaboi Albin Kurti, kjo diçka ishte burgosja e idealit të shenjtë dhe mbarëkombëtar që mbarte "Vetëvendosja", brenda strukturave burokratike të një partie me karakter lokal dhe të izoluar nga pjesa tjetër e Shqipërisë. Nuk e kam fjalën këtu, për atë izolimin e krijuar nga kufijtë, por për izolimin shpirtëror. Shndërrimin e "Vetëvendosjes" në një parti të Kosovës. Pra, të një partie si gjithë të tjerat që muajt e fundit krijoi tek shqiptarët përshtypjen se shqetësohej vetëm për bërjen apo zhbërjen e marrëveshjeve politike dhe llogarive për të zënë karriget e qeverisë së Kosovës. Në këtë këndvështrim Ben Blushi ka të drejtë…

Albin Kurti gaboi, e madje keqasi!

Por, ndoshta më mirë që Albini i gaboi këto llogari, sepse, në të kundërt, në qeverisje "Lëvizja Vetvendosje" do të përballej me një rrezik akoma më të madh…

Korrupsionin që shoqëron në mënyrë të pashmangshme qeverisjen. Njësimit përfundimtar me ata që më shumë se gjithçka tjetër shqiptarët nuk duan ti ngjasojë "Lëvizja Vetëvendosje".

– Ça ke Albin që qahesh dhe ankohesh? Vetë i bëre gabim llogaritë, – i thotë udhëheqësit të "Vetëvendosjes" shkrimto-politikani Ben Blushi.

– Çfarë po bën Albin? Mos u gënje nga llogaritarët mendjengushtë dhe llogaritë e vogla, – e këshillojnë shqiptarët e të gjitha trevave, – Misioni yt dhe i "Lëvizjes Vetëvendosje" është shumë më i madh se kaq. Mos na zhgënje! Ndoshta arsyet e protestës së Prishtinës ishin dhe janë të drejta. Por... Mendohu! Arsyeto! Mos dëgjo adhuruesit e karrigeve! Kush dëshironte më shumë se gjithkush tjetër të shihte në sheshin e Prishtinës, shqiptarë që rrahin shqiptarët? Mos ndoshta ky apo këta "dikush", nesër kanë programuar të shohin shqiptarët të vrasin shqiptarët? Ndiq një rrugë tjetër! Apo më saktë, ktheu në rrugën ku "Vetëvendosja" nisi udhëtimin e saj. Në rrugën e përmbushjes së ëndrrës së madhe të shqiptarëve që shpërfill dhe përbuz "llogaritë" e vogla dhe mediokre, kryerjen e të cilave Blushi të këshillon të mësosh. Në të kundërt, mos luaj me ëndrrën e shenjtë të popullit tonë, dhe, ashtu si tashmë kanë bërë shumë herë disa deputetë

të "Vetëvendosjes", merr përgjegjësinë t'i thuash shqiptarëve se qëllimi i "Vetëvendosjes" është vetëm qeverisja e mirë dhe e ndershme e Kosovës dhe asgjë tjetër më shumë se kaq. Pa u brengosur që e braktise ëndrrën, sepse, populli shqiptar ka dëshmuar që është gjithnjë i aftë të lindi bijë dhe bija që do të punojnë për përmbushjen e saj.

Tiranë, 30. 01. 2015

**1. Është fjala për për protestën e zhvilluar në Prishtinë në datën 27 Janar 2015 nga "Lëvizja Vetëvendosje".**

# RRËFENJË ARKEOLOGJIKE

(e vërteta e fshehur e Antigoneas)

*Projekti i skenarit të një dokumentari që për mungesë fondesh, do të vdiste pa lindur...*

**N**ë mesditën e 21 prillit të vitit 1930, një djalosh i ri, jo më shumë se 25 vjeç, i ngjitet udhëve të ngushta e të gurta të Gjirokastrës. Çanta ushtarake që mban mbi shpinë, këmisha e ndotur, por më tepër pantallonat e shkurtra, tërheqin vëmendjen e vendasve.

Kush është? Nga vjen? Ku shkon?

Në të kundërt, vështrimi i djaloshit është i ftohtë dhe përçmues. Thuajse sikur, pamja e qytetit, aq shumë e çuditshme për të gjithë të huajt që ndër shekuj kishin ecur udhëve të tij si pushtues apo turistë, nuk kishte asgjë të denjë për t'i tërhequr vëmendjen.

Sa vjeç ishte ai qytet? Kur dhe kush e kishte ndërtuar? Cila ishte historia e tij?

Asnjë prej këtyre pyetjeve nuk shqetëson e mendjen e djaloshit që vazhdon të endet udhëve deri kur, së fundmi, gjen atë që po kërkonte. Një hotel. Futet brenda, i tregon pronarit të hotelit pasaportën e Perandorisë Britanike dhe, në fillim me një shqipe të çalë e pastaj me një greqishte jo më të saktë se shqipja, kërkon një dhomë teke.

Pronari, plot mirësjellje, i shpjegon që dhomat ishin dyshe dhe katërshe.

"Dëshiroj të fle vetëm", ia kthen i vendosur djaloshi që, siç do të shpjegonte disa orë më pas në ditarin e tij, nuk donte të flinte në të njëjtën dhomë me një shqiptar sepse, "*ata, flenë të veshur kokë e këmbë, gërhisnin dhe mbajnë erë*".

Për këtë, gërhitjen dhe erën e keqe që mbanin shqiptarët, djaloshi nuk kishte asnjë dyshim. Prej ditës kur kishte kaluar kufirin greko-shqiptar, kishte fjetur nëpër shtëpitë e shqiptarëve që e kishin pritur bujarisht në strehët e tyre të varfra pa e ditur se, ai, i huaji me të cilin po ndanin bukën, do t'ia shpërblente mirësinë duke i quajtur "gërhitës" të "palarë" dhe "kundërmues".

"Atëherë duhet të marrësh një dhomë dyshe", e këshillon pronari i hotelit dhe i tregon çmimet e dhomave të shkruara me shkumës mbi një tabelë të drunjtë.

Djaloshi vështron çmimet me kujdes dhe e kundërshton. Nuk dëshiron të paguaj për dy vetë.

“Unë jam një”, këmbëngul djaloshi duke ngritur lart gishtin tregues.

“Krevatet në dhomë janë dy”, i përgjigjet i zoti hotelit.

Mbas një diskutimi të gjatë mbi çmimin, i huaji pranon të paguaj. Pronari i zgjat çelësin e dhomës dhe e këshillon, që të nesërmen, të mos dalë nga hoteli. Ishte e ndaluar. Qeveria do të bënte regjistrimin e popullsisë.

“Kjo, nuk është e drejtë! Unë jam qytetar britanik”, bërtet djaloshi dhe për të shprehur shpërfilljen dhe bindjen, se ligjet e shtetit shqiptar nuk kishin asnjë pushtet mbi të, tund në ajër pasaportën britanike.

Të njëjtën shpërfillje ndaj ligjeve të shtetit shqiptar, djaloshi e kishte dëshmuar edhe kur, një muaj më parë, kishte kaluar ilegalisht kufirin Greko-Shqiptar diku mes maleve të Çamandës. Në qytezën e Konispolit, funksionarit të xhandarmërisë shqiptare që e pyeti, se kur dhe si e kishte kaluar kufirin, djaloshi, pa i dhënë asnjë përgjigje i kishte tundur para hundëve pasaportën britanike. Funksionari i frikësuar i shtetit të vogël shqiptar, kishte ulur kokën para hijes së dy luanëve të ngrehur Perandorisë së Madhe Britanike dhe e lejoi “hinglisin” të largohej.

Djaloshi quhej Nikollas Hammond dhe vetëm disa muaj përpara se të niste udhëtimin drejt maleve të Shqipërisë së Jugut, ishte emëruar ndihmës profesor në Universitetin e Kembrixhit, në të njëjtin universitet ku kishte mbaruar studimet për histori dhe letërsi klasike.

Rreth gjysmë shekulli më pas, në librin e titulluar "Udhëtime në Epir dhe në Shqipërinë Jugore, para luftës së dytë botërore", Nikollas Hammond, tashmë një nga profesorët dhe studiuesit më të mirënjohur të universiteteve të Kembrixhit, Bristolit dhe anëtar i Akademisë Britanike, tregon se, qëllimi i udhëtimeve të tij në Shqipëri, ishte përshkrimi dhe përcaktimi i vendndodhjes të vendbanimeve të përmendur në shkrimet e autorëve antik. Nga leximi i këtij libri mësojmë se, mbasi kishte kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme pranë Konispolit, 23 vjeçari Nikollas Hammond, profesori i ardhshëm i universiteteve të Kembrixhit dhe Bristolit, çuditërisht i ishte shmangur vizitës së qytetit të Butrintit, ku, prej shumë vitesh zhvillonte kërkime një ekspeditë arkeologjike italiane e drejtuar nga arkeologu Luigji Ugolini[1].

Përse?

Si ishte e mundur që një studiues i historisë antike, i cili synonte të bëhej arkeolog, nuk ishte tunduar aspak të vizitonte gërmimet e kryera në Butrint, ku mund të kishte fatin të takohej me një arkeolog me eksperiencë siç ishte Luigji Ugolini?

Kush ishte arsyeja që e kishte detyruar të riun Hammond të përjashtonte Butrintin, nga lista e vendeve që do të vizitonte në Shqipëri?

Mos ndoshta kjo arsye, lidhej në një farë mënyre me kalimin ilegal të kufirit Shqiptaro-Grek, po aq sa, edhe me praninë e mundshme të Ugolinit në Butrint?

Mos ndoshta…

Ndoshta 23 vjeçari Nikollas Hammond, dëshironte që udhëtimi i tij në Shqipëri të ngelej i fshehtë?

Përse?

I pashoqëruar prej askujt, nga skaji perëndimor i kufirit që ndante shtetin shqiptar nga ai grek, Hammond do të udhëtonte drejt veriut deri në fshatin e Zvërnecit, nga ku, mbas eksplorimit të fshatrave Kurveleshit, kishte vazhduar udhëtimin drejt Gjirokastrës që me shumë gjasa ishte edhe pikësynimi i vërtetë i udhëtimit në Shqipëri.

Ndërkohë që në ditarin e tij Nikollas Hammond do të shkruante qartë dhe prerë se; "*në afërsi të Gjirokastrës nuk ka vendbanime antike*", i riu britanik do të vërtitej i vetëm fshatrave të luginës së Drinosit për më shumë se dy muaj.

Përse?

Krejt ndryshe nga çfarë pohonte Hammond në ditar, ishin të shumtë autorët antikë që përmendin qenësinë në luginën e Drinosit të qytetit të Antigoneas. Për më tepër, vendndodhja e rrënojave të qytetit antik të Antigoneas tregohej thuajse saktësisht edhe në shumë harta historike të shekujve XVIII.

Përballë këtyre dëshmive, natyrshëm të lindte pyetja; si dhe përse, gjurmët e rrënojave dhe emri i qytetit antik të

Antigoneas, ishin zhdukur kaq papritmas nga hartat historike në fillim të shekullit të XX?

Mos ndoshta kjo harresë e pashpjegueshme e vendndodhjes të rrënojave të qytetit antik të Antigoneas ishte edhe arsyeja, që studiuesi i ri Hammond, shprehej i bindur në ditarin e tij se, "në afërsi të Gjirokastrës nuk ka vendbanime antike"?

Apo ndoshta…?

Mbasi eksploron të gjithë luginën e Drinosit dhe viziton një e nga një fshatrat e kësaj lugine, Hammond, udhëton në drejtim të fshatit Seraqenisht, pastaj, edhe ca kilometra më tutje, drejt një kodre që mbante një emër të çuditshëm…

Kalaja e Jermës…

Kalaja e zhuritur!

Aty qëndron më gjatë se kudo tjetër. Për më shumë se një muaj. Mos ndoshta vallë kishte zbuluar gjurmët e një qyteti antik? Aspak! Edhe aty nuk kishte asnjë rrënojë antike të denjë për tu përmendur në ditar. Madje, për humbjen e kotë të kohës, i riu Hamond ia vë fajin Pukëvilit, ambasadorit francez në oborrin e Ali Pash Tepelenës, "*dëshmitë e të cilit mbi gjurmët e lashtësisë së Epirit ishin të mbushura me gënjeshtra*".

Në fillim të korrikut 1930, Nikollas Hammond kthehet në Mbretërinë Greke duke kaluar rishtazi ilegalisht kufirin në malin e Nemërçkës.

Pikërisht, në të njëjtën vit, në qytetin e Korçës do të lindte Dhimosten Budina. Arkeologu shqiptar që 35 vite mbas udhëtimit të Hammondit në Shqipëri, do të drejtonte gërmimet arkeologjike në "kalanë e zhuritur" për të zbuluar se, poshtë truallit të saj, gjendej një qytet i madh antik. Ndoshta më i madhi i zbuluar ndonjëherë brenda kufijve të shtetit shqiptar.

Cili ishte emri i këtij qyteti?

Zbulimi i disa pllakave metalike të cilat përdoreshin për të votuar e shtynë arkeologun të arrinte në përfundimin se, qyteti që kishte zbuluar, ishte ai i Antigoneas.

Ishte ky një zbulim apo ndoshta një rizbulim i një copëze të fshehur të historisë?

Ngjante se Nikollas Hammond, më shumë se askush tjetër, kishte qenë pranë zbulimit të vendndodhjes së qytetit antik të Antigoneas dhe, ndoshta mungesa e përvojës e kishte penguar të hidhte hapin, që do ta përfshinte në radhët e atyre pak arkeologëve që kanë fatin të zbulojnë vendndodhjen e harruar të një qyteti antik.

Në fillimin e viteve 50 të shekullit XX, gjurmët e Nikollas Hammond në kodrën e Jermës do t'i ndiqte edhe një ekspeditë arkeologjike shqiptare e cila, njësoj si edhe Nikollas Hammond do ta braktiste kodrën e Jermës pa dyshuar që nën këmbët e saj fshihej një qytet antik me një sipërfaqe prej 90 hektarësh të rrethuar nga 4 km mure,

brenda të cilëve gjendeshin shtëpi banimi, shëtitore të gjera, tempuj dhe punishte.

Por, përpara ekspeditës eksploruese të Nikollas Hammond në vitet 30, asaj shqiptare në vitet 50 dhe gërmimeve që çuan në zbulimin e qytetit të Antigoneas në vitet 60 të shekullit të XX nga arkeologu Demosten Budina, edhe një tjetër ekspeditë arkeologjike kishte eksploruar dhe gërmuar në kodrën e Jermës, e…

Madje…

Edhe kishte zbuluar praninë e qartë të ekzistencës nën truallin e saj të një qyteti antik. Për të zbuluar disi identitetin e kësaj ekspedite, duhet të kthehemi mbrapa në kohë…

Dhjetor i vitit 1912.

Në mesin e kolonave të ushtrisë së Mbretërisë Greke, hordhive të mercenarëve dhe bandave të kriminelëve që po pushtonin territorin e shtetit të sapo shpallur shqiptar, bënte pjesë edhe një repart i mistershëm. Qëllimi i tij nuk ishte përmbushja e planeve strategjike ushtarake për pushtimin e qyteteve dhe fshatrave shqiptare, plaçkitja e banesave dhe as masakrat e frikshme me të cilat pushtuesit kërkonin të mposhtnin vullnetin e shqiptarëve për të mbrojtur lirinë e sapo fituar, por…

Kërkimet arkeologjike!

Mos u çudisni, ky repart i ushtrisë greke përbëhej nga punonjës të "Shoqërisë Greke të Arkeologjisë".

Zelli aq i pashpjegueshëm, sa edhe i çuditshëm i shtetit grek, për të zbuluar mes zjarrit të luftës ballkanike, të fshehtat e historisë të një territori të pushtuar prej pak ditësh, së pari të habiste dhe pastaj…

Përtej habisë, të nxiste të dyshoje se qëllimi i vërtet i këtij reparti të ushtrisë greke ishte transformimi dhe përçudnimi i historisë së trojeve shqiptare dhe kur kjo nuk ishte e mundur, edhe zhdukja e gjurmëve të saj.

Përse?

Menjëherë pas pushtimit të qytetit të Gjirokastrës nga ushtria greke në 3 mars 1913, reparti i arkeologëve ushtarakë që drejtohej nga 24 vjeçari Dhimitër Evangjelidi, punonjës i shërbimit arkeologjik të shtetit grek (Shoqërisë Arkeologjike Greke), filloi gërmimet në kodrën e Jermës.

Por…

Do të ishte historia e zbulimit e një tjetër vendbanimi antik që do ta bënte emrin e Dhimitër Evangjelidit të famshëm në mbarë botën. Emri i këtij vendbanimi antik ishte Dodona, aq shumë e përmendur nga autorët antik për orakullin e saj.

Në vitin 1875, bankieri dhe politikani grek Kostandin Karapano, gërmonë pran shpateve të malit Mitsikeli dhe ndoshta, fati ose profesioni i politikanit dhe ai i bankierit, e ndihmojnë Karapanon të mos gabohet. Në sipërfaqen prej disa dhjetëra hektarësh që zinte qyteti antik i fshehur prej dhjetëra shekujsh poshtë një shtrese dheu të mbuluar nga pemë dhe shkurre, Karapano gërmon pikërisht në

vendin ku gjendej një thesar që çuditërisht, kishte një përmbajtje shumë të larmishme. Rreth 1800 objekte mes të cilave kishte monedha prej bakri, argjendi dhe floriri, statuja të madhësive dhe materialeve të ndryshme. Midis këtyre objekteve të zbuluara nga Karapano në shpatet e malit Mitsikeli gjendeshin edhe ato…

Dëshmitë që qyteti i zbuluar nga Karapano ishte pikërisht Dodona e famshme. Disa fletë prej plumbi mbi të cilat besimtarët shkruanin pyetjet që i drejtonin orakullit. Mbas zbulimit, Karapano organizon në fshehtësi transportimin e thesarit të gjetur brenda kufijve të Perandorisë Otomane, drejt Mbretërisë së Greqisë.

Në vitet në vazhdim, lajmi i zbulimit të qytetit të Dodonës dhe ai thesarit të gjetur nga Karapano, do të shëtiste në të gjitha akademitë dhe muzeumet e vendeve evropiane dhe, së bashku me të…

Do të përhapeshin në Evropë edhe kërkesat politike për të drejtën e ligjshme që kishte shteti grek për të zotëruar territorin e Epirit e Jugut që sipas politikanëve pseudo-historianë si Katapano, mbarte prova të padiskutueshme të historisë dhe kulturës helene. Duke shpërfillur krejtësisht identitetin shqiptar dhe vllah të shumicës dërrmuese së popullsisë së Epirit të Jugut, në vitin 1913, fuqitë e mëdha evropiane e pranuan kërkesën e shtetit grek për zotërimin e Epirit të Jugut, duke e zëvendësuar kështu, pushtimin e Perandorisë Turke mbi Epirin e Jugut me atë të Mbretërisë Greke.

A i përkiste thesari i zbuluar nga Karapano historisë dhe kulturës së qyteteve helene? Duke mos pasur asnjë informacion të bindshëm mbi hapësirën, pozicionin dhe thellësinë ku Karapano kreu gërmimet e tij, akoma edhe sot, arkeologët, nuk janë në gjendje të japin një përgjigje të saktë mbi kohën që këto objekte i përkasin sa edhe mbi prejardhjen e tyre, pikëpyetje këto, që kanë nxitur shumë studiues të venë në dyshim edhe vetë zbulimin në Dodonë të këtyre objekteve nga ana e Karapanos.

Çuditërisht, me gjithë rolin e madh që luajti zbulimi i qytetit të Dodonës, për të propaganduar dhe arsyetuar përpara opinionit publik evropian pretendimet e Mbretërisë Greke mbi Epirin e Jugut, në vitin 1913, shteti grek ia beson kërkimet në Dodonë, "Institutit Gjerman të Arkeologjisë". Dodona e kishte kryer misionin e saj. Shteti grek, tashmë zot i Epirit të Jugut, kishte nevojë për një zbulim të ri, me ndihmën e të cilit, ashtu si kishte bërë edhe me Dodonën, të justifikonte pretendimet mbi territoret e shtetit të sapo krijuar shqiptar që histo-politikanët grekë e quanin Epiri i Veriut. Kjo ishte edhe arsyeja për të cilën, reparti i gërmuesve të historisë i drejtuar nga Dhimitër Evangelidi, në vitin 1913, gjendej në kalanë e Jermës.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore e pengon "Institutin Gjerman të Arkeologjisë" të kryej gërmime në Dodonë dhe pas mbarimit të luftës, shtetit grek i heq të drejtën për të vazhduar gërmimet.

Historia greke duhet të zbulohej nga arkeolog grekë dhe arkeologu që do t'i besohej misioni i zbulimit e të fshehtave të Dodonës ishte pikërisht Dhimitër Evangjelidi.

Studiuesit dhe kërkuesit e historisë, tashmë prej shumë vitesh, prisnin me ankth të mësonin të fshehtat e Dodonës dhe Dhimitër Evangjelidit i ishte dhënë mundësia e artë për tu bërë goja e orakullit. Ëndrra e madhe e çdo arkeologu, kërkuesi thesaresh apo studiuesi të historisë, për të gërmuar në truallin e shenjtë të orakullit që i kishte thurur vargje Homeri, për Dhimitër Evangjelidin ishte bërë realitet. Emri i tij do të bëhej i famshëm në manualet e arkeologjisë dhe librat e historisë të mbarë botës. Një famë kjo, që në humbellat e saj, fshihte pikëpyetjet mbi gërmimet dhe zbulimet që Evangjelidi kishte kryer në kodrën e kalasë së Jermës. Njollën e grabitësit të historisë të popullit shqiptar. E ndoshta, edhe atë, të përçudnuesit dhe shkatërruesit të historisë për qëllime politike…

Dëshmitë e Hammondit në vitet 30 dhe ato të ekspeditës shqiptare në vitet 50 të shekulli XX, të shtyjnë të besosh se reparti i arkeologëve të ushtrisë greke, përpara largimit nga lugina e Drinosit në shtatorin e vitin 1916, ishte kujdesur jo vetëm të zhdukte çdo gjurmë të gërmimeve, që kishte kryer në kodrën e kalasë së Jermës, por edhe shkatërruar dhe mbuluar me dhe, çdo rrënojë të qytetit antik që ngrihej mbi sipërfaqen e tokës.

Për të shkruar faqet e historisë së re dhe të rreme të një Epiri helen, së pari duhej grabitur, transformuar,

përçudnuar, dhe, kur kjo nuk ishte e mundur, edhe shkatërruar çdo dëshmi e historisë së vërtetë të Epirit. Por, përpjekjet për të rishkruar një histori të re dhe të gënjeshtërt të Epirit, Ilirisë dhe mbarë trojeve të populluara nga shqiptarët, duke grabitur, transformuar, përçudnuar dhe shkatërruar çdo dëshmi të historisë së vërtet, kishin një zanafillë shumë më të hershme se ato të Mbretërisë Greke të Evangjelidit.

Në pranverën e vitit 167 p.e.s, konsulli Paul Emili (Lucius Aemilius Paullus) urdhëroi legjionet romake të shkatërronin nga themelet 70 qytete të Epirit. Për shumë muaj rresht, nga porti i Orikumit, anijet romake do të transportonin drejt Italisë "plaçkën e luftës" të grabitur në Epir…

150.000 qytetarë të Epirit të kthyer në skllevër, dhjetëra ton flori e argjend dhe mijëra statuja prej mermeri dhe bronzi të cilat do të zbukuronin udhët Romës.

Pa dyshim që sot, shumë prej këtyre statujave të grabitura nga Paul Emili në Epir, përdoren në muzeumet evropiane sa edhe dhe në tekstet e historisë së artit dhe arkeologjisë, si shembuj të përkryerjes të artit helen apo romak, edhe pse, në të vërtetë, përkatësia e përkryerjes së tyre, nuk është as helene dhe as romake.

Do të ishte absurde të mendoje se qytete me disa dhjetëra-mijëra banorë siç ishin ato epirote, të mos kishin edhe poetë, filozofë dhe historianë. Emrat dhe veprat e këtyre poetëve, filozofëve dhe historianëve epirotë u

zhdukën njëherë e përgjithnjë në zjarret që ndezën legjionet romake dhe bashkë me to, u zhduk edhe e vërteta e historisë së Epirit dhe heronjve të tij.

Mbas grabitjes, përçudnimit, zvetënimit dhe shkatërrimit të historisë së vërtetë të Epirit, zuri fill shkrimi i historisë së tij të re. Historia e rremë e një Epiri helen dhe romak...

Një histori e rreme që edhe pse kishin kaluar thuajse 2000 vjet nga koha kur legjionet e Paul Emilit kishin shkretuar Epirin, nuk kishte pushuar së shkruari.

Ishte pikërisht qëllimi për të dëshmuar historinë dhe përkatësinë helene të Epirit që e solli Evangjelidin në Shqipëri. Trembëdhjetë vite më pas, qëllimi për të dëshmuar historinë dhe përkatësinë romake të Epirit, solli në Shqipëri edhe arkeologun italian Luigi Ugolini.

Në të njëjtën kohë, Mbretëria e Greqisë dhe ajo e Italisë, do të paraqisnin në tryezat e diplomacive evropiane pretendimet e tyre për të pushtuar Shqipërinë e Jugut në emër të dëshmive të historisë…

Të kujt historie?

Të asaj që do të zbulonin Evangjelidi dhe Ugolini?

Cili ishte kufiri që ndante historinë e Evangjelidit dhe Ugolinit nga politika?

A do të kishin ata guximin, t'i kundërviheshin politikës së shteteve që i paguanin dhe të dëshmonin të vërtetën e historisë së Epirit, nëse përballeshin me të?

Apo, ndoshta ajo, historia e vërtetë e Epirit, tashmë kishte vdekur njëherë e përgjithnjë?

Por…

A mund të vdesë e vërteta?

Mundej vallë që, edhe vërteta e historisë së Epirit t'i kishte mbijetuar legjioneve të Paul Emilit dhe pushtuesve të tjerë të trojeve Shqiptare?

Të ishte e mundur që kjo e vërtetë, të fshihej edhe nën rrënojat e Antigoneas, Butrintit, dhe pse jo, edhe në ato të shumë qyteteve të tjera të Epirit dhe Ilirisë?

Fundi i pjesës së parë.

Tiranë, 22. 05. 2016.

**1. Luigji Maria Ugolini (1895 –1936). Arkeolog italian. Nga viti 1924 deri në vitin 1936 drejton kërkimet arkeologjike italiane në Shqipërinë e Jugut. Autor i librit "Shqipëria antike"** (L'antica Albania: nelle ricerche archeologiche italiane).

## MBI "VELIERËN", DAKOT DHE DAKESHAT!

Në çështjen e ndërtimit të shëmtisë prej betoni të quajtur "velier" (*emër po aq i përçudnuar dhe qesharak sa edhe projekti prej betoni i sipërpërmendur, emër i përçudnuar dhe qesharak sepse, nuk i përket as fjalorit të gjuhës shqipe dhe as fjalorëve të latinishtes dhe italishtes por është një krijesë e fjalorit të arrogancës së mediokritetit dhe injorancës së paskajë të individëve që qeverisin Bashkinë e Durrësit*), problemi i vërtetë nuk është as krye bashkiaku i Durrësit V. Dako, dhe as shëmtia prej betoni që ky kërkon të ndërtojë.

Problemi që duhet të na shqetësojë është vazhdimi i pandalshëm i përmbushjes së projektit, që synon zhdukjen e historisë së popullit shqiptar.

Të gjithë ata që kundërshtojnë projektin e "velierës" prej betoni që do të "qytetërojë" Durrësin 3000 vjeçar, nuk do të munden kurrë të përmbushin misionin e tyre nëse

nuk kuptojnë, që krye bashkiaku i Durrësit, nuk gjendet në postin që mban sepse ka fituar votat, por thjesht dhe vetëm sepse, ka marrë përsipër të ndërtojë "velierën", pra, të rrënojë gjurmët e historisë së kombit Shqiptar.

Velierën?

Jo "velierën" por morinë e "velierave" që ka ndërtuar dhe do të ndërtojë kudo ku ruhet kujtesa materiale e popullit tonë.

Të gjithë ata që kundërshtojnë projektin e "velierës" prej betoni, që do të "qytetëroj" Durrësin 3000 vjeçar, edhe pse misioni i tyre mbart gjithë admirimin dhe përkrahjen time si qytetar dhe intelektual, do të bëjnë një "vër në ujë" nëse nuk kuptojnë se problemi nuk është Dako dhe "veliera" por ata dhjetëra Dako që nga institucionet e shtetit shqiptar nuk pushojnë së dhëni firma, lejuar legalisht dhe ilegalisht, ndërtimin e "velierave" anë e mbanë Shqipërisë. Ata dhjetëra "Dako" dhe "Dakesha" që nga institucionet e shtetit shqiptar, lejojnë përçudnimin e kështjellave, shkatërrimin sistematik dhe të pandalshëm të monumenteve të kulturës dhe plaçkitjen e objekteve arkeologjike.

Ndërkohë që Dakoja shponte dhe thërrmonte duke shndërruar në baltë, historinë mijëravjeçare të Durrësit, pak më tutje në jug, një tjetër Dako "mbyllte sytë" përpara plaçkitjes të Apollonisë, zhbërjen e historisë të një tjetër qyteti mijëravjeçar të Shqipërisë.

Oh, por nuk mbaron këtu!

"Dakot" dhe "Dakeshat" i keni kudo, në krye të muzeve duke shkatërruar atë pak që ka mbetur pa u shkatërruar ose pa u vjedhur.

I keni në krye të bibliotekave duke i lënë librat të myken e të kalben ndërkohë që ndërrojnë makinën e radhës.

Të fshehur pas petkut të injorancës dhe shpesh herë edhe pas petkut të kozmopolitizmit (*një formë moderne e internacionalizmit proletar*), shpesh herë haptazi dhe madje duke u mburrur në ekranet televizive se historia është e dëmshme në epokën e "globalizmit", dhe shumë herë fshehurazi, të mbrojtur nga petku i padijes (*të partiakut që e ka marrë postin si shpërblim për besnikërisë ndaj partisë*), ose e etjes të paskaj për tu pasuruar, ata vazhdojnë të shkatërrojnë historinë e kombit tonë deri kur të vij ajo...

Dita e mynxyrës!

Dita kur do të na pyesin; po ju shqiptar kush jeni dhe nga vini?

Dhe ne...

Do të heshtim!

Do të heshtim sepse nuk e dimë!

Sepse çdo grimcë të kujtesës tonë historike është shitur, plaçkitur, shkatërruar nga Dakot dhe Dakeshat.

P.S. Këtë post scriptum po e shfrytëzoj për ti shkruar dy fjalë edhe krye qeveritarit të këtij vendi...

I nderuari z. Edi Rama, Kryeministër i Shtetit të Shqipërisë, patriotizmi nuk tregohet duke iu mburrur kryeministrit të Greqisë me bëmat e shqiptarit që shpëtoi nga shkatërrimi akropolin e Athinës, por, duke mbrojtur, ashtu siç mbron dhe respekton kryeministri dhe shteti grek, akropolet e historisë të vendit që ti qeveris. Mbi gjithçka tjetër, është kjo që do të përcaktojë "nderimin" apo "çnderimin" tuaj përballë gjyqit të historisë.

Tiranë, 17.02. 2017.

# KUSH E VRAU MIKUN TIM ALTIN KOCAQI?

Nuk kam njohur tjetër njeri që ta donte jetën më shumë sesa Altini.

Këtë, dashurinë e tij të tejskajshme për jetën e vura re (disi me dyshim dhe habi), tek buzëqeshja e tij e madhe, e ngrohtë dhe e panjollë si ajo e një fëmije, herën e parë që u takuam. Prisja të përballesha me dikë krejt të ndryshëm, sepse takimit, i kishte paraprirë një debat i ashpër në FB, por në vend të vetullave të vrenjtura ai më buzëqeshi njësoj...

Njësoj sikur ishim miq të vjetër. Sikur të kishim kaluar së bashku fëmijërinë, adoleshencën dhe aventurat e rinisë dhe të tillë...

Miq të vjetër që çfarëdo që të ndodhë, nuk munden ti mbajnë mëri njëri tjetrit, do të ngeleshim deri në fund, sepse ajo që na bashkonte, ishte paanësisht më e madhe se çdo dasi e mundshme, besoj edhe më e madhe se vetë humbella e vdekjes.

Dashurinë për jetën Altini e shprehte kudo; në batutën e radhës që nuk harronte kurrë ta bënte, ndërsa të ftonte për kafe, në ngrohtësinë prej babai me të cilën të shtrëngonte dorën, në kënaqësinë me të cilën lëvizte lugën në filxhanin e kafes kur rrëfente për të birin, për bashkëshorten, për shijen e ushqimit që kishte ngrënë në mëngjes, baltën që i kishte ndotur këpucët apo rrebeshin

që i kishte njomur shpinën ndërsa kalëronte motorin e tij të vogël.

Por...

Ishte diçka tjetër ajo që Altini e donte më shumë se jetën dhe...

Kjo diçka tjetër ishte ATDHEU!

Dashuria për kombin të cilit i përkiste i kishte ngarkuar Altinit një mëkat të madh mbi shpinë.

Mëkatin e quajtur patriotizëm.

Nuk e kam fjalën këtu për atë mori individësh që bëhen patriotë vetëm kur luan kombëtarja e futbollit, për bankierë e financierë, horra e morra, që e përdorin patriotizmin vetëm për të mbledhur pasuri, duke mballosur reklamat e tyre me shqiponjën, flamurin apo simbole të tjera kombëtare. As për politikanët e radhës që papritur e pa kujtuar veshin maskën e patriotit, për të fshehur skandalet apo për të mbledhur vota.

JO!

Altini nuk ishte një patriot i kësisoj!

Altini ishte një patriot i vërtetë!

Një nga ata që i japin atdheut gjithçka kanë, pa i kërkuar asgjë në këmbim, dhe madje, pa i shkuar aspak në mëndje që për dashurinë e tyre duhet të marrin diçka në këmbim. Një dashuri pa kushte, e panjollë, njësoj si buzëqeshja e Altinit.

Këtij mëkati të parë, tek Altini, i shtohej një mëkat i dytë...

Altini ishte një patriot intelektual...

Kur shkruaj intelektual, nuk e kam fjalën për doktoro-akademikët shterpë të universiteteve kioska dhe as për ata të ekraneve TV, që me shumë gjasa, kanë të paktën 30 vjet që nuk kanë lexuar një libër, e ndoshta, nuk dinë të lexojnë në gjuhën shqipe më shumë sesa një mesazh telefonik, por për një intelektual të vërtet, një intelektual i cili për nga hapësira e dijeve që zotëronte, do të nderonte çdo universitet evropian.

Në vitin 2009, Altini boton "Shqipja Pellazge".

Në vitin 2013, "Dokumente historike – gjuhësore" (vendi i shqipes ndër gjuhët evropiane).

Në vitin 2015 – 2016, përkthen dhe përgatit botimin në shqip të veprave; "Studimet Shqiptare" dhe "Mbi gjuhën shqipe" të shkruara nga albanologët Panajot Kupitori dhe Franz Bop.

Por...

Bota e doktoro-akademikëve shterpë të universiteteve kioska shqiptare, vendosën ta vrasin Altinin me thikat e përbuzjes dhe të heshtjes.

Të njëjtat armë përdorën edhe ekranet e TV që tërbohen nga ngazëllimi, kur është fjala për të reklamuar librat mediokër të politikanëve mediokër, gazetarëve mediokër apo dashnoreve të tyre.

Me tehun e ftohtë të thikave të përbuzjes dhe përçmimit, Altini u përball edhe kur paraqitej në zyrat e institucioneve e të ashtuquajturit shtet shqiptar për të

paraqitur projekte për mbrojtjen dhe hulumtimin e kulturës, gjuhës dhe historisë së kombit tonë.

"Të financojmë një libër ku rrëfehet historia e një heroi shqiptar të panjohur? Të financojmë për ngritjen e një qendre të kulturës shqiptare në Rekë, Tetovë apo Ulqin? Një dokumentar për historinë e lashtë të Epirit? Mbi arvanitasit jo e jo... Ç'marrëzi janë këto? Ne kemi pare për koncerte çingijesh, për libra me vrima e vrimashë, për bunker art dhe art bunkerësh, por... JO! Qoftë larg... Për kësisoj mynxyrash me atdhe dhe histori që ti nxjerr nga goja, ne, shteti shqiptar, nuk jep financime!"

Disa herë e shoqërova Altinin (të cilit, e pamundura që ndoshta një ditë, në zyrat e shtetit shqiptar, do të gjente dikë që ta donte Shqipërinë, i ngjante e mundur) në kësisoj pelegrinazhesh nëpër zyrat e shtetit shqiptar, por pastaj, me gjithë aftësinë e tij për të më nxitur të qeshurën ndërsa më kujtonte vështrimin e sekretarucëve të sekretarëve ministrorë që na shihnin të habitur sikur të ishim marsianë, teksa i rreshtonim listën e gjatë të të mirave, që do të sillnin për kombin përmbushja e projekteve të paraqitura, e braktisa.

Institucionet e shtetit Shqiptar...

Ministrira të ç'kulturës dhe të ç'arsimit...

Hëë!

Nuk mundem të harroj atë zyrtarucin e kollarisur të njërës prej këtyre ministrive që e pyeti Altinin, se kush ishte e nga vinte dhe, ndërsa nuk i bën aspak përshtypje

titujt e librave të shkruar nga Altini, merr një pamje të habitur kur ky i rrëfeu se, për shumë vite, kishte qenë emigrant në Greqi.

"Përse u ktheve në Shqipëri, kur mund të merrje shtetësinë greke?" e pyet zyrtaruci.

Edhe pse aq e pakuptueshme dhe absurde për zyrtarucin e shtetit shqiptar (shqiptar?), Altini e kishte përbuzur shtetësinë greke sepse, marrëzisht, ndjehej shqiptar, ndjente se i kishte borxhe kombit që e kishte lindur.

Nëse do ti shiste trupin dhe shpirtin shtetit grek, pa dyshim që do të ishte pasuruar.

Por...

Altini nuk pranoi ti shiste trupin dhe shpirtin një shteti që nuk ishte ai i kombit të tij dhe u kthye në Shqipëri.

Ahh!

Në Shqipërinë e tij, tuaj, timen, ku patriotizmi është mëkat dhe krim!

Kur horrllëku është nder dhe lavdi!

Institucionet e kulturës të çdo shteti tjetër të botës do ta kishin për nder ta kishin Altinin pjesë të administratës së tyre, kurse në Shqipëri, Altini ishte i papunë...

Thikat nguleshin e nguleshin por dashurinë për atdheun, buzëqeshjen dhe punën e pa ndalur të Altinit për kombin, nuk mundën ta vrisnin.

Në çdo vend të botës, Altini do të nderohej dhe vlerësohej si intelektual, kurse në Shqipëri, shikohej me

përbuzjen dhe mospërfilljen me të cilën shihet dikush që nuk është i aftë të gjejë një punë...

Punë?

Mijëra e mijëra orë të harxhuara mbi faqet e librave të shkruar, mijëra të tjera të harxhuara në rrjetet sociale sepse, siç thoshte Altini, të rinjtë kanë nevojë të mësojnë të vërtetën.

Po këto çfarë ishin?

Nuk ishin punë?

E pra..

Ato mijëra orë, të shndërruara në tre libra dhe dhjetëra shkrime të botuara në rrjetet sociale, ishin një punë kolosale për kulturën e kombit shqiptar!

Gjithçka në shkëmbim të asgjëje...

Hiç!

Por ai buzëqeshte dhe nuk reshte së dashuri kombin sepse e dinte që, dashuria e vërtetë, ajo e pastra, e panjolla si buzëqeshja e tij, është të duash, të përpiqesh, të sakrifikohesh pa kërkuar dhe pa shpresuar asgjë në këmbim dhe, thikat, të dukshme e të padukshme nuk pushonin së nguluri në trupin e tij...

Të jesh intelektual në Shqipëri (e përsëris, nuk e kam fjalën për intelektualët shterpë të universiteteve kioska etj, etj,) është një mëkat i rëndë.

Të jesh patriot në Shqipëri është një mëkat po kaq i rëndë dhe i dënueshëm sa i pari.

Të jesh edhe intelektual edhe patriot, në Shqipëri është një mëkat vrastar.

Vrasja e çdo intelektuali patriot shqiptar është shoqëruar nga një arsye apo vrasës ordiner.

Dhaskal Todri o vra aksidentalisht nga kaçakët që vidhnin udhëve.

Naum Veqilharxhit ia merr jetën një sëmundje e panjohur, nga e cila nuk kishte vuajtur kurrë.

Sëmundje të ngjashme, të papritura dhe ordinere, i morën jetën edhe Anastas Kulluriotit, Panajot Kupitorit, Aristidh Kolës.

Pandeli Sotiri hidhet nga kati i tretë i shtëpisë...

Ohhh!

Lista deri tek Altini është e gjatë!

Thika ordinere që kërkoi të rrëmbente jetën e Altinit, të papunit Altin, autorit të tre librave me fragmentet e vjedhura nga të cilat doktoro – akademikët shterpë të universiteteve kioska do të nxitojnë të mbrojnë doktoraturat e ardhshme, nuk ishte ajo e fundit, sepse...

Të fundit i mori në spitalet kasaphana të shtetit shqiptar (shqiptar?), shtet shqiptar (shqiptar?) që për Altinin nuk kishte lekë ta dërgonte të kurohej jashtë shtetit sepse...

Altini nuk ishte as horr dhe as politikan.

Altini ishte një intelektual patriot, i papunë deri në vdekje...

Ashtu si të gjithë intelektualët patriot shqiptarë.

Do të ishte qesharake ti bëja thirrje prokurorisë që të niste hetimet mbi vdekjen e Altinit.

Madje...

Nuk ju bëj thirrje as shqiptarëve që të heqin dorë sa nuk është vonë nga adhurimi i horrave dhe shushunjave që po i thithin gjakun dhe shpirtin kombit tonë.

Altini e di...

Unë nuk i besoj thirrjeve publike dhe as peticioneve por, në këmbim, i jap fjalën Altinit që nuk do të heq dorë nga rruga të cilën, edhe pse për pak kohë, kryem së bashku.

Mirupafshim miku im i mirë!

Mirupafshim në tokën e heronjve të kombit shqiptar!

Shpresoj që ZOTI I SHQIPTARËVE të më dhurojë, së bashku me buzëqeshjen, edhe forcën tënde për të punuar pa u ndalur, guxuar dhe shpresuar që ditë më të mira do të vijnë për kombin tonë.

Tiranë, 03.02.2017.

# 14 SHKURT 2013...

***Dita e të dashuruarve dhe historia e një "memoje" për Memorialin e Preshevës.***

Në ditën e të dashuruarve, së bashku me problemin e zonjës Krizë që ka kllaposur botën, gripin dhe lajmin e habitshëm të dorëheqjes së një Pape[1], gjumin e shqiptarëve e shqetësoi edhe ardhja e një letre të çuditshme.

Edhe pse shqiptarëve iu arriti në 14 shkurt, ajo, nuk na ish aspak një letër dashurie dhe duke mos qenë e tillë, është e lehtë të kuptosh që shkronjësi apo frymëzuesi i saj nuk qe as i lumi shenjtor Valentini dhe as Erosi krahëlehtë i miteve antike, por...

SH. B. A!

Të paktën kështu iu paraqit shqiptarëve…

Shkruaj "iu paraqit" sepse, që në fillim, shqiptarëve i ngjau e çuditshme mbërritja e një letre të këtillë nga SH.B.A. Përse i ngjau kaq e çuditshme? Mos u nxitoni, arsyen e "çudisë" së shqiptarëve do ta kuptoni kur të mbërrini rreshtat e fundit të kësaj rrëfenje.

Ndjenja e çudisë, ashtu siç ndodh gjithmonë, mbarsi në shpirtrat e shqiptarëve dyshimin se mos ndoshta, letra nuk ishte shkruar nga SH.B.A .

A ishin me të vërtetë SH.B.A."shkronjësi" i kësaj letre të cilën gazetarët e pagëzuan me termin "Memo", cungim i fjalës latine "memorandum"?

Të nesërmen, kur i dërguari i gazetës elektronike "Ballkan Insight" u përpoq të mësonte diçka më tepër mbi "autenticitetin" dhe "autorin" e kësaj "memoje" nga ambasada e Sh. B. A. në Tiranë, zëdhënësi ambasadës iu përgjigj që; ***"… nuk kishte asnjë koment për të bëre në lidhje me letërkëmbimet diplomatike***".

Pra, me aq sa është në gjendje të kuptojë një mendje e thjeshtë, për të cilën gjuha e diplomacisë është po aq e pakuptueshme sa edhe gjuha me të cilën Majat e mistershëm gdhendnin mbi gurë profecitë e tyre, ambasada e SH.B.A as mohonte dhe as e pohonte vërtetësinë e letrës që shqetësoi aq shumë gjumin e shqiptarëve në natën e 14 shkurtit të vitit 2013.

Pyetja e dytë që të lindte ndërsa përpiqeshe të zbërtheje "gjuhën" diplomatike të "Memos" (*"gjuhë" që për çudi nuk ngjante aspak diplomatike apo të paktën asaj që mendjet e thjeshta imagjinojnë se duhet të jetë e tillë*) ishte se kujt i drejtohej kjo letër. Sigurisht, nëse do t'i drejtohej presidentit apo kryeministrit të tyre, shqiptarët nuk do ta kishin "çarë kokën shumë" dhe do t'ja kishin futur gjumit të qetë, por...

Letra fillonte me frazën…

***"Ne jemi tejet të zhgënjyer dhe të shqetësuar se liderët shqiptarë po i largohen rolit tradicional konstruktiv që Shqipëria ka luajtur në rajon".***

Nga leximi i kësaj fraze të krijohej qartazi përshtypja që shkronjësi, nuk ja drejtonte letrën një politikani apo qeveritari të caktuar (*po të ishte kështu në letër do të shkruhej; "ne jemi tejet të zhgënjyer nga qëndrimi juaj etj etj..."*) por pikërisht shqiptarëve të cilëve u ankohej për sjelljen e "keqe" të politikanëve që këta, shqiptarët, kishin zgjedhur të qeveriseshin.

Më tej letra vazhdonte me këto fjalë...

"***Deklaratat e fundit publike të bëra nga politikanët shqiptarë për çështjen e monumentit të Preshevës e kanë kapërcyer vijën e diskutimeve të përgjegjshme, në atë të retorikës kundër produktive dhe potencialisht të rrezikshme***".

Ishte e lehtë të arrije në përfundimin që shkaktarë për shkrimin e "Memos" ishin bërë deklaratat e politikanëve shqiptar në lidhje me ngjarjen që kishte ndodhur në 20 Janar të vitit 2013...

Çfarë ndodhi në 20 Janar 2013?

Repartet policore të Republikës Serbe, shkatërruan memorialin që autoritet lokale të Preshevës kishin ngritur për të nderuar kujtimin e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit e njohur edhe me inicialet U.Ç.P.M.B. Me aq sa mund të kuptoje, "Memoja" këshillonte (*në formë urdhëruese*) se…

Nuk ja vlente të "***ngrije zërin***" per një memorial duke rrezikuar që "***me ngritjen e zërit***", të prishje "***paqen dhe stabilitetin***" (*paqen dhe stabilitetin e kujt?*) sepse ai (*memoriali!*) …

"***…është thjesht një monument. Një pllakë me disa emra mbi të. Nuk është një çështje territoresh, shkollash, zhvillimi ekonomik apo anëtarësimi në BE. Ai ishte një monument i ndërtuar ilegalisht dhe që kishte në një farë mënyre për qëllim të provokonte qeverinë e Serbisë***".

Për të vazhduar ca më poshtë…

"***Është e vërtetë që qeveria e Serbisë mund të ishte treguar më e duruar dhe të vazhdonte tentativat për dialog, por përgjigja nga disa persona në Kosovë (dëmtimi i varrezave) dhe përgjigja nga qeveria juaj, vetëm sa i hodhën benzinë zjarrit dhe dëmtuan imazhin tuaj. Misioni i OSBE në Serbi, ambasada jonë në Beograd dhe një sërë misionesh diplomatike të tjera janë duke u përpjekur të gjejnë një zgjidhje dhe do vazhdojnë me tentativat e tyre. Ndërkohë, deklaratat tuaja vetëm sa e vështirësojnë punën tonë dhe nuk janë aspak të mirëpritura***".

I gjithë ky fragment i "memos" ishte po aq i errët sa edhe këshillat profetike të orakullit të Delfit dhe çdo shqiptar, nëse do ta kishte përpara shkronjësin enigmatik

të “memos”, nuk do të mund të rrinte pa e pyetur; “përse vallë, duhet të jenë gjithmonë shqiptarët ata që duhet të durojnë? Tentativa per dialog…!? Për çfarë dialogu e ke fjalën kur ndërkohë serbët e “paduruar” e kishin shkatërruar memorialin? Apo ndoshta për ti bindur serbët të mos ju shkrepej në mendje që pas shkatërrimit të “memorialit”, të vrisnin, dhunonin dhe largonin nga Presheva, Medvegja dhe Bujanovci edhe vetë shqiptarët? Si është e mundur që shkatërrimi i disa varreve serbe nga persona të panjohur[2], mjaftoi për të dëmtuar imazhin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve ndërsa dhjetëra vite masakrash, gjenocidi, përdhunimesh, largimesh të dhunshme të popullsisë dhe një pafundësi deklaratash mesjetare të politikanëve serbë nuk mjaftuan për të prishur imazhin e Serbisë përpara syve të virgjër të diplomacisë ndërkombëtare?”

Por “memoja”, edhe pse diplomacia ndërkombëtare dhe sidomos ajo evropiane kishte më shumë se 20 vjet që nuk i përgjigjej këtyre pyetjeve të ndruajtura të shqiptarëve, si të ishte shkruar nga një banor i një planeti tjetër, vazhdonte të shpjegonte se …

“***I gjithë synimi i dialogut mes Serbisë dhe Kosovës është që të ndalojnë Serbinë të ndërhyjë në punët e brendshme të Kosovës. Nga ana tjetër, ju ndërhyni pa pikë mëdyshje në çështjet e brendshme të Serbisë***”.

Ndryshe nga ato që e paraprinin, në këtë frazë, shkronjësi "memos" e kishte shprehur mendimin e tij qartazi dhe prerë duke mos i lënë hapësirë lindjes së mëdyshjeve dhe dyshime kohë humbëse.

− Bëni çfarë të dëshironi! Mes jush, mund të grindeni dhe të rriheni. Të vriteni dhe masakroheni. Por... Në "punët e brendshme" të Serbisë mos guxoni të ndërhyni o shqiptarë! − ishte mesazhi i prerë që "memoja" u drejtonte shqiptarëve.

Si ishte e mundur që shkronjësi i "memos" të kishte harruar që Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, popullohen prej shekujsh nga shqiptarë që me referendumin e kryer në vitin 1991, shprehën përpara gjithë botës, dëshirën dhe vullnetin e tyre për të qenë pjese e Kosovës dhe jo e Serbisë?

Shqipëria që ndërhyn në punët e brendshme të Serbisë?

− Aman o "memo" vëllai, për besë qenke shakatar i madh. Edhe pulat i bëre të qeshin,− hungërinë njëzëri, lexuesit dhe dëgjuesit e "memos".

Hungërimë që befas u shndërrua në klithje…

− Po ajo, Serbia ka më shumë se një shekull që ndërhyn në çështjet e brendshme të Shqipërisë! Të paktën që nga viti 1913, kur me lejen e diplomacisë së nderuar evropiane, rrëmbeu thikën dhe si të kishte përpara një tortë, preu në

dy pjesë atdheun, zemrën dhe shpirtin e shqiptarëve. Por nuk u mjaftua me kaq. Oh jo... Pas vitit 1913, Serbia e pakënaqur nga gjysma e atdheut të shqiptarëve që diplomatët evropianë ia dhuruan edhe pse nuk kishin asnjë të drejtë pronësie mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, planifikoi edhe gllabërimin e copës së ngelur duke kërcënuar kështu edhe vetë mbijetesën e kombit shqiptar.

Dyshojmë në paanshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve të diplomacisë evropiane?

Sigurisht që dyshojmë dhe për këtë fajtori i vetëm është vetë ajo...

Diplomacia evropiane!

Mos ndoshta, në vend që t'i kërkohet llogari shqiptarëve për dyshimet e tyre ndaj diplomacisë evropiane do të qe më mirë t'i dëshmohej që kjo, diplomacia evropiane, nuk ishte me ajo e 1913, apo, aq me keq, ajo 1878, kur statisti i famshëm me emrin Bismark, vërejtjes se territoret që po i dhuroheshin Serbisë (*pas humbjes së një lufte midis Turqisë dhe Rusisë!*) nuk ishin të populluara aspak nga turq por nga shqiptarë, ju përgjigj se; "Shqipëria është thjesht nje shprehje gjeografike", duke mohuar ekzistencën e një populli të quajtur shqiptar?

Por shkronjësi i "memos" që ndoshta nuk i dinte apo shtirej se nuk i dinte të gjitha këto, vazhdonte në të tijën…

***"Ne i bëjmë thirrje politikanëve shqiptarë dhe liderëve politikë të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe të mos***

***futen në punët e brendshme të Serbisë. Përkundrazi, fokusohuni në përparësitë e popullit shqiptar në Shqipëri…***"

− Po flet marrëzira or ti... Nuk e dimë kush je e si quhesh, por, për besë po flet marrëzira,− i bërtitën shqiptarët shkronjësit të "memos"− Si mund të përparojë një komb i ndarë nga kufijtë e pesë shteteve të ndryshme? Si mund të ndahet zemra që i jep jetë ekzistencës së këtij kombi në pesë pjesë? Një operacion i tillë diplomatik do të kishte vetëm një rezultat… Vdekjen e popullit që pranon kokulur të shtrihet në tryezën e operacionit!

Vallë, a është e drejtë të detyrohet një popull të pranojë i heshtur dhe pa u ankuar vdekjen e tij me arsyen absurde sepse kështu mbrohet "stabiliteti dhe paqja" e një apo më shumë shteteve?

"***Kur në rrjedhën e historisë njerëzore lind nevoja që një popull të zhbëjë lidhjet politike që e mbajnë të lidhur pas një tjetri, duke marrë kështu përsipër përpara gjithë shteteve të tokës të jetë i pavarur dhe i barabartë me ta, të drejtë që ligjet e natyrës dhe të Zotit ia kanë dhënë, duhet që ai, të respektojë opinionin e njerëzimit duke shpjeguar edhe arsyet që e kanë detyruar ta kryejë këtë ndarje***".

Kjo frazë nuk është shkruar nga ndonjë shqiptar prej atyre që akuzohen se kërkojnë të prishin stabilitetin e

Serbisë por është fjalia e parë e Deklaratës së Pavarsisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës e firmosur në 4 korrik 1776 nga ata që më pas do të quheshin etërit e kombit amerikan. Drita që rrezaton kjo frazë e Deklaratës së Pavarësisë e SH.B.A na nxit të pyesim veten se kush vlen më shumë për Sh. B. A; "stabiliteti" i shtetit të Serbisë apo e drejta "që vetë natyra dhe zoti natyrës" i ka dhënë popullit shqiptar për të zgjedhur dhe vendosur i lirë të ardhmen e tij?

A ka arsye populli shqiptar të kërkojë "zhbërjen" e kësaj lidhjeje me Serbinë, nyjen e se cilës e kanë ideuar, bekuar, ligjësuar dhe së fundmi edhe lidhur, pikërisht ato diplomaci evropiane ndaj të cilave, ti o shkronjës i "Memos", na kërkon sot të kemi besim?

"***Regjimentet serbe prej 1100 vetash, nën komandën e gjeneralit Karlo Popoviç, hynë në Shqipëri të armatosura me vajgur, pompa spërkatëse dhe dinamit. Ata, kapnin shqiptarë sa mundnin. I lidhnin së bashku dhe i qëllonin. Gratë i përdhunonin. Besoj se çdo grua që binte në duart e serbëve bëhej viktime e tyre. Pastaj i mbyllnin në shtëpi dhe vendosnin bomba nëpër mure. I spërkatnin këto shtëpi me vajgur dhe i vinin zjarrin. Kur flaket arrinin dinamitin, shtëpia hidhej në erë. Shqipëria është mbushur me pirgje gurësh të nxirë që dikur ishin shtëpi***".

Ky fragment nuk është i huazuar nga përshkrimi i një filmi horror dhe as nga masakrat që kreu ushtria serbe gjatë luftës së fundit në Bosnje dhe Kosovë. Ai i përket një artikulli të publikuar në gazetën "New York Globe" në prill të vitit 1914 ku rrëfehen masakrat e kryera nga ushtria serbe në pjesën perëndimore të Shqipërisë të cilën diplomacitë e shteteve te mëdha të Evropës i kishin njohur pavarësinë.

Gazetari amerikan Uilliam Houard, në fund të këtij artikulli, arrin në përfundimin, që Serbia, pasi kishte marrë si dhuratë nga fuqitë e mëdha evropiane gjysmën lindore të Shqipërisë, tanimë, po rrëmbente edhe gjysmën tjetër me anën e shfarosjes në masë të shqiptarëve. Por, ndryshe nga ajo që shpresonte gazetari, pra, se fuqitë e mëdha do të ndërhynin për të vendosur rregullin dhe drejtësinë, çuditërisht, edhe asaj kohe, fuqitë e mëdha, për hir të "paqes dhe stabilitetit" do të tregoheshin të duruara ndaj Serbisë së paduruar. Të njëjtat diplomaci evropiane që do të shquheshin për durimin e tyre ndaj masakrave serbe në pjesën perëndimore të Shqipërisë, nuk do të hezitonin ta përdornin këtë pjesë të Shqipërisë si "monedhë" për të paguar hyrjen e Italisë në Luftën e Parë Botërore në krahë të Francës, Rusisë dhe Anglisë në të përmendurin si Traktati i Fshehtë i Londrës. Në paragrafët e këtij traktati të thurur nga diplomatët evropianë, lexojmë…

*"Italia do të marrë në zotërim të plotë Vlorën, ishullin e Sazanit dhe një territor të mjaftueshëm si zonë sigurimi kundër çdo rreziku ushtarak midis lumit Vjosa në veri dhe lindje e krahinës se Himarës në jug. Në rastin e formimit të një shteti të vogël autonom dhe asnjanës në Shqipëri, Italia merr përsipër që të mos kundërshtojë një dëshirë të mundshme te Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë për ndarjen e krahinave veriore dhe jugore të këtij shteti, midis Malit te Zi, Serbisë dhe Greqisë…"*

Shembujt dhe arsyet me të cilat historia mbështet të drejtën e shqiptarëve për të shkëputur përfundimisht çdo lloj lidhjeje varësie politike nga shteti i Serbisë janë të pafundmë, ashtu, siç janë të pafundme, edhe arsyet e dyshimeve, që ne shqiptarët, kemi ndaj drejtësisë së vendimeve të diplomacisë evropiane, që, në vend të këshillave urdhëruese për "durim", drejtuar shqiptarëve për hir të stabilitetit dhe paqes të Serbisë, duhej, që në këtë fillim shekulli të ri, t'i kërkonte falje publikisht popullit shqiptar për dëmin moral, politik, ekonomik dhe psikologjik qe i ka shkaktuar dhe të lante mëkatet e saj duke mundësuar futjen e shqiptareve në Bashkimin Evropian si një komb i vetëm, i pavarur dhe i barabartë me gjithë të tjerët.

Ishte Presidenti Uillson i SH.B.A., që kundërshtoi në Konferencën e Paqes në Paris[3], traktatin e fshehtë të Londrës mbi të cilin diplomatët evropianë kishin

nënshkruar aktin e dënimit me vdekje të kombit shqiptar. Fjalia e parë e deklaratës së pavarësisë të SH.B.A, do t'i dhuronte Presidentit Uillson, forcën e shenjtë për të këmbëngulur të mos e firmoste traktatin e paqes, deri kur, diplomatët evropianë pranuan të njihnin të drejtën kombit shqiptar për të pasur një shtet të pavarur brenda kufijve të caktuar në vitin 1913. Mision ky, përmbushjen e të cilit e vazhduan presidentët Klinton dhe Bush. Për këtë arsye, shqiptarët mirënjohës ndaj Sh. B. A, në vitin 1991, shkelën pa asnjë hezitim dhe mëdyshje mbi gjysmë shekulli propogandë antiamerikane të kryer me aq zell nga regjimi komunist dhe e pritën Xhejms Bejker, sekretarin e shtetit të Sh.B.A, si të ishte vetë Mesia i librave të shenjtë, sepse ai, ishte pasardhës i politikës së presidentit Uillson, që i dha mundësinë shqiptarëve të kishin një shtet (*edhe pse të cunguar*) dhe të vazhdonin të besonin tek ëndrra e shenjtë e lirisë. Për të njëjtin shkak dhe me të njëjtat ndjenja dashurie dhe respekti për të gjithë pasardhësit e presidentit Uillson, që i dhuroi forcën për të ëndërruar dhe jetuar, populli shqiptar do të presë të gjithë përfaqësuesit e SH.B.A.

Por, le ti rikthehemi edhe njëherë shkronjësit anonim të "memos" dhe fjalëve që lanë të pagjumë shqiptarët natën e 14 shkurtit...

Vallë, kujt i ishte drejtuar kjo "memo"?

Politikanëve?

Kujt prej politikanëve?

Atyre të shtetit të Kosovës apo atyre të shtetit të Shqipërisë?

Apo me saktë, Presidentit apo Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë apo atyre të Republikës së Kosovës?

Nëse këto kritika i drejtoheshin ndonjë prej të sipërpërmendurve, atëherë, përse vallë, shkronjësi i "memos" i inatosur, sepse politikanët shqiptarë kishin ndërhyrë në "punët e brendshme të Serbisë" duke marrë guximin të kritikonin shkatërrimin nga shteti Serb të Memorialit të Preshevës, nënvizojmë, ngritur mbi një tokë të populluar nga shqiptarë dhe që gjendej brenda kufijve të shtetit Serb vetëm falë marrëveshjeve prej matrapazësh të diplomatëve evropianë, nuk kishte marrë mundimin ti shkruante atyre personalisht por e kishte bërë letrën e tij publike?

Ndërkohë që gazetarët në përpjekjen e mundimshme për të shmangur çdo konfuzion që mund të krijohej midis përcaktimeve "Memo" dhe "Memorial", e zëvëndësuan këtë te dytin me fjalën "Lapidar" apo "Pllakë përkujtimore", shqiptarët mbas natës të pa gjumë dhe diskutimeve të përflakura pranë kafesë së mëngjesit, arritën në përfundimin e trishtë se "memoja", më shumë se politikanëve i drejtohej pikërisht atyre…

Shqiptarëve!

Fare lehtë, shqiptarët mund të bënin një hap prapa dhe të fajësonin "liderët" e tyre politikë siç i këshillonte

“memoja”, por, befas kuptuan se ishte hera e parë që nuk mund, nuk donin ta bënin këtë, thjesht sepse, ishte hera e parë që “liderët” shqiptarë kishin thënë atë, që të gjithë shqiptarët mendonin…

Ishte herë e parë që liderët shqiptarë të detyruar nga presioni i popullit, kishin guxuar së fundmi të ankoheshin (edhe pse, vetëm me gjysmë zëri) për plagën që përgjakte zemrën e popullit shqiptar prej më shumë se një shekulli.

− E pra, me gjithë mëkatet që mbartnin mbi shpinë, kësaj radhe, “liderët” tanë nuk e meritojnë të vuajnë hakërrimin e “memos”, − mërmëritën shqiptarët dhe, në heshtje, e thuajse me kënaqësi, pranuan “fajin” për të cilën i akuzonte shkronjësi anonim i “memos”.

− Nëse jemi fajtorë, sepse në shekullin e XXI po guxojmë, të ëndërrojmë dhe të kërkojmë, të drejtën për tu vetëqeverisur dhe për tu ndjerë të barabartë mes të barabartëve me të gjithë popujt e botës, të drejtën e shenjtë të pohuar që në vitin 1776 nga Deklarata e Pavarësisë të SH.B.A, atëherë le të na quajnë fajtorë, − pohuan njëzëri shqiptarët dhe ja futën gjumit të qetë edhe pse...

Një dyshim i vogël vazhdonte tu ngacmonte lehtazi mendimin.

Vallë, mbas shkronjësit të “memos”, të qëndronin vërtetë Sh.B.A dhe idealet e lirisë të cilat kishin mbarsur lindjen e kombit amerikan, apo, ndoshta...?

Tiranë, 21. 02. 2013

**1. Papa Benedeti XVI, shpalli publikisht dorëheqjen nga posti i drejtuesit të kishës së krishterë katolike në datën 11 shkurt 2013.**

**2. Shkatërrimi i Memorialit të Preshevës nga xhandarmëria serbe në 20 janar 2013, u pasua në territorin e shtetit të Kosovës, nga shkatërrimi prej personave të panjohur i një monumenti përkujtimor të Luftës II Botërore në qytetin e Vitisë dhe disa dhjetëra gurësh varresh serbe në qytetin e Prizrenit dhe komunën e Kllokotit.**

**3. Në Konferencën e Paqes të zhvilluar (me ndërprerje) në Paris nga prilli i vitit 1919 deri në janar 1920, shtetet fituese të Luftës I Botërore i përcaktuan shteteve humbëse kushtet për të firmosur traktatet e paqes, sa edhe vijëzuan hartën e re politike të Evropës.**

# MBI Z. LUBONJA
# DHE
# "LUBONJËZIMIN"
# E SHOQËRISË SHQIPTARE

Pasi na është shfaqur, rishfaqur dhe stërshfaqur nga ekranet e TV për të na zbrazur mbi krye opinione të ndriçuara mbi sportin, gatimin, politikën (*atë që quhet makro dhe atë që quhet mikro*), ahengun, historinë (*"historinë" e ahengxhinjve që këndojnë të paguar nga i zoti dasmës*), letërsinë, humorin dhe shumë tema të tjera që i përfshijnë të gjitha ngjyrat e ylberit të mendimit njerëzor, z. Lubonja, në artikullin "**Myslimanët, historia dhe miti i Skënderbeut**" (Gazeta "Panorama", 20 Mars 2014. Gazeta "telegraf" 22 Mars 2014), iu rikthye temës së tij të preferuar…

Rishkrimit, apo, siç kujdeset ta cilësojë z. Lubonja,"dekonstruktimit" të historisë së Shqipërisë. Dhe, sigurisht, këtë "dekonstruktim" të historisë, sipas këshillave të z.Lubonja, shqiptarët duhet ta fillojnë nga historia e atij që z. Lubonja i qan zemra ta "dekonstruktojë"...

Gjergj Kastriotit !

Besnik të shprehjes "jepi Çezarit çfarë i takon Çezarit" që nazaretasi Jezu e shqiptoi diku në Provincën Romake të Palestinës, do të tregoheshim të padrejtë ndaj z. Lubonja nëse nuk do të përmendnim që kësaj radhe, më shumë se

nga ajo, dëshira e tij e hershme për të "dekonstruktuar" (copëzuar dhe ringjitur nga e para apo mballosur siç shprehet populli) historinë e Gjergj Kastriotit, shkëndija e cila ndezi tek z. Lubonja frymëzimin për të shkruar "Myslimanët, historia dhe miti i Skënderbeut" u bë një polemikë e zhvilluar për Skënderbeun nga një farë Amir Ahmeti, themelues i partisë "Nisma për Drejtësi dhe Zhvillim", dhe z. Avni Arifi, drejtues në partinë "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës".

Mbasi na njeh me personazhet e debatit kosovar, z. Lubonja kujdeset të nënvizojë se z. Amir Ahmeti është një politikan me "inspirim erdoganist". Për shqiptarët mjeranë që nuk ia thekin shumë nga gjuhët e huaja dhe politika e jashtme, shpjegojmë që "inspirim" mund të shqipërohet saktësisht me fjalën shqipe "frymëzim" dhe se ky "Erdogani", është kryeministri aktual i Turqisë.

Kush ishte shkaku i grindjes midis Amir Ahmetit dhe Avni Arifit?

Ashtu si dikur në kohërat biblike, Zoti, nga maja e një mali i zbuloi Moisiut 10 urdhëresat e famshme, z. Ahmet "erdoganisti" i zbuloi befas popullit shqiptar që; "***…për Skënderbeun mendoj se duhet ti japim fund miteve, sepse, gjeneratat e ardhëshme kanë nevojë për historinë tonë të vërtetë, cilado qoftë ajo dhe jo të ushqehemi me mite***" dhe se, "*…**në mesjetën e hershme kombet nuk kishin lindur ende dhe, nuk kishte kurrëfarë rëndësie se çfarë gjuhe flisje kur interesi fetar vihej para…***".

Mbas leximit të këtyre rreshtave, ndoshta, do të më bërtisni t'i jap fund me kaq, sepse, mjafton dhe tepron për të kuptuar që "zbulimet" historike të z. Ahmeti mbajnë erë të qelbur. Ama, zoti Ahmeti, doni apo nuk doni ju, bërtisni apo nuk bërtisni, nuk mjaftohet me kaq. Me sa duket "erdoganizmi" e kishte frymëzuar apo paguar aq shumë, sa ai, si një kukull e kurdisur, nuk pushon së zbuluari shqiptarëve, diturinë apo të vërtetat mbi historinë e tyre që i kishin ardhur drejt për drejt nga qielli, apo, më saktë, nga Stambolli…

"***Skënderbeu me tu kthyer në Krujë, myslimanëve shqiptar iu tha të zgjidhnin në mes të krishtërimit dhe vdekjes, shumicën e tyre që refuzuan të braktisnin besimin mysliman ai i masakroi pa mëshirë***", shkruan z.Ahmet erdoganisti dhe ashtu si një dhe një bëjnë dy, mbërrin në përfundimin e dëshiruar (e dëshiruar nga ndonjë stambollist që ashtu si ai, ëndërron me sy hapur ringjalljen e Perandorisë Osmane por jo nga shqiptarët!) se; "...***meqë Skënderbeu na derdhi gjak shqiptari për motive fetare, unë nuk mundem ta quaj hero kombëtar***".

E pra, çdo shqiptar, përballë këtij pohimi, pavarësisht lartësive intelektuale ku i noton mendja dhe i lodron shpirti, do ti thoshte z. Ahmeti se; " nuk ju prish aspak gjiza që një bukëshkalë si ai, emiruci i Ahmetëve, nuk e quante Skënderbeun hero kombëtar".

Por, me sa duket, z. Arifi, nuk mundi të mjaftohej me shpërfilljen personale ndaj asaj që kolegu tij politikan

mendonte për Skënderbeun dhe vendos t'i vej në dukje këtij, që, Skënderbeu nuk vrau askënd për motive fetare, sepse, ata që vrau, ishin tradhtar dhe këta, tradhtarët, nuk kanë as komb dhe as fe.

"Shkaku i sherrit është gruaja", thotë një personazh i filmit "Kapidani".

"Shkaku i sherrit është Skënderbeu!", bërtet i ngazëllyer nga faqet e "Panoramës", z. Lubonja.

"Ju pata thënë se historia e Gjergj Kastriotit duhet dekonstruktuar" vazhdon z. Lubonja dhe i pushtuar nga ekstaza e të qenit edhe profet përveçse opinionist, i kujton lexuesit se si, shumë vite më parë, në një shkrim me titullin tundues "***Skënderbeu i kërkimit shkencor***", e kishte parathënë "sherrin" që Skënderbeu do të ndillte mes shqiptarëve, duke...

Sigurisht, duke u kujdesur të anashkalojë faktin që pas këtij titulli zëmadh, fshihej vetëm një intervistë me z. Oliver Jens Schmitt, një historian anonim i importuar nga Zvicra, me të cilin, për z. Lubonja (*siç mund të kuptohet nga titulli që paraprin intervistën me zotërinë në fjalë*), fillonte dhe mbaronte famëmadhja dhe aq e diskutueshmja shkencë e historisë.

"Un jam alfa dhe omega", i tha Zoti izraelitëve.

"Historia e Skënderbeut, fillon dhe mbaron tek Shmidi", i përsëriste asaj kohe shqiptarëve nga faqet e gazetave dhe ekranet e TV, z. Lubonja.

I shqetësuar se mos ndoshta shqiptarët i kishin harruar këshillat e tij profetike sa edhe i ndezur nga debati midis dy politikanëve kosovarë, z. Lubonja (*me ndihmën e faqeve të "Panoramës" dhe "telegrafit"*) vendosi t'ia u rikujtojë rrezikun e madh që i kërcënohej, nëse, nuk pranonin të "dekonstruktonin" historinë e Skënderbeut siç ai i kishte këshilluar.

Por...

Çfarë rreziku mund t'i vinte shqiptarëve nga Skënderbeu që, për më tepër, sa ishte gjallë, nuk u kërkoi kurrë as ta bënin mbret dhe jo më, ta shpallnin pas vdekjes hero kombëtar?

−Përçarja! − hidhet në sulm z. Lubonja, − Skënderbe mavrija kërkon t'iu përçajë!

−Skënderbeu? Mos e dhëntë Zoti! − ia kthejnë shqiptarët dhe të menduar shtojnë, − Ne e quajtëm hero dhe e nderojmë si të tillë pikërisht sepse, ishte i vetmi që na bashkoi, na bëri të ndjehemi dhe të kuptojmë se ishim pjesë e një kombi të ndryshëm kombet e tjera.

−Ju kanë gënjyer! Ju kanë mashtruar! − hingëllin si i marrosur z. Lubonja.

−Ja dëshmia! Prova që po ju përçan, − thotë z. Lubonja dhe ndërsa i tund shqiptarëve para syve debatin midis dy politikanëve kosovarë, llangos në faqet e llangosura të "Panoramës", mendimin e tij mbi Skënderbeun dhe arsyet se përse ishte i bindur që Skënderbeu, simbol i bashkimit të shqiptarëve, në të vërtetë po i përçante.

*"Dhe kështu mund të arrijmë të imagjinojmë një situatë ku shqiptarët myslimanë, për interesa të aktualitetit, t'i bëjnë thirrje komunitetit të tyre që, të mos nderojë Skënderbeun si hero kombëtar, sepse, ai ka vrarë myslimanë; dhe shqiptarë nacionalistë të edukuar me mitin e Rilindjes "feja e shqiptarit është shqiptaria" dhe me Skënderbeun si çlirimtar i atdheut nga "pushtuesit turq", që do tu kundërvihen duke i quajtur "tradhëtarë të atdheut". E kjo t'i polarizoj keqas të dy palët sikur të bëhet fjalë për ngjarje që kanë ndodhur baballarëve të tyre gjatë Luftës së Dytë apo gjatë luftës në Jugosllavi e jo në mesjetë*", shkruan z. Lubonja dhe për hir të rivendosjes së paqes midis shqiptarëve, vetëm disa fraza më tutje, vendos të sqarojë kundërshtitë e mbarsura nga historia e Skënderbeut që kanë përçarë z. Ahmeti dhe z. Arifi.

Si të ishte Solomoni, mbreti i gjithëdijshëm i izraelitëve biblikë, z. Lubonja fillon të gjykojë drejtësinë e pohimeve të dy politikanëve kosovarë. Çuditërisht, ndërsa shumë herë i jep të drejtë "erdoganistit" Ahmet (*kjo, për ata që njohin mendësinë apo pamendësinë historike të z. Lubonja nuk përbën asnjë risi*), nuk shkruan as edhe një fjalë të vetme mbi arsyet se përse z. Arifi i infektuar keqas (*ashtu si edhe shumica dërrmuese e shqiptarëve*) nga ajo ideologji që z. Lubonja e quan "miti i Rilindjes" dhe nga ideja se Skënderbeu na paskërka çliruar shqiptarët nga "pushtuesit turq", gabohet në pohimet e tij.

Ja se si e gjykon z. Lubonja debatin që Skënderbeu i "mallkuar" ndezi midis dy politikanëve shqiptarë nga Kosova...

"***Kur Amir Ahmeti thotë se, në mesjetën e hershme kombet nuk kishin lindur ende dhe, nuk kishte kurrëfarë rëndësie gjuha që flisje përpara interesit fetar, apo se, Skënderbeu ka vrarë shqiptarë myslimanë, thotë disa të vërteta historike që i përkasin asaj kohe***", mbështet i lumtur z.Lubonja, ndriçimet historike të "erdoganistit" nga Kosova.

Por, një fjali më poshtë, z. Lubonja ngatërrohet me këmbët e tij kur na rrëfen që…

"***Ballaban pasha për shembull, i njohur si një nga komandantët më të shquar osmanë që ka luftuar kundër Skënderbeut, që ka vdekur në Petrelë, e që ne e kemi njohur si osman, ka qenë edhe ai shqiptar***".

"***Që ne e kemi njohur si osman***", na thotë z. Lubonja!

Kush "ne"?

Të gjithë shqiptarët që kanë lexuar për historinë e Skënderbeut diçka më tepër se libri i z. Schmit, e dinë prej shumë kohësh që Ballaban Pasha ishte shqiptar. Sikur z. Lubonja të kishte marrë mundimin që krahas "historisë shkencore" të zoti Schmit të kishte lexuar të paktën (dhe cilësoj të paktën) edhe biografinë e Ballaban Pashës të shkruar nga Sami Frashëri, identiteti shqiptar i Ballaban Pashës nuk do t'i ngjante as i padëgjuar, as i habitshëm dhe aq më shumë, si një zbulim të mahnitshëm që z.

Schmit, befas, ia u solli shqiptarëve nga Zvicra së bashku me çokollatat.

I pështjellë nga vorbulla e kënaqësisë që po i zbulonte shqiptarëve se Ballaban Pasha ishte shqiptar, z. Lubonja harron se vetëm një fjali më sipër kishte pohuar që, në mesjetën e hershme kombet akoma nuk ekzistonin. Sigurisht, në këtë pikë të gjykimit, në mënyrë të natyrshme, z. Lubonja duhet të kuptonte që diçka në arsyetimin e tij ishte e gabuar. E gabuar sepse, nëse do të pranonim si të vërtetë pohimin që kombet apo ndjesia kombëtare nuk kishin lindur në kohën kur jetoi Skënderbeu, si rrjedhojë, do të pohonim edhe se, Ballabani Pasha mund të ishte i krishterë apo mysliman, por jo shqiptar.

Por, i dëshiruar sa ska më, të shpëtonte shqiptarët nga përçarja duke i ndihur të "dekonstruktonin" historinë e Skënderbeut, duket se, z. Lubonja nuk kishte kohë të tëpërt që ta humbiste me hezitime e mëdyshje të kota dhe pa u shqetësuar aspak që arsyetimet e gabuara të çojnë në përfundime po aq të gabuara, vendos të vazhdojë thurjen e çoroditur të "çorap-artikullit" duke kërcyer si një lepur i ndërkryer nga një gabim në tjetrin.

Sepse…

Z. Lubonja gabohet edhe kur i jep të drejtë "erdoganistit" nga Kosova kur ky thotë se Skënderbeu na paska jetuar në mesjetën e hershme. E pra, si z. Lubonja, si z."erdoganist", do të mjaftonte të pyesnin një nxënës

shkolle, për të mësuar që, epoka e historisë e quajtur mesjetë e hershme, mbaron ne vitin 1000, pra, thuajse pesë shekuj para kohës në të cilën jetoi Skënderbeu.

Sa për pyetjet...

Çfarë është një komb dhe kur kanë lindur kombet, studiuesit e historisë akoma nuk kanë dhënë një përgjigje përfundimtare, edhe pse, dyshoj që bindja e z. Ahmet "erdoganisti" dhe z. Lubonja "dekonstrukturisti" se kombet nuk ekzistonin në epokën kur jetoi Skënderbeu, më shumë se nga studimet historike që janë kryer në shekuj mbi çështjen kombëtare, janë mbështetur vetëm tek ndonjë libër i veçantë i botuar në gjuhën shqipe si i titulluari "Miti i Kombeve" i z. P. Geary që në mënyrë të ndërsjellë dëshiron ta çojë lexuesin në përfundimin e gabuar se kombet janë një krijim artificial i politikës dhe i ekonomisë dhe jo i gjuhës, traditave, miteve, legjendave, historisë, pra, e të gjithë asaj kujtese të trashëguar që detyron një grup individësh të ndjehen pjesë e bashkësis të quajtur komb apo popull.

Pohimi se në kohën kur jetoi Skënderbeu ekzistonte vetëm ndjesia e përkatësisë fetare dhe jo ndjesia e të qenit pjesë e një kombi, në vend ta ndihmojë, e ngatërron gjithnjë e më keq z. Lubonja kur, pasi i zbulon shqiptarëve të sotëm se Ballaban Pasha ishte shqiptar, pohon më pas se; "***...edhe Skënderbeu ishte mysliman para se të braktiste ushtrinë osmane***".

Pra, për z. Lubonja, Ballabani ishte shqiptar kurse Skënderbeu, duke qenë se kombet nuk kishin lindur, na ishte vetëm mysliman deri kur, na u bë rishtazi i krishterë. Kujdes, i krishterë por jo shqiptar!

Nëse z. Lubonja pranon se Ballabani ishte shqiptar, atëherë, i duhet të pranojë që edhe Skënderbeu ishte shqiptar dhe si rrjedhoje, i duhet të pranojë edhe se…

Gabohet kur së bashku me z. Ahmet "erdoganistin" pohon se në kohën e Skënderbeut, kombet, apo ndjesia kombëtare, nuk kishin lindur akoma.

Por, edhe kësaj radhe, z. Lubonja nuk ka kohë arsyetojë sepse e "shqetëson" deklarata përfundimtare e z. Ahmet "erdoganistit"…

"***Përderisa Skënderbeu derdhi gjak shqiptari për motive fetare nuk mundem ta quaj hero kombëtar***!"

Përpara se i pari (Ahmet "erdoganisti"!) të sh-pallte, dhe i dyti (Lubonja), të shqetësohej për atë që kishte sh-pallur i pari, do të ishte mirë që, të dy bashkë (Ahmeti dhe Lubonja), t'i sqaronin vetvetes disa pyetje që duhej t'iu lindin natyrshëm.

Nëse kombi shqiptar nuk ekzistonte, atëherë si mundi Skënderbeu të derdhte gjak shqiptari?

Nëse Skënderbeu derdhi gjak shqiptari për motive fetare, nuk duhet vallë t'i tregoni lexuesit edhe se sa prej shqiptarëve të asaj kohe ishin myslimanë?

Përgjigjen e pyetjes së dytë (*meqë pyetjes së parë që është pjellë e paditurisë dhe konfuzionit të tyre historik, z. Lubonja*

*dhe z. Ahmeti e kanë të pamundur t'i gjejnë një përgjigje*), z. Lubonja dhe z. Ahmeti mund ta gjejnë lehtësisht nëse marrin mundimin t'i hedhin një sy regjistrimit të popullsisë së Shqipërisë që shteti otoman kreu rreth gjysmë shekulli pas vdekjes së Skënderbeut, dhe do të binden se, shqiptarët që Skënderbeu i vrau sepse gjoja na ishin myslimanë, ekzistojnë vetëm në imagjinatën e tyre historike të frymëzuar nga dikush në Stamboll, Beograd, Athinë, dhe pse jo, edhe në Bruksel apo në tokën e çokollatave dhe orëve që bëjnë "ku-ku" ku ka lindur z. Schmit. Kurse, në lidhje me Ballaban Pashën dhe të tjerë si ai, që ktheheshin në Shqipëri në krye të një ushtrie otomane për të poshtëruar, shkatërruar, plaçkitur, përdhunuar, asimiluar, zhdukur, shfarosur popullin e tyre, na ngjan disi e pamundur të pranojmë se këta u ndëshkuan nga Skënderbeu për shkak të fesë myslimane.

Për hir të "paqes" dhe "dekonstruktimit" të historisë mund edhe t'i pranonim si të vërteta pohimet e z. Lubonja dhe Z. Ahmeti, por, po ta bënim, do të na duhej të pranonim edhe që, shumë heronj shqiptarë të besimit myslimanë si, Isa Boletini, Mic Sokoli, Çerçiz Topulli, na paskan luftuar turqit ( *dhe shqiptarët që ishin pjesë e ushtrisë dhe administratës turke*) vetëm sepse këta ishin myslimanë. Kjo, do të na e shndërronte historinë në një rrëfenjë absurde ku do të rrëfehej se si dikur, ca myslimanë shqiptarë vrisnin vetëm për hir të përkatësisë fetare (*të njëjtë!*) ca myslimanë të tjerë.

Por, zoti Lubonja, i hipnotizuar nga dëshira e marrë për të "dekonstruktuar" sa më parë historinë e Skënderbeut, nuk tundohet nga dyshimet dhe vazhdon tjerrjen e komedisë së tij të keqkuptimeve apo më saktë të gabimeve.

"***Duke qenë se kombet nuk kishin lindur akoma asaj kohe***", arsyeton z. Lubonja, dhe se, "***morali shoqëror i asaj kohe ishte besnikëria ndaj fesë, nuk ka kuptim të përdorësh konceptin e besnikërisë apo tradhëtisë kombëtare në atë kohë***".

Pra, sipas z. Lubonja, duke qenë se Ballaban Pasha ishte bërë mysliman, ai nuk mund dhe nuk duhet të quhej tradhtar edhe pse udhëhoqi një ushtri të huajsh (*por myslimanë si ai*), kundër atyre (*sipas z. Lubonja kombi i Arbërit nuk ekzistonte*) gjuhën e të cilëve fliste që kur kishte lindur. Nëse respektojmë të njëjtën logjikë arsyetimi, nuk del po kaq i pafajshëm edhe Skënderbeu kur akuzohet nga "erdoganistët" apo "ballabanistët" e rinj se vrau myslimanë, kur këtë (*vrasjen e myslimanëve*!), e bëri për të mbrojtur popullin e tij që asaj kohe, ishte i krishterë si edhe ai vetë?

"***Fakti është***", shkruan z.Lubonja, ***"…se ndërsa historia e Skënderbeut e shekullit XV është komplekse, mitizimi i historisë së tij në shekujt XIX–XX e ka thjeshtëzuar figurën për qëllime të nacionalizmit shqiptar që lidhen pa dyshim edhe me aleancat e tij me të krishterët***".

Nga leximi i kësaj fraze është lehtësisht e kuptueshme që sipas z. Lubonja, historia e Skënderbeut që ne njohim sot, është një histori e rreme, pjellë e mitizimit të historisë së vërtetë të Skënderbeut (*e cila ruhet vetëm në kokën e z. Lubonja*) nga nacionalizmi shqiptar në shekujt XIX dhe XX.

Pra, zanafilla e mashtrimit na qenka mjerani nacionalizëm shqiptar...

Nacionalizmi shqiptar?

Befas, z. Lubonja kujtohet për veprat që shumë autorë evropianë shkruan për Skënderbeun gjatë shekujve XVI-XVII, dhe ky fakt i sjell në mendje që gjatë këtyre shekujve, nacionalizmi shqiptar, për dreq, akoma nuk kishte lindur. Atëherë, ndryshon udhë dhe i tregon lexuesit se...

"***...ndërmjet mitizimit, ai*** (Skënderbeu!) ***është bërë më së pari heroi i krishtërimit për të frymëzuar të krishterët në Perëndim që ndiheshin të rrezikuar nga osmanët/myslimanët. Ky mitizim e bëri të famshëm në botën e krishterë…***".

Në këtë pikë të rrëfimit z. Lubonja e ngërthejnë të dridhurat. Kupton se lexuesi mund të mbërrijë në përfundimin që fajin për mitizimin e historisë së Skënderbeut nuk e kishte nacionalizmi shqiptar (*që nuk kishte lindur akoma*!) por ajo...

Evropa!

"Mos e dhëntë zoti të bëj fajtore Evropën!", mendon zoti Lubonja dhe shton në kllapa, "***e theksoj në botën e***

***krishterë dhe jo në ato të shteteve Europiane që lindën më vonë***".

Kush ishin këto shtete që "lindën më vonë" dhe çfarë i dallonte nga ajo që z. Lubonja e quan "botë e krishterë"?

Mos ndoshta këto shtete që "lindën më vonë"(?) nuk i përkisnin besimit të krishterë, arsye kjo për të cilën, z. Lubonja i veçon nga ajo që ai e quan "botë e krishterë"?

Mos u mundoni më kot të gjeni përgjigjet e këtyre pyetjeve sepse, e tëra kjo frazë që në vështrim të parë të ngjan se "thotë" shumë, nga ana historike nuk mbart asnjë kuptim dhe, është thjeshtë një tymnajë e ngritur qëllimisht nga z. Lubonja që lexuesi të humbas udhën e arsyetimit.

Mbi fjalorin dhe konceptet e turbullta historike që z. Lubonja i pëlqen aq shumë të shpërndajë pa u kursyer në hapësirat mediokre të debateve televizive për të fshehur ndoshta njohjen e përciptë të historisë ose gjurmët e dëshirës së tij apo të frymëzuesve të tij për të zhbërë historinë e shqiptarëve, mund të diskutohet gjatë. Në këtë rast, tymnaja historike e kësaj fraze, nuk është mbarsur nga njohja e përciptë e historisë, por, nga dëshira e z. Lubonja, për ta shtyrë lexuesin në përfundimin se, Skënderbeu, nuk u nderua si hero (*"mitizua", shprehet z. Lubonja*) nga popujt e Evropës por nga krishterimi. Ama, pa dashur, në tymnajën e tij të qëllimshme, z. Lubonja shpreh edhe një të vërtetë të madhe...

Ndërsa popujt, njerëzit më të ditur të Evropës, e nderuan Skënderbeun për disa shekuj rresht, si një hero të

pathyeshëm që shpëtoi qytetërimin e popujve evropianë nga dyndjet e hordhive otomane, "shtetet evropiane qe lindën më vonë" (*siç i cilëson Lubonja*) i harruan sakrificat e popullit shqiptar dhe bëmat e Skënderbeut, sepse nxituan të krijonin mitet e heronjve të tyre nacionalë. Mund të shkruajmë këtu një listë të gjatë emrash, por, po mjaftohemi me përmendjen e dy "heronjve" të këtillë që z. Lubonja me siguri i njeh fare mirë; Vilhelm Telin zviceran dhe Till Eulenspiegelin e vendeve të ulta.

I ndërgjegjshëm për morinë e heronjve të rremë apo gjysmë të rremë me të cilët shumë shtete evropiane konstruktuan lavdinë e historisë së tyre, z. Lubonja nxiton t'i largohet kësaj teme të rrezikshme dhe hidhet si luan kundër asaj që ai e quan armiku më i madh i popullit shqiptar …

Nacionalizmit!

Pa të cilin, me gjithë vonesat e shfaqjes tek shqiptarët, dobësinë, brishtësinë që e karakterizoi për shkak të armiqve të shumtë në numër dhe shumë herë më të fuqishëm që ju kundërvunë, sot populli shqiptar do të ishte zhdukur, dhe...

Nëse populli shqiptar do të zhdukej, së bashku me vdekjen e tij do të harroheshin edhe bëmat e çorbës që gatoi diplomacia evropiane në Ballkan. Për ta thënë më thjeshtë, pa praninë e shqiptarëve, tashmë, diplomacia evropiane do t'i kishte zgjidhur problemet e Ballkanit. Por shqiptarët mbijetuan dhe për këtë, fajin e ka gjithnjë ai...

I mallkuari Skënderbe, që edhe pse i vdekur dhe i pavarr, nga bota e përtejme i mbushi mendjen shqiptarëve dhe i dha guximin të mos pranonin të zhdukeshin duke i shkaktuar kaq shumë probleme të pafajshmes Evropë.

Është e kotë të nxehesh dhe turfullosh z. Lubonja, nuk ke ç'i bën heronjve (*e kam fjalën për ata të vërtetët siç është Skënderbeu*), këta janë të tillë dhe quhen heronj, pikërisht sepse, zotërojnë aftësinë të jenë të gjallë e t'i flasin popullit të tyre edhe pse, sipas historisë kanë vdekur shekuj e shekuj më parë (*në lidhje me këtë temë, të këshilloj që, ashtu si denjove të lexosh librin e z. Schmitt, të lexosh edhe librin "Graal… Shpirti i humbur i Evropës dhe historia e mohuar e Alba−Gens"*).

Për të mos humbur kohë në labirintin kaotik të lojërave të fjalëve dhe të përsëriatjeve të sulmeve kundër nacionalizmit shqiptar të cilat z. Lubonja nuk humbet as edhe një rast të vetëm pa ia përsëritur shqiptarëve nga ekranet e TV dhe faqet e gazetave (*të cilat aq shumë e adhurojnë*), më në fund, z. Lubonja shpreh atë që i qante zemra ta thoshte që në fillim…

"…***për të vazhduar me paradokset ku të çon instrumentalizmi i shoqërisë le të kujtoj një gjykim manipulativ të historisë, tejet i përhapur mes shqiptarëve. E kam fjalën për atë që shumë shqiptarë edhe sot e akuzojnë Evropën si "kurvë" sepse ndau Shqipërinë në dysh ndërkohë, që e vërtetë është se, Shqipëria në atë kohë, u krijua si shtet komb dhe se, për aq sa u krijua në atë***

***kohë, u krijua me ndihmesën e shteteve europiane dhe, ç'është më e rëndësishmja, edhe Europa që kemi sot nuk është Europa  që ishte në prag të luftës së parë botërore***".

− Ahh more shqiptarë! Si guxoni të akuzoni Evropën se gjoja kjo e paska ndarë Shqipërinë ne dysh? Kush ja u paska thënë këtë gënjeshtër? − u ulurin shqiptarëve z. Lubonja.

Por edhe këtu z. Lubonja gabohet!

Evropa, nuk e ndau Shqipërinë në dysh sepse së pari e copëtoi në tre pjesë, pastaj në katër dhe duke mos u kënaqur me kaq e futi thikën edhe njëherë në trupin e saj, për ta ndarë në pesë pjesë.

Ti more z. Lubonja gabohesh edhe kur shkruan që Evropa e ndihu Shqipërinë të "krijohej" sepse një apo edhe shumë shtete së bashku, sado të fuqishme që ky apo këta shtete të jenë, nuk munden të krijojnë një komb. Dëshmi e vërtetësisë së këtij pohimi është "kombi jugosllav" që Evropës i shkrepi në mendje të krijonte pas Luftës së Parë Botërore.

Gabohesh edhe kur thua se duhet ta falënderojmë dhe jo ta shajmë "kurvë" Evropën, meqë, sipas teje, me ndihmën e saj, Shqipëria u bë "shtet komb". Në histori, përcaktimi "shtet komb" përdoret për një komb që jeton i pavarur brenda kufijve të një shteti nga ai i qeverisur ndërkohë që, shteti shqiptar që Evropa pranoi ta njihte vetëm pas shumë përpjekjesh të dështuara për ta vrarë pa

lindur akoma, nuk përfshinte brenda kufijve të tij as gjysmën e kombit shqiptar.

Por ngjan se z. Lubonja, është i ndërgjegjshëm për të gjitha gabimet e përmendura më sipër sepse, në të njëjtën fjali, nxiton të shfajësohet për gabimet e tij dhe ato të Evropës me këto fjalë...

"**...ç'është më e rëndësishmja, edhe Europa që kemi sot nuk është Europa që ishte në prag të luftës së dytë botërore**".

Edhe pse "nuk do as mend dhe as kalem" të kuptosh që Evropa e sotme nuk është më, ajo e Luftës së Parë Botërore (*ligji i kohës që ndryshon gjithçka në mënyrë të pashmangshme do të ndryshonte edhe Evropën*), një mendje e pafajshme mund të pyeste; duke qenë se ajo, Evropa e vjetër (*siç e quani ju*), nuk u tregua edhe aq e mirë dhe bujare me ne shqiptarët, kjo e reja si është? Më e mirë akoma apo më e keqe?

Është e vërtetë që Evropa ka ndryshuar por nuk mundemi të themi të njëjtën gjë për diplomacinë e saj. Edhe sot e kësaj dite, populli shqiptar vuan padrejtësitë e traktateve të nënshkruara nga diplomacitë e Evropës së vjetër që z. Lubonja këmbëngul se nuk ekziston më. Akoma edhe njëherë në fillim të shekullit XXI, diplomatët e kësaj Evrope të re (*edhe pse ajo e vjetra nuk ekziston më*) i bënë rishtazi të qartë popullit shqiptarë, se nuk kishin aspak ndërmend të pranonin të ndryshonin ato vijëzat e kufijve që paraardhësit e tyre kishin hequr me thikë mbi

trupin e kombit shqiptar gjatë shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX.

− Harrojeni atë histori! − kërcënon shqiptarët Evropa e re.

"Nëse është e re, siç na tha z. Lubonja, përse vallë vazhdon të mbajë mbi shpinë mëkatet e të vjetrës?", pyesin veten shqiptarët e menduar.

− Harrojeni historinë! − këshillon shqiptarët z. Lubonja dhe kafshon gjuhën. Fjala shqipe "harresë" i tingëllon keq. Mendohet pakëz dhe vendos ta zëvendësoj me përcaktimin filozofik "dekonstruktim".

"Kjo po që është fjalë e bukur. Fjalë e huaj. Nuk e kupton kurrkush", mendon i lumtur për gjetjen z. Lubonja dhe i bërtet shqiptarëve...

− Duhet të dekonstruktoni historinë nëse doni të shpëtoni.

− E si ta dekonstruktojmë këtë të shkretë histori që po na prish kaq shumë punë? − e pyesin shqiptarët.

− Ja u them unë, − përgjigjet z. Lubonja dhe kësaj radhe në rolin e profetit të frymëzuar nga qielli (*Brukseli, Athina, Stambolli, Beogradi …*), e përdor fundin shkrimit të tij tek "Panorama" për t'i ndriçuar shqiptarëve udhën që do ti nxjerë nga "qorrsokaku" ku i ka futur historia e rreme e Shqipërisë e frymëzuar nga të mallkuarit Rilindës.

"***…të krijojmë distancën racionale shkencore me të vërtetat e periudhave të ndryshme historike***", këshillon z. Lubonja.

− Distancë racionale shkencore…Tingëllon mirë! Nuk mundemi ta mohojmë! Po si bëhet kjo? − e pyesin shqiptarët.

"***...kjo bëhet me ndryshimin e historisë nëpër shkolla***", përgjigjet z. Lubonja.

Është kjo e njëjta kështillë-urdhër që shumë prej emisaro-komisarëve anonimë të Evropës së re (*anonimë sepse në vendet e tyre përkatëse, nuk i njeh askush* ) kanë udhëzuar shtetin e Republikës së Shqipërisë, më pas, edhe atë të Republikës së Kosovës, të përmbushin sa më shpejt. Pra, për ta thënë me fjalë të thjeshta, Evropa e re dhe z. Lubonja, së bashku dhe njëzëri, na këshillojnë të zhdukim nga historia e shkruar të gjitha ato fakte historike që sipas tyre, nxisin urrejtjen midis popujve.

Çfarë rezultati do të jepte mbi trupin dhe shpirtin e kombit shqiptar përmbushja e këtij këshill−urdhëri?

Përgjigja është e thjeshtë; rezultatin apo fundin, që do të kishte një i sëmurë rëndë i cili do të këshillohej nga mjeku se për tu shëruar, mjaftonte të harronte sëmundjen nga e cila vuante.

Afërmendsh që harresa e sëmundjes, qoftë kjo edhe e lehtë, nuk mjafton për tu shëruar aq më tepër që...

Emri i sëmundjes nga e cila vuan kombi shqiptar është gjymtimi.

A mund të jetojë e shëndetshme një qenie njerëzore nëse i presim një këmbë, një dorë, ose të dyja bashkë?

Askush nuk do të mendohej shumë për tu përgjigjur se ky mjeran, nuk do të kishte më as jetë të shëndetshme dhe as të gjatë.

E përse vallë duhet të mendojmë se kjo përgjigje aq e logjikshme për trupin njerëzor, nuk është e vlefshme edhe për popujt?

Populli shqiptar z. Lubonja, nuk do të ecë kurrë përpara dhe shoqëria e tij nuk do të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme, për sa kohë do të vazhdojë të jetë i gjymtuar. Ky gjymtim i trupit dhe shpirtit të tij, nuk mund të shërohet duke harruar shkakun dhe emrin e atyre që e gjymtuan. Vallë, nuk do të ishte më mirë, që në vend të këshillave për të harruar historinë, diplomacia evropiane t'i kërkonte të falur popullit shqiptar?

Përballë kësaj pyetjeje, dikush si z. Lubonja mund të na përmendë frazën sugjestionuese; "Evropa e re e popujve të bashkuar", duke shtuar që për hir të përmbushjes së këtij ideali të gjithë popujt e Evropës duhet të sakrifikojmë diçka. Se gjoja, për shqiptarët, kjo "diçka" që duhet të sakrifikojnë në themelet e "Evropës së bashkuar" na qenka historia. Sigurisht që ky "dikushi" gënjen dhe qëllimi i tij nuk është aspak përmbushja e ëndrrës së krijimit të një shteti ku popujt e Evropës të jetojnë në paqe dhe harmoni por e kundërta e saj. Qëllimi i tij është ngjizja e një Evrope ku do të sundonte ligji i xhunglës, gjenocidi dhe zhbërja e popujve, sepse i tillë do të bëhej një shtet i mbarsur nga gënjeshtra, mashtrimi dhe harresa.

Të hipnotizuar nga fraza magjike "Evropa e re e popujve të bashkuar" apo për të fshehur të pëgërat e një qeverisjeje të korruptuar e të pamoralshme, shumëkush nga politikanët e shteteve të Shqipërisë dhe Kosovës i kanë pranuar me hare këshillat për sakrifikimin, harresën, zhbërjen apo "dekonstruktimin" e historisë. Por, çështja e sakrifikimit (harresës etj, etj,) të historisë së papëlqyer, për ne shqiptarët është si puna e fillit të Arianës që dihej ku niste por nuk dihej ku mbaronte, sepse pas emisaro-komisarëve anonimë të Evropës, politikanët shqiptarë filluan të "këshilloheshin" po kaq "miqësisht" edhe nga Greqia, Serbia dhe së fundmi edhe nga Turqia dhe Rusia që të ndryshonin ato pjesë të historisë së Shqipërisë që kishin lidhje me shtetet e tyre dhe...
Nëse i plotësojmë dëshirën të gjithëve, në fund, në librin e historisë të popullit shqiptar do të shkruhet vetëm epitafi...

**"Qenë dikur ca shqiptarë që nuk e dinin që ishin shqiptarë. Kujtonin se kishin një hero, që në të vërtete nuk e kishin dhe pastaj, jetuan të lumtur dhe vdiqën në paqe! Bekuar qoftë kujtimi i tyre i harruar!"**

"**Së dyti**", këshillon z. Lubonja, "**duhet të arrijmë të dekonstruktojmë mitet nacionaliste që kanë lindur në periudha të tjera historike**".

Edhe pse historia e Skënderbeut është "mit" vetëm në hapësirën e çoroditur të mendimit historik të z. Lubonja,

do të pranoja të bëhesha luftëtar i paepur i "dekonstruktimit" të asaj pjese të historisë së popullit shqiptar që z. Lubonja quan "mite nacionaliste" nëse, z. Lubonja do të ishte në gjendje të na tregonte një shtet Evropian, të cilin ne shqiptarët, mund ta merrnin si shembull për të mësuar se si të dekonstruktonim historinë tonë.

E këshilloj z. Lubonja të provoje të këshillojë, le të themi ambasadorin Italian, të "dekonstruktojë" nga librat shkollorë të historisë së Italisë, figurën e Xhuzepe Garibaldit.

E pra, sipas logjikës që përdor z. Lubonja për Skënderbeun (*edhe pse duke shtrembëruar faktet historike*), Garibaldi si vrasës i dhjetëra qindra italianëve të pafajshëm gjatë fushatës së tij në Siçili dhe më pas në Italinë e Jugut, nuk duhet të nderohet si hero nga shteti dhe populli italian dhe as duhet të konsiderohet i tillë në tekstet shkollore. Për të njëjtat arsye nuk duhet të nderohet si i tillë as Martin Luteri në Gjermani apo Zhan D'ark në Francë. Ç'na ngelet të themi për të shfajësuar Karlin e Madh që edhe pse ka një histori të mbushur me masakra është shpallur si hero dhe frymëzues i idesë së Evropës së Bashkuar?

Lista e krimeve të personazheve historikë që në shumë prej vendeve të Evropës së Bashkuar adhurohen si heronj (*shpesh herë pa qenë aspak të tillë*) është e gjatë dhe këtë besoj se Z. Lubonja e di fare mirë. Por nëse e di, përse vallë nuk

pushon së këshilluari shqiptarët që të mohojnë Skënderbeun dhe gjithkënd e gjithçka të lavdishme që mbart historia e popullit shqiptar?

Pjesa e fundit e artikullit ku z. Lubonja e këshillon popullin shqiptar të "***vështrojë nga e ardhmja***", është sa e dhimbshme aq dhe qesharake.

E dhimbshme dhe qesharake sepse e ke të vështirë të kuptosh, nëse është pjellë e një idealizmi fëmijëror apo e një mashtrimi të ndërgjegjshëm. Nëse kjo frazë e z. Lubonja, është rezultat i një kopjimi të pafajshëm intelektual (*siç aq rëndom bëjnë pseudo-intelektualët shqiptarë për tu treguar të tillë, pra intelektualë*) nga programi i ndonjë shoqate ekologjike me seli në lagjet e pasura të ndonjë qyteti të Evropës Perëndimore apo një kalë troje që po i afrohet portave të shpirtit të kombit shqiptar, në fillim për ta ndjellur me pamjen e tij të bukur dhe pastaj për ta vrarë, djegur e varrosur me shpatat dhe zjarrin që fsheh në bark.

"***…për të ndërtuar një të ardhme ku të gjithë të ndihen të lirë në diversitetin e tyre, mendoj se na duhet të gjejmë simbole që ti përgjigjen kësaj të ardhmeje, që fatkeqësisht mungojnë për shkak të uzurpimit të hapësirës sonë publike nga simbolet nacionaliste me frymë totalitare***", shkruan z.Lubonja.

Natyrshëm të lind pyetja se kush janë këto simbole të reja (***ç'virtyte mbartin?***) për të merituar të zëvendësojnë simbolet nacionaliste si; Skënderbeu, flamuri kuq e zi me shkabën dy krenare, historitë e atyre shumë heronjve që

sakrifikuan jetën për kombin shqiptar pa kërkuar dhe marrë asgjë në këmbim, simbole këto, ndoshta vërtet të "vjetra" siç i quan z. Lubonja, por që, pa të cilat, tashmë, kombi shqiptar nuk do të ekzistonte?

Z. Lubonja do t'i radhis "shpejt e shpejt" në këtë mënyrë…

"***Simbole të paqes dhe dhe harmonisë midis diversiteteve.***

***Simbole të Solidaritetit.***

***Simbole të sakrificës për të tjerët.***

***Simbole të dashurisë për natyrën.***

***Simbole kundër racismit dhe homofobisë.***

***Simbole të rezistencës kundër autoritarizmit…"***

Përse ta mohojmë?

Virtyte vërtet të bukura dhe të adhurueshme. Kombi shqiptar shumë prej këtyre virtyteve i zotëron dhe i nderon prej shumë shekujsh (*këtë mund ta dëshmojmë me një pafundësi shembujsh*) por, një hero kombëtar (*që nderohet si i tillë pikërisht sepse qëllimi i jetës së tij ka qenë shpëtimi dhe mbijetesa e kombit*) nuk mund të jetë mbartës i të gjitha këtyre virtyteve. Madje, edhe hyjni paqedashëse si Jezu Krishti dhe Buda, me gjithë përkryerjen mbinjerëzore që i karakterizon, nuk janë mbartës të të gjitha këtyre virtyteve në këmbim të së cilave ju na propozoni të pranojmë kokulur të "dekonstruktojmë" historinë e heroit tonë kombëtar.

Përtej fjalëve të bukura ju z. Lubonja po i kërkoni shqiptarëve të këmbejnë historinë e lavdishme të Skënderbeut dhe shembujt e jetës të atyre dhjetëra e qindra heronjve pa të cilët kombi shqiptar nuk do të ekzistonte, me asgjënë e harresës. Me "hiçin" që i veshur me petkun e një ëndrre të bukur do të na shfaqet në gjumin e përtejmë që ngërthen deri në vdekje popujt që mohojnë apo harrojnë historinë e tyre.

Mjerisht, artikulli i z. Lubonja, është vetëm një copëz e vogël e përpjekjeve për "Lubonjëzimin" e kombit shqiptar. Ndërkohë që shtetet evropiane investojnë me miliona euro për të lëvduar dhe përhapur historinë e tyre me ndihmën e filmave, dokumentarëve, librave historikë, romaneve, poezive, këngëve, pikturave, monumenteve, veprimtari kjo, ku vendet fqinjë që kanë përfituar nga copëtimi i Shqipërisë janë ndër më të zellshmet, shtetet shqiptare (Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë) të fshehura pas justifikimit të varfërisë, investojnë vetëm heshtjen dhe buzëqeshjen e tyre miratuese ndaj atyre që kështillojnë rishkrimin e historisë së popullit shqiptar. Dhe ky miratim i heshtur por shpesh herë edhe aktiv, i hap udhën "lubonjëzimit" të shoqërisë shqiptare që përkrahet dhe investohet bujarisht edhe nga turli shoqatash dhe organizatash evropiane dhe ndërkombëtare "mike" të Shqipërisë. Po të hapim kapakun e librit të z. Schmitt të titulluar "Skënderbeu" do të zbulojmë se është i financuar

nga “Fondi i Bashkëpunimit Zviceran” dhe “Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim”.

Çfarë do të ndodhte sikur institucione të shtetit shqiptar apo kosovar do të financonin botimin, reklamimin dhe shpërndarjen nëpër libraritë e Konfederatës Zvicerane, të një libri ku heronjtë e shtetit zviceran të quheshin banditë dhe hajdut kuajsh?

Vallë, a do të konsiderohej ky akt si shprehje e miqësisë së shtetit shqiptar për zvicrën dhe zviceranët?

Libri i z. Schmitt, me gjithë prirjen lehtësisht të dukshme të autorit për të deformuar dhe keqinterpretuar qëllimisht informacionet mbi historinë e Skënderbeut, nuk do të ngjallte aspak në mendjet e shqiptarëve dyshimin se shumëkush në Evropë po përpiqet që shqiptarët të përbuzin dhe pastaj edhe të harrojnë historinë e tyre, nëse, “Fondi i Bashkëpunimit Zviceran” dhe “Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim”, do të financonte me po kaq dashamirësi dhe mendje të hapur edhe librat e autorëve që ju kundër përgjigjën librit të z.Shmitt. Një dyshim i tillë, nuk do të lindte në mendjet e shqiptarëve edhe nëse libri i z.Schmit do të ishte i vetëm në sojin e tij. Problemi është se libraritë e pakta të Shqipërisë së varfër, gëlojnë nga libra të ngjashëm me ato të z. Schmit dhe në mënyrë të pashmangshme, pas kapakëve të këtyre librave që nën petkun e rremë të kulturës evropiane i këshillojnë shqiptarët të përbuzin dhe pastaj edhe të harrojnë historinë e tyre, gjejmë

gjithmonë emrat e fondeve dhe OJQ ndërkombëtare "mike" të Shqipërisë, që kanë mundësuar përkthimin, botimin dhe reklamimin e bujshëm të këtyre librave. Përhapja, molepsja apo infektimi i shpirtit dhe i mendjes së shqiptarëve me idenë që simbolet kombëtare si flamuri apo himni, jo vetëm që nuk kanë asnjë vlerë për tu nderuar por përkundrazi, janë të dëmshëm, apo që heronjtë e tyre kombëtarë kanë qenë "banditë", "hajdutë kuajsh dhe dhish", "kriminelë ordinerë", krahas librave të sipërpërmendur, kryhet me zell edhe nga një sërë pseudointelektualësh, që nën petkun e opinionistëve apo analistëve sundojnë mediat shqiptare duke i prerë udhën kujtdo që kërkon të shfaqë në këto media një mendim të ndryshëm nga ai i tyre. Përballë këtij realiteti të lind natyrshëm pyetja se mos ndoshta, edhe pas "suksesit" të këtyre personazheve mediatikë, qëndron dikush që kujdeset dhe investon, që këta të përhapin pa u shqetësuar nga askush, ide të tilla antikombëtare, njësoj ashtu si fondet e sipërpërmendura zvicerane, ndihmuan z. Shmitt, historian ky i panjohur në vendin e tij, të botonte një libër në Shqipëri.

Ky dyshim bëhet edhe më i madh kur vëzhgon se pas kapakëve të librave të autorëve shqiptarë si Spiro Konda, Nermin Vlora Falaski, Petro Zheji, Mathieu Aref, Aristidh Kola etj, dhe të shumë historianëve dhe gjuhëtarëve evropianë që kanë shkruar ndër shekuj për historinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve, nuk gjen kurrë emrin e ndonjë

OJQ apo fondacioni "mik" i Shqipërisë që të ketë ndihur për botimin e këtyre librave.

Përse?

"Lubonjëzimi" i shoqërisë shqiptare që zuri fill me procesin e "dekonstruktimit" të historisë së Skënderbeut, vazhdoi me përbaltjen e shumë heronjve të tjerë të popullit shqiptar. Këtë fat e pati edhe Nënë Tereza e nderuar si shenjtore nga shqiptarët e të gjitha besimeve. Pikërisht ky virtyt i Nënë Terezës për të bërë krenar dhe bashkuar gjithë shqiptarët, ndolli sulmin e egër kundër saj. Së pari, mediat e shkruara dhe vizive hodhën dyshimin se nuk ishte shqiptare dhe më pas, në pamundësinë për të dëshmuar "gjakun" joshqiptar të Nënë Terezës, e quajtën mashtruese dhe spiune të Vatikanit. Lista e emrave të heronjve të kombit shqiptar që në forma të ndryshme u bënë pre e kësaj fushate përbaltje është e gjatë dhe zemra më dhemb për t'i përmendur një e nga një. Gjithçka duket se kulmoi me shfaqjen pranë Tiranës të një skulpture të përçudnuar ku heroi ynë kombëtar paraqitej i ngjashëm me hyjin antik Panin (me dy brirë, bisht dhe thundra). Padashur, këta përçudnues apo "dekonstrusktues" anonim të mitit të Skënderbeut, edhe pse jo aq të famshëm (*për arsyen se zgjodhën të ngeleshin anonimë*) sa z. Lubonja apo z. Ahmet "erdoganisti", i bënë një nder të madh heroit tonë kombëtar sepse e njësuan me një prej hyjnive më antike të Qytetërimit Evropian. E bënë Skënderbeun një me...

“Panin e pa-anë, të pafundmë si kozmosi, hyjninë që nuk vdes kurrë edhe pse ka lindur shumë e shumë herë”, siç do të shpreheshin për këtë hyjni, dhjetëra autorë antikë.

Ky është fati i Heroit z. Lubonja!

Ai është indiferent ndaj gjykimeve të ziliqareve, ndereve apo inateve të shteteve, sundimtarëve dhe heronjve të rremë që këta krijojnë, gjykimeve të real-politikës dhe madje edhe të historianëve dhe pseudo – historianëve. Thjeshtë sepse, Heroi, me sakrificën e tij, ka fituar përjetësinë dhe kjo e bën atë të paprekshëm. Përçudnuesit  përpiqen ta njësojnë me bishën e egër dhe pa e ditur i japin pamjen e një hyjnie të pavdekshme. Sepse, siç  thonë fjalët e legjendës ...

Skënderbeu është i gjallë dhe do t’i gjendet gjithnjë në krah popullit që e ka lindur, sa herë që ky, të ketë nevojë për ndihmën e tij!

Tiranë 24. 03. 2014.

# “MAGUS”

Më në fund një lajm i mirë...

Në Tiranë është hapur një librari e re.

Quhet, “Magus” !

Lajm i mirë, sepse në Tiranën e fillim shekullit të XXI, hapen pijetore që për të ngjarë modernë, shqiptarëve i pëlqen ti quajnë “Bar” apo “Pab”, hapen pafund “zgara” greke, turke, piceri italiane, qebaptore e paidhaqtore, por jo librari...

Të hapësh një Librari në Tiranën e shekullit të XXI është marrëzi, sepse, shqiptarëve të fillim shekullit të XXI ju pëlqen të hanë qofte (qoftet e zgarës, qoftet e politikës, qoftet e korrupsionit), të lëpihen si qentë në kërkim të qofteve, të vdesin në spital për shkak të qofteve, të votojnë si qofte për mashtruesin, banditin, përdhunuesin, maskarain, horrin e radhës, të qahen për fatin e keq që kanë lindur shqiptarë dhe që hanë qofte, por...

Nuk ju pëlqen aspak të lexojnë.

Pra...

Nuk bëjnë të vetmen gjë që do ti shpëtonte nga qoftet, nga mashtruesit, nga përdhunuesit, nga maskarenjtë, nga horrat që i qeverisin e ja u bëjnë jetën varr dhe Shqipërinë ferr.

Sa do të jetojë libraria “Magus”?

Një muaj?

Dy?

Një vit...?

Sepse, nuk është e lehtë që një librari të mbijetojë në Shqipërinë e fillim shekullit të XXI, ku libri, dituria, shkronjat shqip, urrehen dhe përbuzen.

Pikërisht, për këtë arsye, librarëve të rinj të "Magusit" i shpreh admirimin tim dhe librarisë i uroj jetë të gjatë sepse, hapja e "Magusit", të jep shpresë se ndoshta një ditë, drita e diturisë do të triumfojë mbi errësirën e horrllëkut që ka ngërthyer Shqipërinë.

Përse libraria është quajtur Magus?

Fare e thjeshtë...

Vetëm midis faqeve të librave mund të gjejmë shkopin magjik i cili do të na ndihë të ndryshojmë Shqipërinë, dhe...

Meqë kryeministrit i pëlqen ti përsërisë rëndom shqiptarëve se nuk ka shkop magjik për të përmbushur premtimet që vetë ju ka bërë, e këshillojmë me këtë rast, të kthejë vështrimin nga librat dhe njerëzit e librave, të çlirojë librat dhe libraritë nga taksat, sepse, vetëm tek njerëzit e librave, tek dituria e librave dhe tek libraritë, mund të gjejë shkopin magjik dhe të bëjë të mundur atë që tanimë na ngjan e pamundur.

Tiranë, 07. 02. 2017.